Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
“Ditët e Naimit”

Biblioteka
MERIDIANE POETIKE

Përgatiti
Shaip EMËRLLAHU

Këshilli botues
Craig CZURY
Visar ZHITI
Ndue UKAJ
Xhelal ZEJNELI
Shaip EMËRLLAHU

Ballina dhe fotografitë
Francoise ROY

www.ditetenaimit.org

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
"DITËT E NAIMIT"

Edicioni XVIII

FYTYRË SIRENE

Përktheu
Visar ZHITI
Silke Liria BLUMBACH
Edita KUÇI - UKAJ
Jeton KELMENDI
Ilire ZAJMI
Lediana STILLO
Robert GORO
Iljaz BOBAJ
Artan ARSLLANI
Entela KASI

Ditët e Naimit
Tetovë, 2014

T'I JAPËSH EMRIN TËND, NJË YLLI...

Sido që të duket dhe sado të kujtojmë se harrohet, - e kam fjalën për poezinë, - shekulli, që gjithmonë është më modern se paraardhësi, me shpejtësitë marramendëse që ka, që ua ka përcjellë gjërave dhe dukurive, ku çuditë shkencore dynden mbi të përditshmen duke e përthithur kohën e gjithsecilit me përbindshmërinë e Kronosit, në fund të fundit brenda njeriut mbetet diçka e ëndërrt, e përhershme dhe e pazëvendësueshme me asgjë, ku fjala, e krijuar në mijëvjeçarë që nga shpellat dhe deri në metropolet, që nga pergamena e deri tek kompjuteri, arrin të shndërrohet në poezi me kumte shpirti e duf jete.

Dhe ajo, poezia e njeriut kështu, vazhdimisht e ka paraprirë ecjen, si dëshirë dhe vegim, me flatra të padukshme drite dhe hijeje dhe ka mbërritur e para atje ku do të donim të ishim.

Shkurt, është ulur poezia e para në vendet ku kanë zbarkuar më pas shkencat dhe teknika, patjetër dhe artet e tjera...

Në fantazinë poetike të njerëzimit gjithçka ka qenë në zanafillë ndjesi ngacmuese për vazhdime ndryshe, shtesa e përmirësime të vetë realitetit. Ja, ashtu si qilimi fluturues i përrallave që ndolli aeroplanin...

- - -

Po e ndërpres përsiatjen, se më bëhet se dëgjoj uturimë avioni, që largësia dhe imazhet qiellore e shndërrojnë në një si recitim universi, ku futen re dhe flatra, rreze, ylbere, psherëtima horizontesh, po, po, se mbahet Festivali, tashmë tradicional, i Poezisë në Tetovë dhe në aeroportin e Shkupit, nëpër stacione, mes udhëtarëve të shumtë, zbresin poetë më tepër se në sezonet e tjera. Priten nga miqtë dhe me taksi, vetura, autobuz, motoçikleta nisen për atje, ku janë ftuar, si në çdo tetor.

Poetët nga bota kërkojnë të dinë më shumë për Poetin Kombëtar të shqiptarëve, Naim Frashëri, emrin e të cilit mban ky festival dhe duan t'ja shqiptojnë sa më drejt, ndalin para shtatores së tij dhe sheshi përreth sikur mbushet me barin e blertë të metaforave...

Drejtori i Festivalit, poeti dhe studiuesi Shaip Emërllahu, duket se ka marrë porosinë e Naimit dhe, teksa ka ndezur

qiririn e tij simbolik mbi skrivani dhe ka hapur librin e madh dhe me pendën naimiane në dorë ka shkruar emrat e poetëve, të qëmtuar nga të 5 kontinentet, të atyre që sapo kanë ardhur të marrin pjesë në edicionin e 18-të të Festivalit, rishtarë, por dhe që kanë bujtur më parë këtu, një herë, dy apo më shumë, të miqësuar tashmë me Festivalin dhe Tetovën, që do të duan të vijnë sërish.

Lexohen poezi, takohen poetë, bisedojnë dhe tregojnë, vizitojnë Universitetin shqiptar të Tetovës, i ngritur me mund, sakrifica e gjak.

Ndodh të ulen në një tryezë autorë, vendet e të cilëve janë në armiqësi me njëri-tjetrin, apo që nuk e njohin siç ndodh me Kosovën apo janë dhe në luftë midis tyre e poezia ndjell paqen, që do të vijë patjetër, spraps urrejtjet e dëmshme, mbjell mirëkuptimin e bukur.

Secili sjell diçka nga vendi i vet, aroma jete, profile të blerta dëshirash, rrugëtime fatesh, përpjekje e trishtime njerëzore, plagë dhe gjak... të pasqyruara prajshëm apo shqetësueshëm tek fjala e gjuhës së secilit, por që nuk krijohet më Babilonia e vjetër, por Tetova e re. Një si metropol poezie.

Antologjitë e përvitshme të Festivalit shtohen në bibliotekat tona. Janë poezi nga bota, të gjuhëve të ndryshme, por tani të gjitha në gjuhën shqipe, "në gjuhën e perëndive" siç besonte Naimi dhe gjithë rilindësit tanë.

Naimi e dëshironte bashkëbisedimin poetik, ja ashtu me dorë në zemër, jo vetëm me lexuesin shqiptar, por dhe me fqinjët ballkanas dhe ende më gjerë, në kontinent e më tej. Prandaj dhe shkruante poezi dhe në greqisht, në gjuhën homerike, dhe në persisht, poezinë e të cilëve e çmonte shumë për shpirtin, por më e kultivuar i dukej poezia perëndimore dhe u thoshte shqiptarëve se "lind ku perëndon". Dhe të tjerëve donte t'u tregonte për shqiptarët dhe trojet e tyre, për lashtësinë e dashamirësinë proverbiale. Dhe kërkonte si panteist dashurinë.

Ky festival, si të thuash, vazhdon dhe bën realitet, ja ashtu urtshëm, profecinë naimiane, duke mbledhur poetë në sofrën tetovare të poezisë, duke e zgjeruar edhe më komunikimin shqiptar me poezinë e botës.

Çdo vit Festivali vlerëson një nga të ftuarit me emrin e Naimit dhe të tjerë me çmime të tjera, sikur përndez kështu entuziazmin, hedh prarime të qirinjta të poezisë mbi gjindjen.

Kjo sikur i jep më solemnitet veprimtarisë, autorëve të pranishëm dhe dëgjuesve të tyre në sallën e madhe të teatrit të qytetit, aq sa, më pëlqen të kujtoj, se fituesi i vjetshëm, bullgaro-francezi Athanase Vantchev de Thracy botoi një libër të veçantë në Francë me poezi kushtuar të gjithë fituesve të mëparshëm, duke krijuar një poemë përbashkuese shpirtrash dhe imazhesh, me kumbime silabash të takimit, shkak i së cilës ishte Tetova jonë.

Me jehonë të brendshme më të gjerë janë dhe antologjitë e veta që boton ky Festival, tashmë i shndërruar në një institucion, që meriton vëmendje dhe mbështetje të

mëtejshme të institucioneve të shtetit.

Dialogu është shndërruar në poezi. Dhe sa më shumë jetë të sjellin poetët me poezitë e tyre, aq më shumë dhe poezia do të futet në jetë, përtej jetëve të tyre, në lexues dhe breza. Se jetët ia përcjellin njëra-tjetrës poezinë e jetës.

Në fund të fundit këtu mbahet një festival poezie, ku shpalosen emocione artistike, forma dhe ritme, metafora të befta, të ardhura nga thellësitë dhe nga larg, ngërthehen zëra, qetësia me të furishmen, shqetësimet me vegimtaren, konfliktet me paqen, modernia vazhdon klasiken dhe i rikthehet ndryshe, vërtet "Ditët e Naimit" këtu i ngjanë një shkolle ku të gjithë jemi mësues dhe nxënës, poetë dhe dëgjues dhe rizbulojmë se poezisë i mjafton vetvetja, si bukuri dhe identitet, harmoni me veten dhe botën dhe që ajo, poezia, do ta shoqërojë njeriun deri në fundin pa fund.

Ndërkaq, mund të vazhdojmë të themi që Tetova bën festivalin e mirëkuptimit të lartësuar në dashuri njerëzore.

Dhe nuk është rastësi që fituesi i sivjetshëm i Çmimit "Naim Frashëri" u përzgjodh poeti italian Sebastiano Grasso, këngëtari modern i dashurisë. E përditshmja e njeriut, çastet e saj, ai dëshiron që të shndërrohen në poezi dhe fuqia e dashurisë duket sikur e çon këdo nga rrugët e zakonshme plot me vetura në qiejt me pegas.

T'i japësh emrin tënd një ylli...

shkruan ai në njërën nga poezitë e zgjedhura për në Tetovë. Ja pra, poeti që prek yjet me dorë, shumë më përpara se atje të shkojnë anijet kozmike, i jep secilit nga një yll dhe le t'i pagëzojnë me emra dashurie.

Dhe Tetova sikur shton konstelacione të reja në qiellin e saj, mbi malet e Sharrit, nga erërat e të cilit vërshon ajër i pastër, nga ai që u bënte mirë mushkërive naimiane të poezisë, sjell ujëra të ftohtë e të kulluar, që ujisin epitetet e risive.

Poetët e botës, që bujtën në Ditët e Naimit, marrin me vete diçka nga Tetova dhe e çojnë në vendet e tyre ashtu si një suvenir, një mbresë, një imazh mbrëmjeje, si mjekër e poetit apo agu si profeci mirësie, mjegull dhe mikpritje, biseda me diell, ndonjëherë bie dhe borë e butë si heshtje e bardhë, e mbartin si melodi, po kështu një copëz rruge tetovare, aulat universitare, bekimin e selisë bektashiane, urat që të çojnë në një zemër tjetër, buzëqeshjet... njohën shqiptarë, tani do t'i duan më shumë... dhe në përmbledhjet e ardhshme me poezi që do të dalin në vendet e tyre e gjuhët e tyre, mbase njëra nga poezitë a më shumë si varg të fundit do të kenë: Tetovë, Ditët e Naimit, 2014

Visar ZHITI

Fitues i çmimit letrar “Naim Frashëri”

Sebastiano GRASSO (ITALI)

Sebastiano GRASSO
(ITALI)

Foto: Ferdinado Scianna

Sebastiano Grasso u lind më vitin 1947, në Catania të Sicilisë në Itali. Aty mori mësimet e para, ku kreu kolegjin klasik të San Michele di Acircale të drejtuar nga Etërit Filipinë.

Në vitin 1964, kur ai ishte 17 vjeç, boton përmbledhjen e tij të parë me vargje.

Laurohet për Letërsi moderne. Për disa vite me radhë ka ligjëruar letërsisë italiane në Universitet, deri në vitin 1971, kur shpërngulet në Milano për të punuar në gazetën më të madhe italiane, "Corriere della Sera".

Që nga marsi i vitit 2007, është zgjedhur President i PEN Club-it italian.

Ka nxjerrë librat me poezi:

- "Horizonte të largëta" - 1964,
- "Plaquette" - 1968, (me parathënie të kritikut të madh italian Carlo Bo),
- "Poezi jashtë stinës" - 1970 (me një hyrje nga shkrimtari Diego Valeri dhe me një vizatim në ballinë nga poeti i madh spanjoll Rafael Alberti,
- "Loja e kujtesës" – 1973 (me parathënie nga poeti i madh italian Mario Luzi e përsëri me vizatime nga Rafael Alberti, Domenico Cantatore, Ibrahim Kodra, Giuseppe Migneco e Aliqi Sasu, përkthyer në Spanjë në kolanën "Adonais",
- "Sina e kllounit" – 1978 (me parathënie nga Riccardo Bacchelli) dhe merr çmimin "Beella" dhe fiton "Cepp-Pistoia",
- "Poeti dhe fantazma" – 1980 (përsëri me parathënie nga kritiku Carlo Bo),... dhe Sebastiano Grasso hesht për 20 vjet rresht, ndërkaq poezi e tij futen nëpër antologji e botime kolektive.

Dhe befas në shekullin e ri, në mijëvjeçarin e ri shpërthim tjetër. Dalin librat:

- "Pubja jote e zezë do ta talle vdekjen" – 2000 (me një shkrim kritik nga Carlo Bo),
- "Mbi malin e Venerës" – 2002 (me parathënie nga Mario Luzi),
- "Lutja e një virgjëreshe" – 2004...
- "Pudër në këpucë të sheshta grash" – 2006... dhe vlerësohet me çmimin ndërkombëtar "Lerici-Pea" së bashku me Lawrece Ferlinghetti për karrierën letrare.
- "Hiri falenderon prushin dhe xixat" – 2007, (përmbledhje e katër vëllimeve të mëparshëm me parathënie nga shkrimtari i njohur Alberto Bevilacqua dhe me shtesë shkrimesh kritika nga autorë të shquar).

Po në këtë vit del në Spanë një përmbledhje me vjersha me parathënie nga nobelsiti portugez José Saramago.

Më pas vazhdojnë përkthimet e poezisë së tij në Poloni me parathënie nga Otto von Krauss, në Rusi "Nimfa me xhinse" - 2008, me parathënie nga poeti i njohur Evgenij Evtushenko,

- "Nën këmishën me perla" – 2008, (përmbledhje e futur në një kuti bronzi, gdhëndur nga skulptori Arnaldo Pomodoro),
- "Ti, në grackë nën qerpikë" – 2009, (me parathënie nga Jacqueline Risset), i përkthyer në suedisht, rusisht, arabisht (me parathënie nga poeti i njohur në botë Adonis, po edhe nga Moni Ovadia, etj,) si dhe në shqip në vitin 2014 (me parathënie nga Visar Zhiti).

Gjithashtu, ai është përkthyer dhe në gjuhët franceze, angleze, bullgare, etj, e vazhdon të përkthehet.

Sebastiano Grasso është përkthyes dhe vetë. Në gjuhën e tij amtare, në italisht, ka sjellë nga frëngjishtja poetët Apollinaire, Bodlaire, Cendrars, Senghor, Valery e nga spanjishtja Alberti, Aleixandre, Cemuda, Dali Gracia Loeca, Hierro, Jimenez, Machado, Neruda.

Të shumta janë veprat e tij eseistike për teatrin, bashkëpunimet me emra të mëdhenj të artit botëror.

Në gazetën "Corrire della Sera", ku ai vazhdon punën në sektorin e kulturës, ku punuan shkrimtarët e mëdhenj si Dino Buzzati e nobelisti Eugenio

Montale, boton çdo javë nga një shkrim eseistik.

Në vëmendjen e tij janë dhe kultura shqiptare dhe shqiptarët, për të cilët dhe ka shkruar...

NË STACION

Fantazmat fryjnë gjoksin dhe hovin
duke lënë fosile e perëndime të dashnorit tënd
ngjyrë bordoje. Aroma e bukës së mykur
krijon pauza tejet të gjata në këtë stinë
ende të pambaruar: rrënjë e mot' i mirë
shkridhet nga dheu i shkrifët. Të enjten
nuk do të vish me trenin e parë të mëngjesit,
që niset nga Sondrio, por unë po pres tashmë
në Stacionin Qendror dhe mbledh zjarrin e mbrëmjes
të trageteve në Laguna. Ndërrojmë zakone:
pak nisje, tepër arritje. Këtu jemi shumicë
që presim dhe pamja memece vazhdon,
ngulmon një lojë shkëmbimesh e përshëndetjesh.

FORMË TË HUMBURA

Zota të paepur u gjendën në një vajtim
të nëndheshëm ku ujëra acide mjegullash
spërkasin fytyrën tënde prej sirene të kohëve të tjera.
Këtu çdo dhomë bëhet e ndryshme:
imazhi yt vishet me fjalë, me forma
të humbura ndërsa vera futet pyjeve
dhe, në mbrëmje, hëna fle mbi degët e hija
përzihet me drurë hollakë që zhyten
nëpër ligatina. Dhe shiu ka zërin e saj
që rrëshqet mbi zallin e rrëkeve, ndërsa rrekem
t'i qëndroj natës që më fushëron aq pranë.

DO TË VIJNË TEK TY MBI FLLADE

Teksa endesh gjatë natës në kopshtet
e Manuelit mbi ne shpikin retë
drejtime të reja. Të marr me vete; mbi çatitë
e Sondrios petale, bardhësi bore,
rënë në agoni mes gotullave të tjegullave
ashtu si gjarpërinjtë. Do të vijnë te ty mbi fllade

psherëtimat e mia të ndezura,
do të dëgjosh me detin
që mërmërit jehonën e vajtimeve të mia, i këndon
Edgardi Luçies. Jehona jote është imja.

LEGJENDAT FSHATARE

E dashur, vezullojnë mbi thika të çuditshme
mendime dhe re të bardha përmbysin
stërkala kaltërsish. Thonë që natën
ndjehet rritja e grurit dhe e barit
hollak, por mbase janë legjenda fshatare
(në Varzella fermeri ua tregonte
nëntë çupave të tij). Ngulmon, vallëzon
e njolltë, lëshon dritë ngjyra mbi ishullin ku
stinët mbarojnë në puset pa ujë
e në qiejt ngjyrë llogaçesh.

RRATHË MAGJIKË

Nga sa enigma përbëhet historia jonë;
prej sa magjish, anija me të cilën duhej
të shkoje. Dialogu i thyer rinis: ëndërroj
një kohë që nuk ishte në ëndërr. Gjurmë e tua
mbi tapet shkatërrojnë fantazmat e shtëpisë, rrathë
magjikë e pasqyra ku kërkohet fytyra jote,
të vazhdosh një lojë dashurie e t'i japësh emrin
tënd një ylli. Në pritje, po në pritje që mjegulla
të shkrihet dhe furia e syve të tu të vijë me diellin.

TË KËPUTËSH AGIMET

Do të hapësh krahët e tu (nëna ime më pret
prej kohësh: nuk do ta zhgënjej ende dhe aq).
Si është e mundur të këputësh agime si pemët
o të thyesh pasqyrat dhe fati
mos të të braktisë? Zërat tanë coptojnë
flukset e reflukset, hiri bën pis parketin
dhe mes gjinjëve të tu shtrij dorën dhe fillon
solfezhi me mollzat e gishtave. Thonë që përroi
u çmend dhe ujrat vërshojnë luginave.
Nuk duhet shkuar në teatër, ditë pas dite
drama do të luhet brenda mureve shtëpiakë

MUZGU I JETËS

Pranvera i hidhet Veriut, e-mail-et
kanë zëvendësuar telegrafin, thonë, por
s'e di në di t'i lexosh. Engjëjt tanë janë
gjetiu, në det të hapur, si zogjtë shtegtarë.
Netët mbufaten, bëhen flluska kujtimesh
por s'plasin dot. Zot!, fati
ynë është një torturë e gjithmontë. Dhe është
tamam këtu, thua, muzgu i jetës, ferri ynë.

KUMBIMI I SË DIELËS

Shtohet kumbimi i së dielës
në mëngjes me ngrohtësinë e parë të qershorit.
Udhëtimi i munguar më lë pa ngjyrat
e stinës së verës, nga ditët perverse të gërryera
prej perëndimeve të kuqe gjak. Nga pas
xhamave shoh në rrugë, në kërkim
të krahëve të tu që shenjojnë një lamtumirë.

AJRI ZVETËNON

Do të të vijë në pranverë, përfundon falltarja
duke mos pranuar shpërblimin ("Do t'ma jepni
bashkë"):
atëherë në shtëpi do të jenë divanet e rinj. Të tjera
kujtime: trupa pa egërsi, stuhi të kërcënuara
nga gjëmimet (por pa shi), pagjumësi e muzikë
ripërtërijnë netët. Kush pret, në Randazzo,
barinjtë që derdhin qumështin e porsa mjelë
në kusitë e aluminta lënë jashtë
portës? (Nuk kishte Zyra të Higjienës.)
Të gabon një vetmi mbretërore dhe nuk vëren
që ajri zvetënon çdo skeptër.

MBI RRËNOJA

Piqet drita mbi rrënojat e torturuara;
këtu mbetet e në agoni rindizet
zëri yt ("Merrmë çmendurisht")
që duronte kontraste e kontradikta.
Jeta vazhdon, thonë shumë. Bulërin
në dhomën e ndëjtjes Minotauri i Pikassos duke

ngritur kokën e xhindosur. Dhe nata s'ka mëshirë
as nga stërkalat e saj as nga ëndrrat tona.

TË VOZITËSH

Pothuaj një mbishkrim, zëri yt. E kërkoj
ende mbi det, mbi lumë, si të qe
i aftë të pluskonte. Epitafet janë gjithnjë
më larg. Shpërfillin furtunën çafkat
që enden të lodhura fare ulët. Deti
mbërthehet tek mëngjesi, shpërthen anët
e fshatit ku kumbimet e para zgjojnë
gjumin dhe zbulojnë sekrete. Kemi pushuar
së vozituri, natën, drejt natës.

TË RIJETOSH MAGJINË

Grupi i humbur mblidhet,
sa jemi pas kësaj shtrëngate.
Mario Luzi

Anash binarëve që ndjekin faret e makinës
renditen shtëpiza e pallate të lyer. Gjeste të
shpejtë, shiu falsifikon temperaturën dhe orët bëhen
më të shkurtra, vdesin kodërzat gjithnjë e më larg
nga qytetit. Grija ndjek të tjera gjerësi
dhe deti ndërron emër pak e nga pak
nga që treni zgjatet drejt Veriut; rijeton magjia
e erës që rrokëzon e pëshpërit e që ti kërkon
të kapësh përvjetorë të padukshëm, shenja jete.

RRUGA BËN BËRRYL

Humb figura jote ku rruga
bën bërryl. Papritur e panjohura:
çfarë do të ndodhë? Nuk mundem
të të nxjerr nga kujtimet, s'ia dal dot. Duku
për kënaqësi, zhduku, riduku
si një vetëtitje, spikat, pastaj hepohu
dhe të ngatërroj me gjethnajën e një gajushe
që del jashtë nga muri në kthesë, boshatisesh
nga lulëkuqet ngjyrë gjaku. Tani heshtja
pothuaj e djeg dritën dhe e bën të errët
si në një gjerdan me brumbull
o në një humbje. Montale ka takuar
të keqen e jetës, unë kotësinë e saj të bukur.

NATË SURREALISTE

Një violinë në rrugë përsërit me orë të njëjtën
qarje dhe nga ballkonet tashmë dikush bërtet
se nuk mundet më. Dysheku ishte
më i ashpër në atë natën tjetër surrealiste
në të cilën gjumi u shpall i falimentuar.
Është fytyra jote në sirtarin e parë
djathtas skrivanisë: buzëqesh mes hithrave
e fierishtave, shikon, dëgjon, ngashënjehesh
sikurse hija që shfaqet të mos
ta marrë era e Jugut, e tmerrshme
si kjo cijatje violine.

QYTETI VDES

Në udhëkryqe bashkohet dhuna, qyteti
vdes nga ora në orë, dhe nuk duhet më
të presësh që shkëlqimi të braktisë pllakat
e bardha të banjës. Koret e natës bëhen
shtjella ndërsa biçikletat fluturojnë
mbi trotuare, u paraprijnë mallkimeve
dhe mjegullave ku të gjallët fshihen
o humbin si të vdekurit. O mbase ti e unë
jemi të vdekur, por pa e majmur tokën.

MISTERE

Kanë mbetje të natës kupat e argjendta
vendosur pas kanatave. Në video dikush
flet për mistere e daulle dhe vrasje
(në një sfond zërash histerikë), e thirrje
nga oborri i shtëpisë, para filmit
të tetë e gjysmës. Gishtërinjtë futen
nën jelek dhe thonjtë çjerrin gjirin
e ëndrrave. Jashtë një erë e fortë bën rrëmujë,
tund dhe pastron kryqet e praruar në qendër
të jaseminëve. Të mistershme, gabimet
joshnin ditët pa vënë
në hesap muzikën që shpallte
hakmarrjet në mjegullën gjithnjë e më therëse.

SHKALLË LËVIZËSE

Nuk mund të pres që të mbetesh vetëm.
Vetëtin metali i shkallëve lëvizëse
në Rinashente, fati ynë ngjyhet
me të zezë, mbulohet me hi dhe harxhohet
duke iu avitur një qielli që mbulon
prapësitë që nuk bëjnë potere.

GRI

Thua që grija nuk është tamam
një ngjyrë. Dhe qyteti? Shtëpi gri,
rrugë gri, tram gri, skena dhe paraskena gri.
Dhe sytë e tu janë gri: ajo grija që ka mbërritur
shkëlqimin e shekujve.

ENGJËJ NË KUNDËRDRITË

Bredhat dhe mështeknat ngjishen pas shtëpive
në Kristanstad,
ku bij dhe nipër të larguar jetojnë verën reale.
Kemi pritur këtë çast; pastaj kemi
ndalur, pa motiv. Zotat e detit cenojnë
anijet në rad. Cili, në shekullin XXI këndon ende
për vesën o erën që rrëmben një palë
çorape të shkulura nga kapëset? Engjëjt
janë zhdukur nga librat e përrallave; është e
pamundur t'i shohësh qoftë në kundërdritë.
Sytë pasqyrojnë një pallto blu leshi.
Të flesh. Do fle me shpresë se do të shoh në ëndërr,
por dallga të shtyn mbi shesh për të braktisur
vetveten.

E FUNDIT

Nata e fundit, fleta e fundit, hëna e fundit,
e fundit... Ku je? Shtirem se po të pres
dhe këndoj një refren, por tingulli copëtohet
dhe pakësohet befas, vazhdon qyteti të zgjohet
dhe më risjell aromën tënde të mëngjesit të parë,
kur mbi trotuare bënin sfilatë të parët
bankarë dhe veshi burgoste zërat.

Përktheu nga italishtja: Visar Zhiti

Maryam Ala AMJADI
(IRAN)

Maryam Ala Amjadi (1984, Teheran) është një poete, përkthyese dhe eseiste iraniane, e cila ka kaluar vitet e ndikuara të fëmijërisë së saj në Indi dhe shkruan poezi në gjuhën angleze. Ajo mori çmimin e ''Young Generation Poet' në Festivalin e parë Ndërkombëtar të Poezisë në Yinchuan, Kinë (Shtator 2011) dhe u dha Honorary Fellowship in Creative Writing nga Programi Ndërkombëtar i Shkrimtarëve (IWP) në Universitetin e Iowa-sw, SHBA (Pranverë 2008). Ala Amjadi është autore e një përmbledhje së poezisë dygjuhëshe anglishte-persiane e, Mua, Unë, dhe Vetja (2003) dhe libri i saj i dytë poetik, Plumbat Cigan, u botua nga Prafullata Publicataions (Indi) në vitin 2010. Përkthimi i poetit amerikan, Raymond Carver, u botua në një përmbledhje me titullin, Frika e arritjes së hershme (Aknoon Publikime, Teheran 2009). Ajo ishte gjithashtu fituese e Medaljes Argjende në Olimpiadën e 14-të Kombëtare Perse të Letërsisë (2001) dhe fituese e Çmimit të Dytë (për çështje gjinore në përkthim) në A.K. Ramanujan National Paper Reading Competition, Universiteti i Baroda, Indi (janar 2009). Ajo ishte shkrimtare për Tehran Times Daily, aty ku mbajti dhe shkroi një faqe javore në gjuhën angleze dedikuar kulturës dhe shoqërisë iraniane. Aktualisht, ajo është një studiuese PhD në Tekste dhe ngjarje në Europën e hershme moderne (TEEME) në Universitetin e Kentit dhe Universidade e Porto. Poezitë e Ala Amjadi-të janë përkthyer në arabishte, kineze, hinduse, italiane dhe rumune.

DELIRIUM

E burgosur në mua
është një grua
e humbur dhe e bukur
fundi i epshit tuaj për shëmtim.

Dua t' ju tregoj një histori të etheve të krevatit,
t´ju këndoj, një këngë pa rimë nga djepi i rremë
që përkund larg pengojcën e arkivoleve

Unë dua t' jem nxënës i kësaj përralle
në sytë e atij eunuku të kërrusur
me butësinë e një mijë Sheherazade të dehura
për të shuar vallen e një zjarri që ishte ndërtuar për të tremb frikën.
Pra: dëgjomëni mua nëse guxoni

Unë thash: e burgosur në mua është një grua
e humbur dhe e bukur.
le të vijë, të vijë
edhe toka, toka, kam thënë edhe toka
e përsërit veten,
Kush jam unë që të ulem, ulem, kush jam unë që të
ulem, ndërsa pemët vdesin në këmbë?

Unë thash, thash prisni, thash fundi i epshit tuaj për
shëmtinë
e fundit sepse gjërat që unë i di, unë i di,
në padijeni të gjërave që unë s'i di, unë s' i di
kafshoj kurrizin tim me shkëlqimin e një gruaje
që gjithmonë nxiton në pasqyrë pak para meje,
një papritshmëri, e cila nga çdo vezë çel një mijë
këngë mjellme
në një liqen që pretendon të jetë deti
për hir të një peshku të vogël, të zi
i cili ra në dashuri me lojën e rrezeve të diellit
në një tas kristali që kurrë s'e kishte parë,
një peshk i vogël, i zi, i cili ëndërronte rrjetin e
peshkatarit çdo natë
në krye të një gruaje të vjetër që ngeci në shkallët e kujtimeve
si zemra e rrjetit të merimangës e shtëpisë shkoi të flejë

Unë gjithmonë e kam ditur, unë thash
unë gjithmonë e kam ditur se shëmtia- bukuria
ishte një burrë për një grua
i cili mbajti këmbët e saj të papërmbajtura në papafingo
dhe krehu flokët e saj të parrethprera për një tjetër
në bodrum

Ti e di: nuk është distanca, ishte gjithmonë ajo që
shtrihet në mes
Unë e mendoj ketë moment dhe tjetrin, ajo që erdhi
nga dera, s' mund të shkon nga dritarja.
Unë dita si ta mbushja trupin tim edhe kur nuk
kishte ujë
për të larë tokën e baltosur,
ku lulet nga zbukurimi frymojnë, të pavëmendshëm
për sytë
që i këputi ato në sythe dhe i rriti të gjitha nga e para
Kam pasur një kuptim
se asnjë Hirushe në qytet
s'e dinte se ku këpuca vuante
në këmbën e gabuar

Askush nuk ngriti një gisht të gërvishte një zë

Unë pyeta: pse janë njerëz, njerëz dhe jo
rinoqeront?

Piva shiun si llumin e të Plotfuqishmit
Kam luajtur me dëborën ndërsa ai pështyu.
Pyeta, pse ata është dashur t´i varin yjet ashtu?
Pyeta, por kjo zgërdhirje kurrë nuk shkoi sipër me hijen

Unë isha poshtërsia, sa as vdekja nuk pranoi të gjykoi
Unë isha pastërtia, sa edhe këmbët e përgjakshme
të agimit
S' mund ta njollosin,
Unë gjithmonë isha ato gjëra që kurrë s' do të
mund të jenë përsëri

Ku, ku është rruga që hapet e më kthen te nëna
juaj e gjirit?

Unë gjithmonë e kam ditur
dhe pse kaltërsia mbi çdo qepallë është e njëjtë
Unë kisha shpresë,
Unë kisha shpresë se era do të zgjerojë këtë buzëqeshje
kisha huazuar nga një tjetër histori,
ku fundi gjithmonë bie në dashuri diku në mes,
ku heronjtë dhe heroinat përqafojnë horizontet e njeriut
dhe e keqja komploton në humor të mirë
të dhuroj një përkëdhelje për shpatullat e narratorit.

Ju e shihni, unë mendova se kisha një kuptim
kockat e mia janë ngjitur në nyjat e mia,
por tërë qenia ime ishte një enigmë figurative e
bashkimit të pjesëve
që u ul në tryezën me një pjesë qendrore të zhdukur

Nëse unë flas, nëse unë shpreh, edhe gjuha ime
është xheloze nga unë
Goja ime është një portë burgu që hapet me
krismat e fjalëve
në perëndim të diellit të dënimeve
Gjuha ime është njohur me përkëdheljet e flladit
përgjuar nëpër humnera, nga fortesa e dhëmbëve.

Kisha një kuptim
Unë mendova se e kisha një kuptim
Edhe toka e përsërit veten,
kush jam unë të them, them, kush jam unë për të
thënë " ndalo!" kur unë qëndroj
dhe gjaku endet në venat e mia?

Unë gjithmonë e dija,
Unë gjithmonë e dija kjo buzëqeshje
ishte një grua që ishte e shëmtuara- e bukura
për disa grimca të braktisura në Mars
me shpresën e mbytur të oksigjenit për një dashuri
të njëanshme,
një jehonë në male e lidhur me zinxhirë te një dorë
fëmijërore
që tërhoqi diellin vetëm për të tharë
funde me lule mbi çatinë e një shtëpie të shtrembër:

një dashuri e njëanshme ...
një dashuri e njëanshme ...
një dashuri e njëanshme.

Po, një dashuri e njëanshme
si një banesë katrore ku të katërta elementet e
dënimit
gjejnë shtëpinë në pak qoshe absolute
dhe një ditar që shkruan nga vetja çdo natë
me bishtat e cigareve në grepa të dëshpëruara
që ndjek një përgjigje dhe derdh një lot të zi në
fund si karrem:

Në mes të vetmisë tënde të mundshme, O Zoti im,
a mund të jetë se Ti vuan aq shumë?
(Sa e tmerrshme në qoftë se nuk e bën, sa e
tmerrshme në qoftë se jo!)

KU ËSHTË PAQJA E KËSAJ POEME?

Hej poet!
Le të jetoj dega e ullirit
dhe ta çlirojë barrën e hidhërimit të vet
Harrojeni pëllumbin herë pas here,
kështu mund të mbaj mend fluturimin pa një
udhëzim

Kama është lodhur nga tradhtitë
Peshoret duan të peshojnë veten për një ndryshim
dhe pragu i çdo faqeje dridhet
kur gojët e drejta numërojnë e pushimin e fjalëve
dhe gishtat e shtrembër me magji shndërrojnë
kokat në numra

Hej poet!
Drejto lojën e fjalëve të fundit me shoshën e

qëllimeve të para
Zhvishe kujdesin e ndajfoljeve me thelbin e
heshtjeve të kontrabanduara
Ngjyros gjakun e mbiemrave në zemrën e të gjitha
gjërave të hijezuara
dhe folje e pritjes e të gjitha emrave të çastit

Mbajë duart e orës dhe lëkundu:
Unë kam lindur për t'i humanizuar fjalët në këtë mënyrë!

Çdo laps i gjallë është një armë tjetër e thyer.

Poezia kurrë nuk do të vdes
por ndoshta një ditë,
një ditë të frikshme të patrembur
ne do të flasim pa metafora.

SHTËPI E HIDHUR SHTËPI

Nga asgjëkund
kjo shtëpi është tre cigare larg

Ata gjithmonë mund ta nuhatin atë
nga nafta që etërit nuk do u sjellin
dhe betejat e betejave që kurrë nuk rrjedhin.

Shkurtesa e diellit,
flokët e grave kurrë nuk rriten të gjata
Dhe gjinjtë e tyre
janë balona të rrudhura
që kurrë s' u lartësuan për rrushin e thartë

Pra, me të gjitha vezët në fytyrat tona
ne kemi omëletë shihe për mëngjes
dhe hamë zemrat tona nga gojët tona

Pastaj ne zvarritemi në qetësinë e shtretërve
ëndërrimtar
Kokat që flenë rreth s' kanë brengosje me tregimet
e zgjuara

Në këtë shtëpi
dritaret janë dyer -
që nxisin besimin në fat
dhe dyert janë dritare-
ndërsa ata mbyllin, në tavane muret të katit

Kur kukuvajka këlthet
ne përshëllejmë, përshëndetje t´i dorëzojmë ëndrrat

Ëndërr- duke vdekur
ne rrezikojmë lamtumirën me dhinë
që shpëton blegërinin në dyert e para

Gratë të mbuluara në perde
që shoshitin diellin në fytyrat e tyre
gjithmonë flasim për atë
që është dëgjuar si atje

Dhe këto tulla kanë minj
që asnjëherë nuk janë pre e korbit
por brej fjalë për fjalë
në lutjen tonë çnjerëzore
të njerizoj dordolecët.

Në këtë shtëpi,
ne fshehim atë që e kërkojmë
dhe përpiqemi të gjejmë humbjen tonë
shkojmë vjedhurazi në duart tona
në gjuhën tonë lidhim këpucët

Deri sa telefoni bënë një zile
dhe ne e dimë se krimbat
kanë peshkuar një zë tjetër në tinguj

Dhe kështu, ne pamë
çka ne shohim
edhe deti
tundet
në të njëjtën barkë me ne

Megjithatë, ne frymojmë në ta
dhe pjellën e minierave që shpërthen
në bërthama minutash
por kurrë nuk çelin në orë
për të dytën
njëri prej nesh kthehet prapa tyre
gishtat e par lexojnë fjalët e fundit
në Braille:

nga asgjëkund
kjo shtëpi është tre cigare larg.

(Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj)

Kadir AYDEMİR
(TURQI)

U lind më 13 shtator 1977, në Stamboll. Pas diplomimit në Shkollën e Lartë Fenerbahçe, ai ka studiuar menaxhimin e biznesit dhe marrëdhëniet publike. Poezitë dhe shkrimet e tij janë parë në revista të ndryshme. Ai botoi 11 numra të gazetës "Başka" (Të Tjera) Revista poemtike ndërmjet 1997 dhe 2003 ai ka qenë redaktor i internetit www.yitikulke.com që ai e themeloi që nga viti 2000. Libri i quajtur " Gölü Emen Mektup " (letra që absorboi Liqenin) ishte botuar në gjuhën e Azerbajxhanit në Azerbajxhan. "Aşksız Gölgeler" (Lieblose Schatten), tregime të shkurtra, u botua në gjuhën gjermane në Gjermani, 2103. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë si anglisht, frëngjisht, armenisht, gjuhën e Azerbajxhanit, gjuhen bullgare, japoneze, ruse. Ai gjithashtu shkruan tregime dhe proza. Ai admiron Janis Ricos. Ai botoi revistën e tij të parë me poezi haiku të quajtur Haikum (Haiku im). Z. Aydemir është gjithashtu themelues dhe redaktor i Yitik Ülke Yayınları (Lost Land Publikime).

Libra: Sessizliğin Bekçisi (Shikuesi i Heshtjës) (Haiku, 2002, Hera Poem Library)

Dikenler Sarayı (Pallati i Thumbimit) (2003-2012, Lost Land Publications)

Aşksız Gölgeler (Heja pa dashuri) (Stories, Lost Land Publications)

Rüzgarla Saklı (Fshehur nga Era) (Poezi dashurie, 2007, Lost Land Publications)

Sonsuz Unutuş (Harrimet e Përjetshme) (Tregime të shkurtëra, 2012, Lost Land Publications)

Soğuk Yazgı (Fati i Ftohët) (Poezi dhe Haiku, 2014, Lost Land Publications)

Liba të botuar jashtë vendit:

Gölü Emen Mektup (Letra që Absorboj Liqenin) (2005, Azerbaigjan, Paralel Şiir Kitaplığı) (2005, Azerbaijan, Parallel Poem Library)

Aşksız Gölgeler (Hije pa dashuri) (2013, Gjermani, Binooki Verlag)

Tregimet qe ka përgatitur:

Cunda Öyküleri (Rrëfimet e Vështira) (Eylül 2006, Yitik Ülke Yayınları) (Shtator 2006, Lost Land Publications)

Ekşi Öyküler (Rrëfimet e Tharta) (Maj 2007, Yitik Ülke Yayınları) (Maj 2007, Lost Land Publications)

Bozcaada Öyküleri (TRrëfimet e tendosura) (2009, Lost Land Publications)

Olimpos Öyküleri (Rrëfimet Olimpike) (2010, Lost Land Publications)

80'lerde Çocuk Olmak (Të jesh fëmij në 80-tat) (2010, Lost Land Publications)
90'lar Kitabı (Libri I 90-tave) (2012, Lost Land Publications)
Tuhaf Alışkanlıklar Kitabı (Libri i Zakoneve të pazakonta) (2012, Lost Land Publications)
Mutsuz Aşk Vardır (Tregime të hidhura Dashurie) (2014, Lost Land Publications)
Yitik Öykü (Rrëfimet e humbura) (2014, Lost Land Publications)

HAJDE, ZGJOHU

Po shikoj në foton tuaj
Hijen tënde lakuriq
është një flutur mikluese në terren

Natën e parë u zgjova me ty
Shiu kishte filluar të flasë
ia kisha ndjerë aromën trupit tënd

Lule ime e gjumit,
Si kërkove flokët tua
E Mendova harabelin jofluturues

ku tani
A është pasqyrë jote e vogël
Kjo na bën të harrojmë çdo gjë?

NË THELLËSITË

I.
Ylli i ftohtë
I fshehur në trupin tim
është për ty
Zëri yt është era
Dhe duart tuaja gjumi
I njëjta Diell
i Cili na ngrohë të dyve.

II.
Kam dëgjuar të deti
Shkoi në tokë
Uji tërheq zemrën time.
III.
Më jepni butësi

Skajet e natës
Me ardhjen e ftohtë
Zogjtë janë çuar në migrimin
Era më kërrus
Kundër jush.

DIMRI I POEZISË

Ju po shpërndani pluhur mbi dëborë
sqepi i një reje shkurton rrahun e mjerë
Mendoni për të gjitha që ndodhin
Kuptojnë stalaktitet së është zemëruar me diellin
Babai juaj është dehur, atje është një kamion qymyr
përpara shtëpisë
Kuptoni, lotët e tu nuk do ta shkrijnë këtë borë.

Përktheu nga anglishtja: Jeton Kelmendi



Silke Liria BLUMBACH (GJERMANI)

Silke Blumbach, me emrin e saj shqiptar Liria, u lind më 13 dhjetor 1970 në Göttingen, Gjermani, në një familje mësuesish. Filloi së shkruari poezi në moshën 8 vjeçare.

Mirëpo, depërtimi i saj erdhi pasi mjeshtroi gjuhën shqipe.

Si e huaja e pare që shkruante shqip, ka botuar tre libra me poezi dhe një ditar në gjuhën shqipe si dhe një libër me poezi në anglisht.

- Dyzet vdekje në Sarandë, Tiranë 1999
- Karavela e fundosur, Tetovë 2002
- Lumi që rrjedh drejt burimit, Tetovë 2007
- Ditari i një kthimi, Tiranë 2010
- Beyond the Bows of the Heart, SHBA 2012

Poezitë e saj, që u botuan në revista dhe gazeta letrare të vendeve të ndryshme duke përfshirë revista internet, u përkthyen në boshnjakisht, rumanisht, odia (një gjuhë e Indisë) dhe kinezisht, ndërsa ajo ka shkruar edhe poezi në frëngjisht, spanjisht, gjeorgjisht dhe hungarisht. Ka fituar një sërë shpërblimesh letrare, veçanërisht, por jo vetëm, në botën shqiptare. Është anëtare e Drejtorisë së Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" në Tetovë. Fjalët janë edhe në qendër të jetës profesionale të Silke Blumbach si përkthyese.

"Momentalisht lufton me kancer". Jeton dhe punon në Berlin.

MËNGJES NË ALLIAS

Në mëngjes, në lagjen e Alliasit,
ku poshtë ballkonit fillon deti i Sarandës,
me çaj mali dhe vezë me rigon në gojë,
me këngët e stërgjyshërve prej radios në vesh,
lundron ti nëpër mjegullat e hershme,
e përqafuar nga dielli.

Ti ende nuk di ç'janë përrallat, vashë,
se ato viset e kënduara s'i gjen në asnjë vend ne dhe
përveç hartës së labirintit tënd të brendshëm.
Kuptimi do të vijë si plumb. Do të të shpojë
krahët e bardhë engjëllorë. Do të vdesësh
dyzet vdekjet e Sarandës.

Por tani për tani më të bukur nuk ka
se këtë mëngjes të fundit në Allias,

ku poshtë ballkonit të Ballkanit
fillon deti Jon.

UNË JAM

Jam delja në barin e bjeshkëve dhe shqiponja në erë.
Jam vdekja dhe jeta në rrugët e bujshme të Tiranës.

Gojat që bërtasin dhe eshtrat që heshtin në Kosovë – qenkam unë.
Dëshpërimi dhe shpresa në qindra sy në anijet e urisë që mbyten – qenkam unë.

Jam ylberi në liqenet e helmuara vajguri ne Ballsh.
Jam peshqit e ngordhur në Lanën që mbaroi të jetë lumë.

Rrjedhja irreale me bukuri frymëmarrëse të Vjosës – edhe kjo qenkam unë
Edhe dallgët vezulluese në bregun e harrueshëm të Sarandës – qenkam unë.

Jam njëmijë mitra shqiptare të kolonizuara prej lufte dhe patriarkati
Po jam edhe fuqia e Teutës, Shota Galicës, Ajnishahe Shalës dhe shoqes sime Mrika në Allias.

Ndonjë ditë trupi im do kalbet për t'u bërë njësh me të dashurën tokë shqiptare
Por nga gjoksi do të ngritet shpirti im me krahë të artë shqiponje
Për t'u shkrirë përherë me Diellin e Artë.

KOSOVA DHE UNË, DUKE U ZGJUAR NGA NJË ËNDËRR E LIGË

Mirëmëngjesi, Kosova ime.
Unë di që ti nuk fjete mirë.
U përpëlite, rënkove në ëndërr.
Vdekja të ndjek deri në shtratin
e natës paqësore.
Por jemi zgjuar bashkë, jemi zgjuar!
Të hamë një kokërr veze. Të pimë kafe.
Pije dhe shih pak nga dritarja.

Do ketë pemë e lule. (Do ketë jetë.)
Edhe këtu.

Për sa kohë do ta mbajmë tmerrin në palcë?
Mos, mos u kujto, Kosova, moj.
Erdhi mëngjesi ynë me diellin dhe cicërime.
Kemi harruar si shijohet jeta
E cila dukej si një ishull shumë i largët.

Por ne jetojmë! Jetojmë ende!
Mos e harro dhe merr frymë thellë.
Shih, prapa perdes na fillon pranvera.

Do kthehen dallëndyshet. (Do kthehen shpresat.)
Edhe këtu.

FSHAT SHQIPTAR

Fshati ynë ndodhet nëntëqind kilometra mbi detin
Si kështjellë e pamposhtme në mes të reve,
Ku edhe shqiponjave u është tepër i hollë ajri.
Por ne e ndërtuam në kohën ilire, se diellin e donim,
Për t'i banuar më afër. Edhe
Për shkak të shpendëve, ishim në garë, në kohën e motshme,
Kështu na këndojnë rapsodët në sofër midis resh,
Garë se kush ngre folenë më të lartë. Fituam ne.
Pastaj na hynte shumë mirë në punë kjo pozitë strategjike.
Shtëpitë tona nuk u dogjën. Gratë tona nuk u përdhunuan.
Foshnjat tona nuk u nxorën me shpatë nga mitra.
Po shqipen tonë, sa e ruajtëm, sa më të kulluar nuk ka poshtë në dhe!
Por aman, aman! Nëntëqind kilometra larg detit!
Përrallat tona nuk flasin për kuçedra, për zana apo xhuxhmaxhuxhë,
Por për rrjetet e plota të peshkatarëve. Për perlat në mes të guaskave
Dhe për delfinin që shpëtoi një detar.
Aman, aman! Nëntëqind kilometra larg detit!

RRAFSHI I TETË[1]

Pëshpëritej në kohën e yllë, kur mështekra para shtëpisë së gjyshit përkulej në erë
Se në një vend të pjerrët shtrihet rrafshi që nuk është si të shtatë rrafshet e tjera,
Pëshpëritej dhe dëgjoja me gishtin në gojë pranë sobës nën pemën e Vitit të Ri
Të stolisur me ar dhe me engjëj. Rrafshi i tetë me qenie të çuditshme
Nga mish dhe gjak dhe plumb dhe shkronja.

Jetonim në rrafshin e tretë me dele dhe keca, grurin dhe gurin,
Kurse i dyti rrafsh ishte i kaltër si sytë e mi në një mëngjes prilli
Dhe si zjarri i metaleve pa vlerë në orë mësimi të kimisë
Dhe aq i lëngët sa pështyma. Dhe anije kishte, më shumë se ëndrra, më të mëdha.
Andej gjendej rrafshi i parë. Ai i pafjalë.

Katër dhe pesë: nuk di gjë. Flija gjumë kur m'i këndonte gjyshja.
Më i bukur ishte rrafshi numër gjashtë krejt vrima-vrima,
Me bimë që më shumë se luleve, iriqëve u ngjanin,
Por kokën e pushova në Rrafshin e Kosit, në Rrafshin e Kosit, në Rrafshin e Kosit
Te bardhë, të butë, ku malet janë nga djathi dhe lumenjtë nga qumështi.

Po pëshpëritej pranë sobës së yllë në kopshtin e argjendtë të gjyshit të humbur:
Rrafshi i tetë, ai rrafsh të pret, veç dy herë në jetë, qofsh argat ose mbret,
I teti rrafsh plot me kafshë, me mëndafsh, rrafsh me afsh,
Kështu pëshpëritej e flitej thirrej bërtitej, dhe fjalët më hynë në veshët si shigjeta,
Pra kosin e tunda nga çizmet e mia dhe ika dhe erdha dhe qenkam këtu.

[1] "ova" = turqisht për "rrafsh". Poezi kushtuar Tetovës

Bisera Suljiç-BOSHKAILO (BOSNJË E HERCEGOVINË)

Bisera Boshkailo është lindur më 9.01.1965 në Tutinë. Është doktore e shkencave filologjike, gjuhë gjermane dhe ligjëruese e gjuhës gjermane në Ingolstad të Gjermanisë. Nga viti 2008 është ligjëruese dhe shefe e katedrës për Gjuhë gjermane në Universitetin ndërkombëtar në Novi Pazar. Është artiste e lirë dhe punon si përkthyese, gazetare dhe letrare.

Kritikat letrare dhe punimet shkencore i boton në shumë revista të njohura në vendet e ish-Jugosllavisë dhe Gjermani. Ka përkthyer edhe disa autorë të njohur gjerman. Ka të fituar dhe çmime të ndryshme letrare në vend dhe jashtë saj. Veprat e saj janë të përkthyera në gjermanisht dhe turqisht. Është anëtare e autorëve boshnjak, shoqatës së autorëve gjerman dhe shoqatës së gazetarëve boshnjak.

Vepra të botuara: "Vallja e Vilinës"- poezi, "Goli Otok"- roman, "La perla"-roman, "Shpella"- roman, etj.

NËNA IME

A ka zemër
Ai shpirt në sexhde
Që Allahut
Me përkulje i lutet?

Sa është? Si është?
Si rreh? Si frymon?
Me ç'e shëron
Nga plagët e zjarrta?

Pesë kohë ajo lutet!
Gjersa fshehurazi
Përmbi libër e vështroj,
Unë jam e lumtur që jam e saj!

Gurrë ka zemrën!
Jo, të ishte gurrë
Do copëtohej në copëza!
Kur të shihte mjerimin e fëmijëve!

Lumë ka zemrën!
Jo të ishte lumë

Do shterej
Sikur lotët e saj të rëndë!

Nëna ime nuk ka zemër!
Nënës sime në vend të zemrës
E mbuluar nga provokimet
Qëndron dashuria ndaj të Gjithëfuqishmit!

BOSNJA E PAKOHË

Unë jam nishani yt
Tokë e mirë
Në furtunë e erë
Kalorës i palëkundur
Në dashuri dhe ëndrra
Roja jote shekullore!

Unë jam kufiri yt
Që mes qiellit dhe tokës
Sjell motet
Drejt dhe krenar
Dielli i mirëpritur
Për zambakë të artë!

Jam vula jote
Amaneti i gurtë
Nga Zoti i dhënë
Në dijeni të t'gjithëve
Se je e pakohë
Nga më të mirat Atdhe!

MOS MË PRIT MË I DASHUR

Mos më prit më
Në fund të udhës sate
Mos m'ëndërro
Tri shënime të arta

Unë nuk do të vi më
Që të t'zgjoj dashurinë
U shter më burimi
Ndër drurin e çmendur

Mos më prit më
Në fund të udhës sate
Mos m'i ëndërro më

Tri shënime të arta

Ti ishe i dashur
Vetëm qafore shkëlqyese
Për qafën time
Margaritarë i radhitur

Mos më prit më
Në fund të udhës sate
Mos m'i ëndërro më
Tri shënime të arta

Unë nuk do të vi
T'më dashurosh në prehër
Tashmë shpejtoj te tjetërkush
Rrugëve të diellit

Përktheu: Artan Arsllani

Mujë BUÇPAPAJ (SHQIPËRI)

U lind më 1962, në Tropojë. Është diplomuar për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës. Ka kryer studimet pasuniversitare për skenar të filmit artistik pranë ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", sot "Albafilmi." Aktualisht është duke përfunduar studimet e doktoraturës në degën e shkencave letrare në Qendrës Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Mujë Buçpapaj është një figurë mjaft e njohur dhe e spikatur në fushën e artit dhe letërsisë. Ai është autor i shumë librave, por edhe i qindra shkrimeve publicistike, kritikave, eseve, studimeve , si dhe përkthimeve kryesisht nga poezia bashkëkohore amerikane. Është autor i disa përmbledhjeve poetike, eseve dhe studimeve, një pjesë e të cilave të botuara në disa gjuhë të huaja. Si një nga poetët më të mirë bashkëkohorë ka fituar disa çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Më 2009 Shoqata e përkthyesve të SHBA-ve, dhe shoqata e bibliotekave publike te SHBA-ve, i jep Çmimin e parë për librin "THE INVISIBLE VICTORY", si libri më i mire i botuar në anglisht nga gjuhet e huaja. Libri iu rekomandua studenteve të universiteteve për t'u lexuar.

Më 2010 Revista prestigjioze amerikane " Translation Revieë" e cila botohet prej 30 vjetësh nga Universiteti i Teksasit në një numër të saj shkruan një studim të gjatë për poezinë e M. Buçpapajt. Revista më e madhe në botë për përkthimin nga gjuhet e huaja, vlerëson "THE INVISIBLE VICTORY", si libri më i mirë i botuar gjatë atij viti në anglisht.

Në nëntor 2012 libri i fundit i poetit Mujë Buçpapaj "The invisible victory" fitoi çmimin e librit më të mirë i cili qarkullon ndërkombëtarisht nga Organizata Ndërkombëtare Kulturore "Kafeja e ideve" në Selaminë të Athinës. Arsyet e dhënies së çmimit i referohen kontributit të tij në poezi. Shkrimtari krijon një shkollë të re poetike model në ndërtimin e vargjeve dhe përshkrimit të përvojave të vështira, të cilat ndërthuren bashkë nëpërmjet vargjeve, që kërkojnë analizë të thellë në mënyrë që të bëhet e kuptueshme rëndësia e kuptimeve dhe vargjeve të cilat hapin rrugë të reja të shprehjes poetike."

Në Qershor 2014 Organizata Ndërkombëtare Kulturore "Kafeja e ideve", dhe UNESKO i kanë dhënë poetit M. Buçpapaj çmimin "Aleksandri i Madh i Artë", çmim i fituar tre vjet më parë edhe nga poeti i mirënjohur shqiptar Ali Podrimja. Në vitet 2005-2012 M. Buçpapaj ka qenë drejtor i përgjithshëm i Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "P. Arbnori." M. Buçpapaj gjatë

periudhës korrik 2012 prill 2014 , ka qenë drejtor i Zyrës Shqiptare i të drejtave të Autorit, Tiranë. Aktualisht është drejtor i gazetës javore, letrare dhe kulturore "Nacional", dhe drejtor i Qendrës Kombëtar e Kulturore Nacional në Tiranë, një sipërmarrje private e tij dhe e vëllezërve Buçpapaj, të njohur si poetë, shkrimtarë, përkthyes, publicist dhe studiues të shquar të letërsisë.

ADRESAT JANË PREJ AJRI

Adresat janë prej ajri të shkruara, prej zërash të tejm
që thërrasin lavdinë e të dashuruarve të nxituar, të verës.

Nëpër to, do të të gjejë në agjendën e qytetit të fshehtë të
Zërave të ngritur të lagjes, në pushim të zënkave të erës së
Tabelave që mbajnë mbishkrimet e syve tu, të qiellt
Në perëndim të diellit të botës, në muzg të qytetit
Duke rendur do të gjej,

Do të të ngre lart në metaforat e duarve, të ajrit
nëpër afshin tënd të prekshëm të adresës virtuale
të ëndrrës,

Do të shuaj zjarrin e rënë në provincën e pluhurt
Të botës indiferente të pamjes që meriton stuhinë.

Adresat janë tortura e të panjohurve që rendim pas
Ëndrrës, në qytetin e vogël të lumit shërues, të shelgjeve të
Mbrëmjes, deri në premtim,
Të burrit të pathyeshëm të fjalës.

Do të gjej edhe pa adresë në këtë mjegull të zërit tënd
Dhe lëkundjes së malit pëshpëritës të pendimit.

Do të të tregoj si bëhet dashuri me hijen e malit
pushtues të
Kohës, deri tek të fshehtat tua të parrëfyera kurrë,
dritës së muzgut të ndriçuar.

Tiranë, korrik 2014

JO VETËM HAPAT

Jo vetëm hapat po të sjellin pamjes së qartë
të vendimit për të dashur malin, me rrufetë,
mjegullat dhe stuhitë e tundimit.

Do ta lehtësoj rrugën gjurmëve të fjalës së
Së mbajtur sipër rrafshit të ngjyrave të prekshme.
Në të dalë të orës së hapave të padukshëm
Të qiellit do të pres të të rrëfej atë që mundon
Udhëtarin,

Një strehë të qetësisë së ëndrrës dhe idilin
E dashurisë për botën si një orë mësimi në
Klasën e provincës së shfaqjes
Së fundit

Jo vetëm hapat po të sjellin në ditën e papritur të
Premtimit të dashurisë, të shenjës së botës
Së kalendarit të poetëve që nuk vijnë prej rrugësh
Por prej dritës së qiellit,
Me mallin e shiut, me erën, me zjarrin përvëlues
Për të ndezur malin, prej heshtjes së dyshimit.

Tiranë, korrik 2014

KUR THUA TË MË PRESËSH

Kur thua të më presësh nata bëhet e pakuptimtë nga
Hapat e padukshëm të imazhit tënd,
si një pemë e çelur nga shiu
Dhe vështrimi i dritareve të shtëpive të lagjes,
të ndërtuara nga dashuria
Britmat e fëmijëve dhe tundimi i nxitimit për të hyrë në mal
Pa zhurmën e rrënjës sipër krahëve të mi.

Dhe prapë do të të pres, të vish me vrull si një
lumë, luginës së fshehtë të
Të ndezur të kodrave të pamjes,
për të pirë në burimet tua hijen e pemës,
Të frutave të çara të jetës,
dhe aromën e periferisë së pritjes,
Luginës së trëndafiltë do të zbres si rojtar i parkut,

Do t'i numëroj në një inventar
furinë e dorëzimit tënd të metaforave,
Para stuhisë që rrezon pemët.

Në krahët e mi do të mbaj sipër botës
Për gjinjsh të artë të verës,
si një mbretëreshë do të vish për fjalësh
Të forta, të vuajtjes së dhënies së lajmit,

Rrotull një qielli që vetëm ty të pëlqen, me ngjyrat,
me shpendtë, dhe rrugët e
E pamjes së qartë të ajrit mikpritës, që zbret pemët
poshtë për t'i vjelë
Nga rojtari i padukshëm i qiellit,
për të ushqyer ëndrrën me
Lëngun e afshit të frutave të çara nga vera e pjekjes së diellit
Brigjeve të lumit të kthyer nga udhëtimi me gjithë
qytetin
E skicuar të dashurisë së përflakur të stinës,
me manaferrat, barishtet, shelgjet
E përkulura të pritjes që dridhet në erë.

Dhe prapë do të të pres, të vish tek unë me vrull,
Si një lumë valësh, dëshirash,
Zogjsh që humbin gjurmëve të malit, freskisë
Së burimit të një dite të plotë, për t'u prehur
Dhe ringjallur…

Tiranë, korrik 2014

Laure CAMBAU
(FRANCË)

Laure Cambau jeton në Paris. Si pianiste shoqëron këngëtarë lirikë dhe merr pjesë në recitime poetike me improvizime muzikore. U ftua në Festivalin e Poezisë Ndërkombëtare "Trois-Rivières" në tetor 2002, në Takimin e Poetëve të Botës Latine në Morelia, në Panairin e Librit të Meksikës, 2003, në Festivalin e Strugës, 2007 dhe në manifestime të ndryshme poetike në Francë dhe jashtë.

Ka botuar "Bulevardë lunatikë" (shtëpia botuese "Brocéliande", 1998), "Njeriu në vaskën e ujit", vijuar nga "Retë e kohëve të rëndomta" (shtëpia botuese "L'Amandier", 2001), "Latifa, vajza e vogël që qante fjalë" (përrallë muzikore, muzikë nga R. Gagneux, shtëpia botuese "Durand", 2000), "Po bakshishi I engjëjve?" (shtëpia botuese "L'Amandier"), 2005), "Thika në përqafim" (qershor 2007, shtëpia botuese "Phi", Luksemburg, bashkedicioni "Ecrits des Forges", Québec) si dhe libra artistësh (me J. Vimard, M. Cambau etj.). Shkrimet e saj gjenden në shumë revista dhe antologji (Seghers 2008 etj.) dhe disa janë vënë në muzikë.

PESHKATAR

Mrekullia mbahet veç në një fill
ku ti var
nga një breg në tjetrin
peshq dhe koka
virgjëresha dhe barinj
një lot alkimik
mbledhur mbi faqen e lypësit
ti nuk mund të mos nderësh jetën
në të bardhën e virgjër

VAJZA QË SHET FRUTA

Ti lan xhamat
po zjarri të kap sërish gjithnjë
në qytet si dhe në stallë
duke djegur dhi revista
xhingla dhe kujtime të kryeqytetit
duke djegur ujq dhe fshesa
dhe një magjistar do të humbte aty
në këtë të përditshme të padjegshme

ti e vendos fytyrën time në një kornizë
një maskë u vendos hajdutëve
fruta fëmijëve
trungje për rrugën
ti mbjell turbullimin
e një diçkaje përtej të padjegshme
në të kuqen tënde dhe në sytë e mi.

KOKË

Kokave dua tu jap fjalë
por fjalët nuk mund t'i detyrojmë
të pushtojnë ikonat
nuk mund t'i dëndim kokat me fjalë lutjesh e poezi dashurie
nuk mund t'i detyrojmë fjalët të hyjnë në një gojë memece
veç mund të pyesim ëndrrat
të vëzhgojmë zorrët e pulës
ose të lexojmë në fundin e filxhanëve
unë kërkoj parfumin e kokave
kërkoj aromën e të bardhës

Germain DROOGENBROODT (BELGJIKË)

U lind në Rollegem, pjesa flamane e Belgjikës, ku Gjermanishtja është një prej gjuhëve zyrtare. Në vitin 1987 ai u shpërngul në fshatin mesdhetar të artistëve në Altea, dhe u integrua në jetën letrare spanjolle.

Germain Droogenbroodt është një poet i vlerësuar në arenën ndërkombëtare, e po ashtu i njohur si përkthyes, botues dhe promotor i poezisë moderne në botë. Njohës i gjashtë gjuhëve i përfshirë në më tepër së 30 botime në poezinë Gjermane, Italiane, Spanjolle, angleze dhe Franceze.

Si themelues dhe botues i POINT editions, (poezi botërore) ka botuar më shumë se 80 përmbledhje të poezisë modern. Në 1996 ai themeloi lëvizjen të njohur si Neo sensacionismo, me poetin e famshëm kinez, Bei Dao dhe Duo Duo.

Germain Droogenbroodtka udhëhequr festival të ndryshme të poezisë në Spanjë.

Poezia e tij është e shumanshme. Pas debutimit të parë me "Dyzet në mur', (1984), e përcaktuar si poezia e re romantike. Ai botoi; 'A e njihni vendin?', meditime në Liqenin e Komos, Itali, një përmbledhje e poezive të natyrës. Në vitin 1995 atij ju akordua bursa Hawthornded, (Skoci), ku shkroi: ' Biseda me të pranishmin', poezi rreth vdekjes, të vlerësuara me çmimin P.G. Buckinx-Prize.

Një kritik zyrtar i zyrës së bibliotekave e ka përshkruar poezinë e tij të dashurisë si 'poezi virtuoze'. Në fund të viti 1997 u shfaq 'Njëzet e pesë dhe dy poezi dashurie', dhe në vitin 1998, 'Midis heshtjes së buzëve të tua', përmbledhje e poezive të dashurisë.

Libri i tij me poezi, "Në rrjedhën e kohës', meditime mbi Himalajën, u botua në 2008 në Belgjikë, dhe si botim me " Poezi të zgjedhura nga Germain Droogenbroodt" në Shangai dhe në Spanjë . Laureat i çmimit XXIX Premio de Poesía Juan Alcaide 2008. 'Mbrëmjet Strugane të poezisë', botuan një përzgjedhje të poezisë së tij në Plejad 2010.

'Në rrjedhën e kohës', është përkthyer dhe promovuar në Kioto, nga Fondacioni Ndërkombëtar i Kiotos, Japoni 2010, dhe në Gelik, Irlandë 2012. Një përzgjedhje e poezive të tij është botuar në Bangladesh n2 vitin 2012.

'Dritë pahije', libri i tij i fundit me poezi u promovua në 2012, si një botim dygjuhësh, Gjermanisht Spanjisht në panairin e librit në Antuerp, dhe në shumë qytete të ndryshme të Belgjikës dhe Spanjës. Germain Droogenbroodt, është shpesh i ftuar për lexime dhe konferenca në universitete të ndryshme dhe festival ndërkombëtare të poezisë në botë. Atij i është akorduar grada

Dr. në Letërsi në vitin 1990 në Egjipt, ku edhe është vlerësuar me çmime të ndryshme letrare.

ITAKA

Me kokën si lulëkuqe ëndrrash
Dielli pikturon një tjetër ditë
Shpërndan dritë
Tej mbi kurorë malesh
Që mbështjellin Mesdheun
Një det perlash dhe argjendi
Ngjyros parajsën
Blu dhe të bardhë
E fshin prej kokës
Ashpërsinë e kujtimeve

CIKËL

Asgjë nuk zgjat
Në tokë a univers

Retë bëhen ujë
Dhe uji lumë

Uji i lumit
humbet në det

avullohet
dhe retë përsëri
bëhen ujë

KUR RETË

Ndalojnë së qenuri re
Shpërndarë ajrit

Forma që zhbëhen ngadalë
Lejnë pas

Në blunë e pafundme
lagështinë
Prej së cilës nisi gjithçka

Përktheu nga anglishtja: Entela Kasi



Shaip EMËRLLAHU (MAQEDONI)

Shaip Emërllahu u lind më 13 prill 1962 në Trebosh, Tetovë. Fakultetin Filologjik, Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Magjistroi në letërsi në Universitetin e Tiranës, në temën "Struktura e poezisë së Azem Shkrelit". Ndjek studimet për doktoraturë. Është mësimdhënës në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Botoi vëllimet me poezi "Pagëzimi i viteve", 1994, "Projekti i thyer", 1997, "Vdekja e paktë", 2001. Më vitin 2001, "Akademia Orient - Oksi¬dent" në Bukuresht ia botoi në gjuhën shqipe dhe rumune vëllimin me poezi "Vdekja e paktë / Putina moarte" (Përktheu L. Topçiu). Në vitin 2004, PEN-i kroat dhe Shoqata e Shkrimtarëve Kroatë ia botojnë vëllimin dygjuhësh kroatisht/ shqip me titull "Poezi" (Përktheu M. Vikers). Në vitin 2004, Sh.B "Feniks" nga Shkupi ia botoi në gjuhën maqedone librin me poezi të zgjedhura "Dvorski son" (Përktheu A. Selmani). Në vitin 2000, në bashk¬autorësi botoi librin me dëshmi të masakrave në Kosovë "...edhe ne dëshmojmë/We Witness", Sh.b. "Ditët e Naimit" (shqip-anglisht). Shtëpia botuese italiane "La stanca del poeta – 57" në vitin 2009, ia botoi vëllimin me poezi "Stracci di vita", (nga anglishtja përktheu G. Napolitano), ndërkaq, po atë vit i botohet në gjuhën angleze libri poetik "Life's Rags" (Përktheu E.Zaimi/C.Czury). Cikle poetike të tij janë botuar edhe në gjuhën frënge, angleze, hebraike, spanjolle, arabe, rumune, turke, polake, çeke, kroate, maqedonase etj. Poezia e tij është përfshirë në disa antologji ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në festivale poetike ndërkombëtare dhe ata vendore. Është nderuar me disa çmime letrare. Ka punuar gazetar në mediumet elektronike dhe të shkruara, brenda dhe jashtë vendit. Për disa vite ka punuar redaktor i Rubrikës së kulturës në të përditshmen "Flaka".

Është themelues dhe drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë 'Ditët e Naimit'.

PRANVERË JETATDHEU

heshtja monotone e dhomës
torzohet nga furia e rebelimit të kohës

dera e meditimeve
nën hovet e emocioneve dykrerëshe
hapet dhe mbyllet

një dashuri dyzemrash së një krahërori
ka dalë në mal

pranverë Jetëatdheu

1989

UDHË PA KRYE

po s'u kape për rrënjë jete
valët e hazdisura të marrin para
oxhakun tënd në nevojtore
e kthen Korbi i Alan Posë
pëllumbat as përreth s'fluturojnë

kahja e gishtit tregues
kah ti
është më e keqe se arma
ajo të shteron zërin si në ëndërr
e mbytesh djerse
në kërkim shtegdaljeje
damka në ballë
është e neveritshme
si buzëqeshja e pushtuesit
mbase për një mulli uji shkon

udhët pa krye
gjithmonë shfrytëzohen
nga kryet pa udhë

1988

KAH PO SHKOJMË

bishti i natës
mbeti për çerdhe buklash

gjethi i mëngjesit
plasi me zor

kah tash?!

1994

Galina GANOVA (BULLGARI)

Lindi me 12 Shtator 1967, në qytezën e Provadia, Provinca e Varnës. Ajo jeton dhe punon në Vratsa dhe ka dy fëmijë.

Ajo është autore e këtyre librave:

2000 - „Zogu fluturimth"/ Птицаокрилена/ – poezi

2002 - „Si një moment" /Катомиг/- poezi

2004 - „Në gjurmët e verës" / Подирстъпкитеналятото/-poezi

2008 - „Vizionet" /Видения/-poezi

2008 - „Në rrugët e Evropës"/Попътищата на Европа/, shtëpia botuese „Bulgarian writer" -travelogue

2008 - „Këmisha qiellore" /Однебокошуля/, Podgoricë, përkthim në serbisht nga poeti malazias Veselin Rakchevich

2011 - „Më jem një kujtim" / Подаримиспомен/- poezi

2011 - „Kujtimet nga Krastina Bara" /Спомениот Кръстина бара/-sage ancestrale

2014 - „Në një frymë" /На единдъх/Наодномдыханий/- poezi – libër në dy gjuhë origjinal dhe përkthim në bashkëpunim me Poetin Rus Roza SHORNIKOVA

Galina GANOVA është fituese e shumë çmimeve nacionale. Ajo ka qenë anëtare e shoqatës së poetëve Bullgar që nga 2004. Punon jashtë këshillit kryesor, Vratsa të drejtat e autorëve dhe asiciacionin historik lokal.

PSE NUK

Fillojnë nga fillimi
Në një qytet të vogël, të shkretë
Me dredha-dredha rrugët dhe një kafene të vë në gjumë
Jeta jonë e re dhe e vërtetë ende shpikur.

Do të jetë një takim i rastësishëm
Në një shesh të papërshkrueshme dhe heshtur,
Do të jem i panjohur, misterioz, joshës
E ju do të jeni jo më shumë se një i huaj.

Dashuruar, do të prisni për mua rrugën e modës së vjetër,
Duke sjellë lule të kuqe dhe pasion përhapën,
E në kinema të vjetër që ju do të mbani dorën time,
Nëse kam qenë i pazëvendësueshëm.

Do të marrim me qira një shtëpi me një tarracë
dhe një thupër argjendi aty pranë,

Dhe ne do të shkruaj romancë tonë të ri ...
Pse nuk filloni atë të gjithën nga fillimi -
Ata thonë se - ne të gjithë e meritojnë një shans të dytë ...

PA TY

Jam duke qëndruar. Nuk jam në asnjë nxitim.
Nuk presin mua, nuk bëni kujdes, e di.
Në këtë natë me yje, të heshtur jeni me një tjetër,
Ose, akoma më keq, nuk bridhni vetëm?

Në këtë tryezë tani, në mënyra të ndryshme, në mënyra të shkëlqyera
Dhe e zhurmshme bota është -
Dikush thotë diçka me zë të lartë,
Pastaj të qeshura të përzemërt derdh.

Po përpiqem për të qeshur në përputhje me rrethanat,
Ndërsa duke dëgjuar bisedat.
Ka pak dyshim mendja ime është e përhumbur -
Në çudi sytë e tyre janë të ndezur.

Jam duke lënë, por nuk jam në nxitim për të lëvizur
Ende duke shpresuar për të përmbushur në shtëpi rrugën time.
Është e padobishme të gënjesh veten -
Në këtë tryezë, pa ju, unë jam vetëm.

KOZMIK

Jam një planet në një qefin me re
Diku në kanavacë ngjyra e yjeve;
Një trup delikat, forca ende magnetike
Dhimbje dhe dashuri – e tëra në një.

Çfarë jeni ju që po vjen tani -
Një Universi i ri, një kometë e çrregullt?
Çfarë do të më çosh në buzëqeshjen tënde -
Dashuri Qiellor apo dhimbje të kësaj bote?

Nëse nuk jeni më shumë se një Hënë e zbehtë,
Ju do të digjeni në orbitën time...
Mund të jeni si agimi,
Mund të jeni si Dielli– më magjeps!

(Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj)

Laura GARAVAGLIA (ITALI)

Laura Garavaglia është e lindur në vitin 1956 në Milano. Tani ajo jeton dhe punon në Komo. Ka kontribuar në faqet kulturore të disa gazetave kombëtare dhe lokale: Il Giornale, Il Coriere di Como, "L'Ordine". Ajo gjithherë ka qenë e interesuar në poezi. Maurizio Cuchhi e rekomandoj atë në vitin 2010 për poezitë e saj të pabotuara në kolonën me emrin "Dialoghi in versi" (Dialogje në vargje) në gazetën italiane "La Stampa. "

Nga poezia ajo ka botuar: Frammenti di vita –Fragmente të jetesë (Il Filo 2009), çmimin e dytë "Opera Prima Edita" në " Circe Award, one Woman, Many cultures ", Monterotondo (Rm); Farfalle e Pietre -Fluturat dhe Gurët-, (LietoColle Editore, 2010); Çmimi i jurisë në konkursin letrar "Alda Merini", Brunate (Co), e përmendur në çmimin letrar Albero Andronico, Romë, 2011, La simmetria del gheriglio, Stampa Editore, 2012 finaliste në Çmimin Ndërkombëtar të Poezisë "Mario Luzi. " Libri i ri i poezive, Correnti ascensionali, CFR 2013.

Poezitë e saj, janë vlerësuar nga shumë poetë të rëndësishëm italian, të tillë si: Maurizio Cuchhi, Giancarlo Majorino, Milo De Agelis, Giampero Neri, Mario Santagostini, Gilberto Isella, Vivian Lamarque, Donatella Bisutti, Piera Mattei.

Poezitë e saj janë futur në disa antologji (Il sapore di una fragola, a cura di Paolo Lagazzi e Patrizia Trimboli, Quadernario Blu, Lietocolle 2012 a cura di Giampiero Neri e Vincenzo Mascolo, Alfabeto Animale a cura di Eloisa Guarracino, Zanetto, 2011, il segreto delle Fragole, LietoColle, 2012, Arbor poetica LietoColle 2012, the Antology of Mario Luzi Award 2013, L'amore Dalla A alla Z . I poeti contemporanei e il sentimento Amoroso, PuntoaCapo, 2014).

Ajo ishte e ftuar në Festivalet Ndërkombëtare të Poezisë në Kopenhagë, në Rumani dhe në Zvicër. Ajo është autore e biografisë Franco Soldaini. I sapori della mia vita - Franko Soldaini. Shijet e jetës sime (NodoLibri 2011).

Ajo është anëtare themeluese dhe presidente e shoqatës kulturore "La casa della Poesia di Como" (Shtëpia e Poezisë së Komosë), www.lacasadellapoesiadicomo.it, që ka qëllimin e përhapjes së poezisë në të gjithë territorin e Komosë, nëpërmjet takimeve me përfaqësuesit e mëdhenj të poezisë italiane; poezi dhe muzikë recitale: shfaqje skene, prezantime të librave, shfaqje arti me përputhje të leximit të poezisë dhe me subjekte të lidhura të veprave të artit. Ajo është përgjegjëse e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Europa in versi" që zhvillohet çdo vit në Komo, ku ajo fton poetë, artistë, muzikantë, interpretues, etj më të rëndësishëm

ndërkombëtar. Ajo gjithashtu kontribuon në Festivalin Letrar "Parolario" dhe në ekspozitën e artit bashkëkohor Miniartextil, që zhvillohet në Komo çdo vit.

Ajo është anëtare e jurisë e Çmimit Letrar "Antonio Fogazzaro" dhe "Alda Merini" dhe nga ky vit anëtare e jurisë së një çmimi të ri Çmimit Letrar, "Premio Città di Como". Ajo kontribuon në organizimin e Festivalit Letrar "Parolario", i cili zhvillohet çdo vit në shtator, në Komo. Ajo shkruan kritike letrare në disa revista letrare on-line dhe bashkëpunon me disa shtëpi botuese. Ajo është drejtore e një koleksioni të poetëve të huaj të quajtur "Altre Terre" dhe të botuar nga Lieto Colle. Ajo është anëtare e PEN Club Italiano. Ajo mori pjesë në Festivalin Letrar Ndërkombëtar në Kopenhagë dhe ajo ishte e ftuar të merr pjesë në Fundatia Antares, Festivalin e Poezisë në Rumani.

Nga "Simetria e thelbit" (Stampa, 2012)

Koha mposhtë jetën
e tretet në pika të dendura
pikon poshtë që të le gjurmë të pasigurta
njolla që më pas do të zbehen.
Unë marr mbetjet e ditës,
nxjerr mishin nga fjalët tek kockat,
e thithi palcën, deri sa mundem.

Misteri i trashë kyç universin
mashtron botën:
galaktikat, yjet, shkëmbin, fletët ose frutat.
Pamja dënon-
Deri në pafundësinë e gjërave të kota.
Unë e dua shkencën që nuk le
vend për dinakërinë e kohës
të besimit dhe të ëndrrës.
Një mollë piqet, kalbet.
Por atomi mbetet, kthen
heshtjen e kozmosit.

Nga "Thermals" (CFR, 2013)

INDIKATIV I TANISHËM

A jeni edhe ju duke kërkuar linjat e universit
në mesin e gabimeve horizontale të ditës?
Çfarë nëse zeniti ishte në të vërtetë këtu
në parvazin e dritares mes vazos lulemine.

Hija e pasdites në shkallë,
në këtë mungesë heshtjeje për shkakun.
Ose: n'qoftë se koni i dritës do të ngatërrohej në bar
ky çast i kthyer-
i zverdhur
në mes të ardhmes dhe të kaluarës?

(Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj)

Brigitte GYR
(FRANCË)

Brigite Gyr u lind në Gjenevë dhe mban shtetësinë Franceze dhe Zvicerane. Është diplomuar për Ligje dhe Shkenca Politike dhe punon si juriste në Zvicër. Jeton në Paris që në vitin 1976, ku punon si përkthyese e Anglishtes, Gjermanishtes, Italishtes dhe Spanjishtes. Ka përkthyer 15 libra, midis të cilëve, ' Rrëfime të Tiresias', nga Andras Gerevich, një përmbledhje poezish nga anglishtja botim tregjuhësh nga botime Jackues Bremond, 2014.

Ajo gjithashtu organizon seminare të së shkruarit, shkruan parathënie librash, kontribuon në revista të ndryshme letrare si; Toka e Femrave' , 'Maja Letrare' dhe 'Les Carnets d'Eucharis, në Evropë.

Ajo ka botuar përmbledhje poetike midis të cilave: 'Në ndihmë endur', botime Jacques Bremond, 1988, 'Letra të dyfishta në fund të pusit', botime Jacques Bremond, çmimi Claude Sernet 2001, ' Kështjella e Hirit', botime Le Dé Bleu, 2006, 'Shtrirë në bosh', botime La Petite Fabrique, 2012, ' Bisedë e zhveshur', botime Lanskine, 2011, çmimi Charles Vildrac 2012, akorduar nga The Société des Gens de Lettres, 'E pasigurt në shënime të drejta', botime Lanskine, 2014.

Ajo shkruan drama, tregime të shkurtra dhe libra për fëmijë. Poezitë e saj dhe tregimet janë botuar në revista të ndryshme letrare, në Frëngjisht apo gjuhë të huaja.

Merr pjesë rregullisht në festivale ndërkombëtare të poezisë, në Algjeri, Lodevë, etj.

Ajo është gjithashtu anëtare e jurisë për disa çmime letrare si Chenouard, SGDL dhe çmimi Simone Carfort i Fondacionit të Francës.

Është e përfshirë në organizata të shkrimtarëve në Francë dhe Gjermani. Është Zv/presidente e Organizatës; the Union des Poètes & Cle.

I

Jam kthyer në vendin tuaj
Por ky vend nuk është më i juaji

Jetoni të tashmen
Në një vend të djegur
Me pemë të larta

Një noktrun nga Fauré
Ju shoqëron
Dhe ajo
Që dikur luante

Ky qytet ku u linda
Ky vend që mbart në vete
Më duken të huaj

Vendi im është gjithkund
çuditshëm nga një qytet në tjetrin
Dhe rrallë ndalet të pushojë
Nën hijen e shkurreve

II

Ato ditë
Në liqen
Pranë shtëpisë
Do të mbysja fjalët
Që ngultas
I kam në kokë
Do të flakja lodrat
Që luaja dikur
Në të vërtetë
Kisha frikë hedhur atje

A të kujtohet
Nata kur
Një kokë e lodhur
Shtrihej në barin
E kopshtit
lidhur kurorë trëndafilave tokës

në buzët e bashkuara
një litar i kuq
lidh fjalët
i kthen pas i mbledh

III

A dëshironi t'ju tregoj
Ju të cilin ne e quajmë ai
Ju të cilin ne e quajmë ajo
Si filloi gjithçka
Atë ditë

Pothuajse ditë e zakonshme
Një puhizë e lehtë
Erdhi nga toka
pëshpëriti në veshë
Butësisht
Pastaj
Kumboi e kumboi
Gjithë muzikën e tingujve
Përveç
Thelbësores
Muzikën rërës dhe gurëve
Dallgëve lëndën e universit
Kur qetësia ra
Ekskavatori
Nxori jashtë gjithçka të mbetur
E pamë në televizion
Nuk guxojmë të dalim jashtë

në buzët e bashkuara
një litar i kuq
lidh fjalët
i kthen pas i mbledh

Përktheu nga anglishtja: Entelsa Kasi



Foto: Victor Moreno

Adriana HOYOS (KOLUMBI)

Adriana Hoyos ka jetuar mes Amerikës Latine dhe Europës. E lindur në Bogota, nga një familje muzikantësh, ajo është trajnuar në moshë të hershme si violiniste. Kur ajo ishte vetëm njëmbëdhjetë vjeç, u shpërngul në Sabadell, Barcelona; e inicion adoleshenten e saj të parë duke zbuluar lexime të Lorcas, Gimferrer-it, Mallarmé-s, dhe Eliot-it. Menjëherë pasi arriti moshën madhore, ajo kthehet në Bogota dhe qëndron një kohë në një hotel të vogël, në mes të qendrës historike dhe boheme të qytetit, ndërsa ajo i bashkohet Orkestrës Rinore Simfonike mbijeton duke dhënë mësime violine. Studion letërsinë në Universitetin Javeriana, por kaosi i kryeqytetit dhe nostalgjia për vendin e vjetër e kthen atë mbrapa në Spanjë. Studion regjinë e filmit në Qendrën Catalunya të Studimeve kinematografike dhe merr pjesë në seminaret për Dokumentare dhe Shkrim Skenari.

Është regjisore e disa filmave të shkurtër:

"Elegia", 1998 / Fiction / 9 '/ Betacam, "HOTEL SANTA FE", 2001 / Fiksion

"BENEYTO DESDOBLANDOSE", 2010 / Fiksion-Dokumentare.

Në vitin 2000 ajo shkon në Madrid, ku aty prodhon më shumë se një njëqind reklama televizive dhe themelon kompaninë e saj La Huella del Gato.

E drejton që nga viti 2000 Festival Visual Cine Novísimo, e cila është bërë ekspozitë dhe platformë promovimi të krijimit audio-vizuale e pararoja më e rëndësishme në komunitetin e Madridit dhe një prej më të rëndësishmet në Spanjë.

Në vitin 2009 boton "La Torre Sumergida", March Editor, Barcelona.

Në 2013 boton "La Mirada Desobediente", Editorial Devenir, Madrid.

Shkrimet e saj janë shfaqur në një numër të revistave në Amerikën Latine dhe nw Evropë.

Në vitin 2014 merr pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Venecias të Poezisë. Disa nga poezitë e saj janë përkthyer në italisht nga Erminio Corti dhe në anglisht nga Jonathan

Boulting. Ajo është anëtare e ACEC, (Shoqata kolegjiale e Shkrimtarëve të Katalonisw).

Përveç kësaj, ajo është Drejtore e Komunikacionit të CIMA, Asociacion de Mujeres Cineastas y de Medios Audiovisuales. (Shoqata e Grave të Filmit dhe Media Audiovizuale, Spanjë)

SYRI VIGJILENT

1
Tani që thyhet drita
Unë jam ngjyrë e tejdukshme

Jam këmbëngulëse në zë
Në bardhësinë e agimit;
Qielli i kthjelltë.

I vetmuar kalon një zog
Ashtu si një pikturë
N 'kornizat e mia të dritares
Përmes xhamit një lule lulëzon
Një zog më në fund fluturon

2
Në brigjet e lumit
Sikur një zog i parajsës
Ylberi
Mbi mal
Syri Vigjilent

3
Me krahë të purpurta
Zogu fluturues
Vajosur me rrëshirën e qiellit
Na përkujton për e veprave tona voglat

Flaka ndizet
Ajo zgjat fluturimin
Dhe si i arratisur
depërton natën

LITANIA E FRIKËS

Unë jam e frikësuar dhe nuk duhet të jem
Unë i di shkallët e qiellit
Retë, zogjtë janë të lidhura së bashku nga
E qeshura e fluturave

Unë jam e frikësuar dhe nuk duhet të jem
Unë e kuptoj dritën, ligjërimin e saj
Por ,është ftohtë; është natë
Dhe çdo gjë është e trashë, e drejtë, çdo gjë
shkurtohet

Unë jam e frikësuar jam dy ose as një
Gjithmonë pranë jush e vetëm
Unë jam e frikësuar nga këto duar;
Këto duar, kjo shpinë

Ky zë në fund të rreshtit
Lavë e pastër në stomakun e oqeanit

Më kanë mësuar të mendoj në pafundësi
Ata kanë zbuluar arpegionin e heshtjes
Por unë jam e frikësuar armiku, vetja ime
Vetën e mbështjell në lëkurën time
Shoqja ime e përditshme

Si një gjuhë e vdekur
Si një hije e rrallë
Ashtu si një Ati ynë

Unë jam e frikësuar dhe tashmë është ditë

STATUJA

Hap pas hapi ti shkon
                shthur veten
Në fragmente të qenies së shtangur

Rruga e dëborës
Duke u bërë statujë

E kripës
E hiçit

Muzika e injekton shpirtin tuaj me ilaçin e saj
Për të shpëtuar apo asgjësuar

Apo nuk është kjo ajo që mund ta vras
Ose këndon këngën e bilbilit?

(Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj)

Entela SAFETI - KASI
(SHQIPËRI)

Poete, romanciere, përkthyese dhe eseiste. Është autore e librave "Ëndërr e paemër","Koha e Kalit","Pasion dhe Krim", "Në këtë muzg pikëllimi", "Të korrat e Krishtlindjeve". Për veprën e saj janë shprehur kritikë vendas dhe të huaj. Është vlerësuar në Finlandë nga Federata Ndërkombëtare e Përkthyesve të Letërsisë,(FIT), për "Përkthim letrar dhe të drejtat e autorit" në vitin2005. Poezia e saj është përfshirë në "Mbrëmjet Strugane të Poezisë"2001 dhe 2002, si edhe nga "Festivali Ndërkombëtar i poezisë në Izmir"i organizuar nga PEN International dhe PEN Qendra e Turqisë në vitin 2007, ku është lauruar me kupën e kristaltë të këtij festivali, midis poetëve të vitit. Është ftuar në aktivitet më të rëndësishme për letërsinë nga PEN International, dhe FIT, në Ballkan, Evropë, SHBA, Azi, Afrikë, Kinë, Japoni, dhe në Korenë e Jugut. Është përkthyer në: Maqedonisht, Turqisht, Anglisht, Frëngjisht, Arabisht,etj, dhe është botuar në antologji dhe revista letrare në vende të ndryshme të botës. Ka sjellë në gjuhën shqipe romanin 'Kujtime të Mirelës' të Eugene Schoulgin dhe veprën e përzgjedhur të Casimiro de Britos, 'Muzika e botës'. Ka përkthyer dhe botuar antologjinë e poezisë bashkëkohorë të autorëve PEN, ' Metafora që s'falen', në shtëpinë botuese Serembe, Shkup. Aktualisht është Presidente e PEN Qendrës të Shqipërisë dhe anëtare e bordit 'In Search Commite', të PEN International. Është ftuar si shkrimtare e gjuhës shqipe nga Universitete te ndryshme në botë, si: Univeristeti i Xhorxhias në Shtetet e Bashkuara, Universiteti i Haifas, Izrael, Universiteti i HANKUK, Seul, Universiteti i Maltepe, Turqi, etj. Ajo mban titullin 'Ambasadore e Paqes', akorduar nga Federata Botërore për Paqe Universale në vitin 2013.

HIRI

Do të zgjohesh nesër ndoshta
Nën brymë stine të ftohtë për ëndrrën
E ndoshta nuk do të kesh rrotull vetveten
Ikur sendesh të vogla, gjuhësh që flasin pa gojë.
Nga të gjitha anët nuk gjendet kush të rrëfejë udhën
Kur shkel rrugë të ftohta
Pa gjurmë njeriu.
Kur zgjatet në pafundësi ikja
Rrëzuar në heshtje krahët e shpendit
Sosin kah qielli,
E reja lumbardhës i bëhet shtrat

Dhimbja kur nuk zbret në tokë ngjit polip për korale detesh
Që i shkojnë fundit, territ të errur dritash pa tinguj
I ftohtë pus i kumbimit të fjalës
Që reket të kapërcejë pragun e gjuhës,
Kur kumti ngrin në fletë papirusi
Të kujtesës shkruar në rrëfenja ëndrrash.
Zemrën mos e merr në krahë!
Sepse krahët për ëndrrën janë pllanga myshku të errët
Në qela të ftohta ku zgjohet dija
E fshehta e botës
Përtej qiellit që prek njeriu
Dhe fle atje zëri, tingull i vjetër si koha kur fluturonim
Si yj të këputur tokës
Si vetja rrëzuar mbi rruzuj loti...
E tash nuk di ta kem një reze
Ta gjej një udhë kthimi
Sepse drita zbardhet netësh të përcjella territ.
E nga maja malesh zgjohet e ikur në pafundësi
Rruga që zgjatet qiellit
Të mundimit
E mbetet mjegullës,
Hiri...

Mitrovicë, 9.11.2013

FJALA

Fjala në syrin e natës zhduket
Mëndafsh tis i dhimbjes lindur me dritën
Pakur, terur në moskund
Kur vjeshton mbi ne vetvetja, lëndë e pasosur
Ky gur që shndrit në hon të gremisur
detit të dhimbjes dhe kripës
Merr formë mermeri
Statujë i bëhet ëndrrës që u mbyll në kullën
Ku gjyshi shtronte lëkurët e deleve të bardha
Të ngroheshin miqtë
Atje, ende hiri i drurëve të djegur mbështjell flatra zogjsh të ikur
E jashtë në malin me pyje të zhveshur vjen kënga e kahershme
Pa tinguj
Mbështjellë në kuti argjendi
Botësh të fshehta

Ku heshtja rëndon sa ari
Sot shkunden pemë të pjekura
E bien
Në pragun tënd....

Korrik 2013

SIKUR

Sikur në flatra zogjsh të bardhë të endej fjala
Në sqep të pëllumbit kumti
Dhe drita në sytë e të vetmuarit
Ngarkuar në trastën me libra
Të vjetër kohës që s'kthehet
Në parvaz të qelqeve
me botën mbi shpinë
Do të ishim kështu një mirazh
I dijes
Kokrizë rëre nën lëkurë të tingullit
Kur shkretimit njeriu i ndërton statuja
Dhe gra të mbështjella si kukulla
Mbetur në dhoma fëmijësh
I drejtojnë lutje qiellit
Ku lëvizin avionët...

Sikur në shtrat koralesh të prehej ëndrra
Në trup të perlës dhimbja e fikur
Në thellësi ujërash të errët
Detesh që botën ndajnë
N'kufij të së pamundurës
Dija
Do të zbriste në sytë e të trishtuarit
Si drita e flakës së kandelierës
Në udhëtim të pasosun'
Dhe gjuha nuk do të mjaftonte
Për të folur
Si peng i moskuptimit ndër njerëz
Kur natyra ikur prej nesh
Në muze, ka ndaluar mohimit…

30 Prill 2012

Trajçe KACAROV (MAQEDONI)

Trajçe Kacarov është poet, eseist, dramaturg. Është lindur në Shtip më 14 shtator 1959. Me profesion është jurist, aktor dhe teatrolog. Magjistroi në studimet Kulturologjike në Institutin për letërsi maqedonase në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi", në Shkup.

Punon si dramaturg dhe udhëheqës i sektorit të dramës në IKQK "Aco Shopov"- në teatrin kombëtar në Shtip.

Më 1993 themeloi revistën për art "SUM" dhe vazhdon të jetë kryeredaktor i saj. Më 1996 themeloi dhe bëhet redaktor i revistës mujore për teatër "Trend teatër". Ndërsa, më 1997 bashkë me grupin e autorëve themelon gazetën e Shoqatës së shkrimtarëve të Maqedonisë "Stozher".

Ka botuar rreth 20 vepra shkencore, eseistikë, publicistikë, ndër të cilat mund të përmenden librat e Gi Misho "Malerme", Jirzhi Mencel "Besimi dhe skeptik", Vadim Maksimov "Sistemi i Antonen Arto", Mihail Çekov "Loja e aktorit" etj., poezitë "Nën sqetullat e orës së zgjimit", "E ndjekni Horhen", "Emigranti Cvik" etj.

Gjithashtu, është i përfshirë në disa antologji brenda dhe jashtë vendit. Si dhe ka fituar disa çmime letrare brenda vendit.

E DIJA NJË GRUA

E dija një grua
E cila gjithçka që do shihte
Gjithçka që do dëgjonte
E mbyllte në kokën e saj
Koka iu rrit aq e madhe
Ashtu që një ditë erdhi dhe tha

-Kokën e kam aq të madhe
Dhe me të nuk mundem
As në shtëpi
As jashtë saj
Me të nuk mundem
As në këmbë
As në gjoks
Kokën e kam aq të madhe
Dhe asgjë nuk mundet mbi të.

E di një grua
E cila kur ec
Ec si pa kokë

GRUAJA QË ECË PARA MEJE

Gruaja që ecë para meje
Kalon rrugën
Unë e ndjek pas

Blen në qoshqe
Unë vështroj përreth saj

Derisa largohet
Më gjënë e blerë në dorë
Shoh:

Mban prapanicën si unë
Dëshpërimin e saj në fytyrë

OPIT

Fjala nuk është më e fuqishme se heshtja
Prania nga mungesa
Për atë derisa ecim bashkë
Ose pushojmë të mbështetur njëri në tjetrin
Të lëmë të duhemi dhe dashurohemi
Atëherë kur nuk do të ekzistojmë

TAJA

E hap këtë ditë
Pa çelësin e buzëqeshjes tënde
Pa llambën e trupit tënd
Pa rrugën e flokëve tuaja, Taja

E hap këtë ditë
Pa thellësinë e afërsisë tënde, Taja

E hap këtë ditë
Ditë që nuk më vlen asgjë
S'mund të jetë ai fustani yt, Taja

Përktheu: Artan Arsllani

Levent KARATAŞ
(TURQI)

Poet, u lind në 1972. Libri i tij i parë me poezi, 'Galileo', u botua në vitin 1992.

Librat e tij të botuar janë: 'Masal', 'Bir Doğu Uykusu', 'Güzel Cumartesi', 'Piyano Fabrikaları'.

Poezitë dhe artikujt të ndryshëm janë botuar në revista dhe gazeta si: Varlık, Adamsanat, Gösteri, Sombahar, Yasakmeyve, Şiir-lik, Şiiratı, Şiiroku, İblis, Şairin Atölyesi, Yeni Yüzyıl, Cumhuriyet, Cumhuriyet Kitap.

Poezia e tij: 'Bir Doğu Uykusu' është botuar në SHBA dhe Mbretërinë e Bashkuar. Poezia është përkthyer në anglisht nga Fiona Tomkison.

E TIJ TË ATIJ

Shohim ajrin
Prej së cilit edhe ujqërit do të trembeshin; mbështjellë balte, ajër i errët
Duke qëndruar në dritare
Krahasoj ajrin e djeshëm dhe të tjerave ditë
Oh Zot! Mungesa e dritës na dhemb shpesh
Errësira e shpirtit na dhemb
'Kjo është'- themi-' hija e dreqit dashuri e kohës'
Mendojmë për fantazma që lagen shiut
Kur kalojnë stinë paralelesh mbështjellë vend pas vendi
Mendojmë sikur ai hap çadrën, dhe e mbyll
Flasim për kohën
Kur ajo pikon, pikon, pikon
U besojmë avionëve fluturues
Dhe trenave të pambëritshëm
Shohim detet dhe fillojmë të flasim për ujërat
E tij të atij
'Oh', themi, " e shoh detin'. Sa do të doja të prehesha tek ai përherë
Ndjejmë shiun në fund të tij
Gjersa ftohemi
Gjersa trembemi
Sikur era të na prekte
Zgjohemi me ujin
Flasim me ajrin
Si gjithë të tjerët më parë
Flasim për këtë për atë.

HIPNOZA

Kush më solli këtu?
Së fundmi isha në tualet, mendoj
Më kujtohet që
Kush janë këta njerëz që mbajnë këto dosje?
Që gatuhen
Që gatuajnë
Që gatuajnë
A je ti mjeku?
Apo është nëna që dëshiron të më zgjojë?
Por mund të jetë po ashtu im atë
A je ti mjeku?
Së fundi kërkova një dopio raki
Kurrë nuk do ta shoh këtë raki në tavolinë besoj,
A je ti kamerieri?
Jam ulur në kolltukun e kuq
Madje kam shkuar në fund të rrugës së vdekjes
Por kjo është për keq
Ha ha ha!
Mendova shtriganët mbetur në fëmijërinë time
A po fishkëllen ky shtrigan?
Mund të jete një biletashitës
Por për keq këtë kësaj here
Ia premtova dikur vetes
Ah, a je ti mjeku?
Ha ha ha!

Përktheu nga anglishtja: Entela S. Kasi

Joslin Love KEARSE (SHBA)

Joslin Love Kearse, që përndryshe njihet si Soul Cry (E qara e Shpirtit), është poete dhe artiste e fjalës së folur nga York, PA. "Fëmija e dashurisë" e një nëne muzikante dhe një babai letrar, ka marrë pjesë në shumë ngjarje dhe "slams" në bregun lindor të SHBA-së. Në "Central PA Hip-Hop Awards" mori titullin e Poetit të Vitit për 2007 dhe 2008. Ka bërë 2 CD me titullin "Destiny's Calling" (Thirrja e fatit) dhe "The Love Chronicles" (Kronikat e dashurisë) dhe në qershor 2013 botoi përmbledhjen e pare me poezi, "Passing By" (Duke kaluar).

Kearse, që është një veterane krenare e ushtrisë së SHBA-së, ka kryer një studim dyvjeçar për menaxhim biznesi në Yorktowne Business Institute, një "Bachelor's Degree" në udhëheqje organizative dhe më 2014 parashikohet të kryejë Master-in në menaxhim biznesi në Eastern University.

Është edhe amatore e artit pamor dhe një këngëtare dhe kantautore e suksesshme dhe jeton me djalin e saj Jordan në York County, Pennsylvania.

KËTEJ E TUTJE (NONETË)

Shpresa e nesërme është dhembje e zemrës e sotshme
Me zbehjen e pasioneve duhet të ndodhë ndryshimi.
Hilja është kalimi pa
qenë kalimtar.
Zvarritjes së
ngadalshme
i thuhet
vazhdim.

RREBESH PLUMBASH DHE PLAÇKITJE (BOMBA FJALËSH)

PO HYN! MBROHU!
nga raketat e hedhura nga një shok i betejës i një rasti
ish-shpirt binjak në gropën e dhelprës, dashnor i kthyer në
opozitë operative që operon prapa vijat e armikut
duke hedhur në rrebesh granata prej fjalive zjarrvënëse
që brejnë ndërgjegjen
dhe lënë pas shkretim emocional

Kësaj here nuk është mundësi as tërheqje as dorëzim
diplomacia është praktikë arkaike e luftërave të djeshme
nuk do të ketë marrëveshje paqeje kur dashuria
mbahet peng
e maskuar… e lidhur dhe e shtuposur në fragmente
filmike kujtimi bajat
dhe hakmarrja është një trimëreshë e veshur në
rroba mbrojtëse
e aftë në artin e lashtë të shqelmit në prapanicë me fjalë
"në gatishmëri" për të fituar një zemër vjollcë për
mbresat e saj

Kërkime faljeje nuk mund të shuajnë kurrë agoninë
e një plage thithëse gjoksi të mbështjellë në celofan
për të qetësuar gurgullimën e frymëmarrjes së shkurtuar
të heshtur në një murmurimë të ulët mu para afrimit
të vdekjes
një vrasëse kundërshtare me keqardhje nuk është
balsam lehtësues
ajo qenka napalm!
të gjithë e dine që napalmi kundërmon
për organet më të ndjeshme me strehim nën brinjët

Falja është kali i Trojës
i ofruar nga nevoja për shërim; ngaqë nuk është
më i burgosur lufte
armiku është i lire tani për t'u qëlluar
e armatosur dhe ngarkuar, plotësisht automatikisht
duke zbrazur një pas një magazina të mëdha
për ta vrarë me mirësinë që ajo perceptoi si dobësi
pa marrë vesh kurrë që synimi i mirësisë ishte vrasja
dhe që edhe ajo do të ishte viktimë e kësaj lufte!

AJO, DASHURI SI …VIVALDI

Agoni e ëmbël në
perkusion me dy grushte
telash harpsikordi
me lumturim harmonik
dhe synim te bukur

Ajo flet një simfoni kur
sonata e saj gufohet
plot me ndjenja
të skalitura ashpër nga
malli i shpirtit
Mospërputhja mendore shkakton

burgosje audiofonike
unë dëgjoj, e kërrusur mbi
skajin e kolltukut, e magjepsur nga
toni i tij dhe ngjyra e tingullit

Duke pushuar mbi modulimet e saj
me veneracion të "crescendo"-s
e tejngopur me emocion
duke u shpërthyer në një
duartrokitje "staccato"

ROJTARE E MOTRËS

në kornizën e saj të pakrehur të kuqërremtë
fije të arta për kaçurrela të pasynuara
të zëna nën peshën e leshtë të
një xhup tepër të ngrohtë për pasdite në mes të pranverës
njolla të hirta në sy të kaltër të ngjitur pranë faqe të pista
të dëshpëruara për kapsallitje shprese

nën afarin e leckosur të xhupit të saj,
thellë si beli i mbështjellë, një qenush i çrregulluar
i shtyrë nga mëshikëza e tij në liri,
që del pjesërisht në mbrojtjen e saj
duke nuhatur fuqimisht të gjitha sendet
i padukshëm për sytë e saj ende të mbuluar

kalimtarë të virtytshëm hundëpjetë
dhe shikime poshtë formonin
një parade ngatërruese trupash
në ujvara nga ashensorë
dhe drejt pas rasteve të mira
për të plotësuar nevojën e tjetërkujt

në qendrën e qytetit të Philadelphias ku
Galleria Mall dhe Convention Center bashkohen
tregtarë të përzier me konsumatorë të etur
që harxhojnë për teprime të rastësishme
në vend të dëshirës së saj për ushqim
dhe një biletë autobusi në shtëpi

kishte një mundësi për të përjetuar kënaqësinë
e shërbimit ndaj një të panjohure në rrethana të panjohura
me mall për ngushëllim, siguri dhe ushqyerje,
ndoshta vetëm unë e pashë Krishtin në sytë e saj
dhe vendosa ta ngushëlloja Atë.

DEPRESION

Ajo numëron sekondat
minutat, orët e kaluara
në ankth të qetë
meditativ

Ulluqe të tejmbushura derdhin
dushe të herëpashershme
kundër tjegullave prej druri
që ia japin shuplaka heshtjes së saj

Bojë dhe suva me qime kali
bëjnë flluska dhe zbërthehen kur
lagështi kullon nëpër
të çara të pandërvarura llaçi

Ajo e di por nuk merr vesh

Vetëm numëron sekondat
minutat, orët e kaluara
në kërrusje të qetë
mosbesuese

Shtëpitë me papafingo
një kafshim i paidentifikueshëm
nxiton dhe gërryen
midis kutive dhe trarët

Erërat vërshëllejnë nëpër
parvaze të pavulosura dritaresh
kur ajri i lagësht trazon
një të dridhur nëpër eshtrat e saj

Ajo merr vesh por nuk përgjigjet

Numëron sekondat
minutat, orët e kaluara
në burgoste të qetë të
frikës që shfaqet.

Shtëpia e vjetër këndon partiturën e tmerrit të saj
kurse ajo mban kohën e saktë me metronom.

Përktheu nga anglishtja: Silke Liria Blumbach

Dinos KUBATIS
(GREQI)

Dinos Kubatis lindi në Athinë, kreu studimet për Teatër dhe Gjuhën frenge.

Që në moshë të vogël iu përkushtua fushës së Letrave dhe Artit. Si aktor dhe regjizor punoi ne Greqi dhe jashtështetit, ku fitoi çmimin ndçrkombeta ''JONESKO'', për tërësinë e punës së tij regjizoriale. Shkroi në të gjitha gjinitë e letërsisë dhe ka botuar 19 libra. Përveç, Greqisë librat e tij jane botuar në Francë, në Kanada, në Poloni dhe në Shqipëri. Njëkohesisht, Dinos Kubatis ka punuar me pasion në gazetari, me radio dhe televizion. Veprat e tij janë përkthyer dhe janë paraqitur në shumë gjuhe dhe jane luajtur shume drama te tij ne teater, ne televizon dhe ne radio. Ne vitin 2007, i jepet titulli ''Doktor Nderi i Letërsisë të Bizantit'' në Universitetin e Valencias dhe ''Akademik Nderi'' në Akademinë e Portugalisë. Merr pjesë ne kongrese te ndryshme nderkombetare te artit dhe kultures. Dinos Kubatis eshte antar i shume organizatave nderkombetare si; Shtepia e Europës, Shoqata e Kulturës Greke, Shoqata Kulturore e Shkrimtareve Te Teatron , te UNESKO etj... E kane nderuar me cmime nga Agjencia Nderkombetare Kulturore ''Johanesburg'', i Shoqatës Nderkombetare AQEPA te Australiasë, nga Shoqata Kulturore ''Promithevs'', në Uashington, me Medaljen e Arte te Akademise Franceze te Letrave, te Delfinikes Afiktonies, te UNESKO-os ,Dafnia e Arte nga Bashkimi I 52 Akadeimikon ne Bote nen kryesine e princit Joanu - Arkadhiu - Laskari Komninu, etj. Romanet e tij historike , si ''E dashura ime Ajvali'' dhe romani i fundit qe u botua tani afer ''Në flkatë e Izmirit'' jane bere best - seler dhe përbëjnë objekt disertacioni në Departamentin e Studimeve Moderne greke, në Universitetet e huaja... Veprat e tij jane perkthyer në: frengjisht, anglisht, gjermanish, indisht, polonisht, shqip, serbisht, turqisht, rusisht dhe në ukranisht. Disa libra te tij jane botuar në; Francë, Kanada, Poloni dhe në Shqiperi. Dinos Kubatis eshte krijues i shumë organizatave si; ''Teatri Eksperimental'', ''Organizata e Teatrit te Jonit'', Qendra e Teatrit e Ekesperimtal'', Festavali i Teatrit te Monologut dhe Qendra kulturore ''Kafeja e Ideve'' , që ka një njohje ndërkombëtare, për organizimin e përvitshëm të simpoziumit të poezisë , letërsisë dhe dhënien e Medaljes së Artë te ''Aleksandrit te Madh'' dhe '' Virgjinës'', për njerëzit intelektual, të artit, të shkencës, të biznesit, të politikës, të sportit, nga e gjithe bota.

NUK ISHA NË KOSOVË...

Ishe ti atje, kur binin bombat dhe shkatërronin
shtëpitë?
Ishe ti atje, kur bombat hapnin kanale nëpër fusha
për të mbjell farën e vdekjes?
Kur në pranverë mbillnin kafka
dhe në verë korrnin jetë të pastra dhe të pafajshme,
ishe atje?

Dhe në qofte se nuk ishe atje, ku ishe?
Merrje pjesë në një konferencë për paqen e botës?
Bekoje zbulimet e reja "krejtësisht të sakta" të
shkencës?

Kujtoje me tmerr viktimat e Hiroshimës,
apo admiroje eksperimentin e shpërbërjes së
Ajshtajnit
që me krenari mësojnë nëpër shkolla?

Dhe në qoftë se nuk ishe atje, mos vallë fshiheshe
nga frika prej të gjitha atyre që ndodhnin në emër
te Paqes,
apo ndoshta afër një oxhaku të nxehtë
duke shijuar lumturinë e të një zakonshmi njeriu
neglizhent,
të cilin e kanë bindur të besoj se gjithçka
është e shkruar nga Zoti
dhe çdo gjë rreth tij ndodh për lumturinë e tij?

Kudo që të ishe, siç dhe do të mundje të mendoje,
nuk ndjeve tmerrin, nuk dëgjove zhurmën
shurdhuese
teksa aeroplanët kalonin si breshëri sorrash të
frikshme,
nuk pe fëmijë të pafajshëm që prej breshërive
automatikësh të notojnë në gjak...

Kudo që të ishe, ashtu sikurse dhe unë,
nuk ndjemë vdekjen të afroj
dhe të ngrij shpirtrat tanë...

Memaliaj,
17 nëntor 2010

Përktheu nga greqishtja: Ira Llangosi

PAVARËSIA E KOSOVËS

Nga mali kreshtëlartë i Dardanisë
Shpendi i zi me dy kokë që të kallin tmerr,
Prej hapësirës së Kosovës kalon me furi
Shikon tokën e lyer me të kuq dhe thërret:
''Hapu, o tokë, mijëra kufomat nxirr,
Ata që armiku varrosi . Trimat të gjithë,
Me pushkët e vjetra dhe shpatat tehgjera të bëjnë ballë,
Mandat të fuqishëm sjell, ta dëgjojë vendi mbarë!''
U tund rruzullimi, u hapën varret poshtë,
Të vdekurit e luftës dolën përmbi tokë.

Nëna, gra, të reja dhe plaka mos vajtoni,
''Shpendi i zi në qiell erdhi sërish'', të thoni.
Burra trima, heronj, vëllezër, baballarë,
Fëmijë, që heronjtë pushkët ju lanë,
Gatituni. Qielli u hap dhe po hapet sërish
Dhe fton në luftë gjithë hijeshitë e lirisë.

''Të hapur janë qiejt dhe sjellin bekim!''-
Thërrasin gëzimplotë nënat dhe fëmijët.
Dhe i ngrenë lart , në zemër i shtrëngojnë fëmijëë,
Lart, në hajmalinë e qëndisur, ku shkruhet ''Liri''!
Dhe zbresin prej malesh, luginat i zënë,
Fortifikohen, ca majtas, djathtas ca të tjerë.
Presin gjithë ditën, mbrëmjet të vijnë,
Të tregojnë në luftë guxim e burrëri.

Aty, mëngjes e mesditë, zogu krenar,
Shkon duke çarë retë, krahëhapur tej e ndanë,
-mbi trimat e Dardanisë, qëndron e vigjilon,
Shqiponja e zezë me dy krerë.
Guxim marrin burrat, kur shohin shpendin që i mbron
Dhe sikush e kupton se ka mundësi,
Të marrë gjakun e të parëve të tij
Dhe se me harenë e shqipes fuqiplotë,
Prej armikut shkelës, kombin mund ta shpëtojë,
Ashtu siç e ka pritur për shekuj me radhë.

Gjyshet e tregonin në përrallat e tyre,
-Por e vërteta nuk është përrallë,-
Se toka e shenjtë, ku ata kanë jetuar,
Toka, ku fëmijët e tyre rritën,burrëruan,
Dikur ishte e lirë, tokë e tyre ish...
Trimat, që gjyshen e kishin besim,
Në ëndrrat e tyre veç këtë ëndërronin,
Lirinë ! Këtë çast në shekuj e kishin pritur,

Kur fati do t'i sillte përballë me armikun,
Ta hidhnin tej, zgjedhën, skllavërinë,
Kosovës së tyre t'i sillnin lirinë.

Një mëngjes, lart, në qiej ata panë,
Shpendin me dy krerë të të parëve tanë,
Ta mbulonte Kosovën e trojet arbënore,
Prej rrafshinës, zemëratën deri lart në male
Ta nderte e krahët të hapte tej e tej,
Duke flatruar, ajrin shtynte tej
E shpresë i mbushte zemrat njerëzore,
Të vdekurit alarmoi në lugje e shpatie,
U dha atyre armë, u dha shpresë lirie,
Për ta çliruar atdhenë e tyre fatkeq.

Dhe, ja, boria qysh herët ushton,
Qiellin e tund, Tokën e gjëmon,
Në luftë ngrihet populli mbarë,
Me çudi armiku i sheh përballë.
Marrin flakë pushkët, topi gjëmon,
Në atë luftë, që shekujsh vazhdon,
Prej kohës së Turqisë e gjithë kohët e tjera,
Tashmë mbërrin në fund dhe kanë shumë rëndësi,
Gjërat e mëdha, që ka ndërmend ai.
Të skllavëruarit, lirinë dëshirojnë,
Shqiponja në qiej sërish vigjilon,
E dinë, me dashuri i mbron cep më cep,
Vendin, atdhenë dhe bijtë e vet.
Ndërsa gjyshja sërish nga qoshka e saj,
Thotë se kjo nuk ishte përrallë,
Ato që tha dikur, ishin një e vërtetë.
E lë mënjanë pirostinë e lashtë
Dhe del në ballë,fëmijëve udhë t'u hapë,
Në fushën e gjerë, ku mëllenja quket,
Mbi turmat pushtuese zbraz dufin e vet.

Dhe gjyshi urimin e jep me dëshirë,
Nëna jep të sajën këshillë:
Kuvendi i vërtetë, është ai i Drejtësisë,
Të hyjnë në luftë, të luftojnë me trimëri,
Mandej prej saj të jetojnë në liri.
Zbritën nga malet trimat ushtarë,
Fëmijët e parritur, në krye gratë,
Aty në fushë, armikun e fortë,
Të tillë armik, që s'është parë gjer më sot,
Trimat sërish e luftojnë me furi,
Që në atdhe të vijë e shtrenjta liri,
Aty ku toka sërish përskuq

Dhe agimi lulëzon e merr frymë të purpurt,
Aty ku gjaku ka rënë me shumicë,
Tmerr e frikë ngjall mbi armiqtë.

Dhe qiejt i lë shpendi i zi,
Me plot gëzim, me plot krenari,
Zbret tatëposhtë flakë i kuq,
Në ushtritë çlirimtare bëhet flamur.
Të gjithë, trimat që fitoren dhanë,
Kthehen në vatrat e tyre si luanë,
Dragonj, që nuk ua ka kush fuqinë,
Atdheut të tyre i japin lirinë.

Salaminë,
30 janar 2013

Përktheu: Iliaz Bobaj

LUMI I LANËS

Lumi i Lanës lotëzon çdo agim e pasdite.
Në zemër të Tiranës, lumi i lashtë,
lë dhimbjen e tij...

Gjithë jetën e tij lotëzonte lumi i Lanës.
Fillimisht, pasi rridhte i vetëm në zemër të Natyrës
dhe zogjtë pinin ujin e tij.

Pastaj lumi i Lanës lotëzonte se erdhën njerëzit
dhe i privuan rrjedhjen e lirë në zemër të Tiranës,
në zemër të njerëzve.

Në zemër të zogjve nuk do të jetë lumi i Lanës,
se dita-ditës e vrasin njerëzit
dhe ai fashit lotët e vet.

SARANDË

E hedhur në gjirin e detit, bregu,
në gji të tij nunarit valët e qeta,
duke udhëtuar nëpër horizonte dhe në pafundësinë
e botës.

Dallgët – magjike të Historisë së botës,
si brenda një guaske kujtimesh, trumbetojnë në
bregdetin mikpritës,
legjendat që dëgjuan prej shtojzovalleve dhe
peshqve me kokë si të kalit.

Buzëdetit dëgjuan Sirenat duke kënduar përreth tij,
këngë ende të pashqiptueshme, që fitojnë tinguj të rinj
në lëvozhgat e guaskave prej alabastri.

Aty, në gjurmët e Anhorezmit të lashtë,
ëndërrojnë netët magjike dhe mbrëmjet yjeplotë,
shpërndajnë argjend prej pluhuri yjor.

Me një kitarë me tre tela, notat
qetësojnë Zotat dhe vajzat e brishta heqin,
valle mbi harkun e violinave.

Finiqi, Butrinti, lavditë e tyre ngrihen,
hijesojnë diellin dhe përkujdesin,
vendin ku prekin me dashuri të dy detet.

Faniten piratë grabitës, larg lumturisë së këtij vendi,
të ndjekur prej burrash mbrojtës të Paqes,
në luftën e kotë brenda kësaj bote.

Një pëllumb i bardhë bie një degëz ulliri
në sqepin e vet dhe fletët e tij shenjtërohen,
në ujërat e kaltra të detit.

Ngrihen miq, armiq, pushtues, fantazma,
në yjësitë e natës ''falje'' kërkojnë,
prej qytetit shekullor që tradhtuan.

Grekë, Bizantinë, Romakë, sërish hedhin valle,
rrokullisen në rrënojat e kështjellave,
të dehur prej bukurisë së vendit.

Mbretër, Mbretër, Princër, Shenjtorë,
pushtues dhe çlirimtarë, ngrenë panair të
përbashkët
dhe bekojnë fatin, që vetëm në gjirin e tij jetuan.

Sot, në mjegullën e Historisë, si në ekran,
shpërfaqin lavdi, kurora dafine
mbajnë në duart e tyre.

Sot, bukuria shkëlqimtare
mbulon qytetin dhe Historia
e quan fëmijë të saj të denjë.

Sot, Zota, luftëtarë dhe heronj,
me nderim i përkushtojnë dashurinë e tyre,
këtij qyteti të thjeshtë, të denjë.

Memaliaj, 12 Janar 2014

Përktheu: Iliaz Bobaj

PORTI I NDEZUR

Lilit tim

Në këmbët e tua,
guaska deti vishje.
Në dy buzët e tua kishe,
kripëzim dhe vesë.

Lundroje përmes detit,
busullën e dashurisë,
si far dhe si shpresë,
që vjen prej largësisë.

U përkula dhe putha,
majat e gishtave të tua,
dhe zemrën tënde dëgjova,
që rrihte si një dallgë.

Në gjoksin tënd u ngjita,
port i mbrojtur mirë,
furtunë që nuk të kap
dhe di të dashuroj.

Përktheu: Iliaz Bobaj

SHQIPËRI

Male e lëndina kapërceva
Pashë tokën tënde, lumenjtë e tu
dhe natyrën admirova
Pashë detrat blu që pikturojnë dantella
greminat, kataraktet, lumenjtë
fushat e mëdha, gëmushat e ullishtat
dhe qiellin që si çati mbron krenarin e të fortin
Popullin tënd

Shqipëri
Pak dija historinë tënde
për Popullin tënd pak dija...

Në rrugët dhe rrugicat e tua shkela
në shtëpitë e Popullit tënd jetova...
Njoha zakonet që koha gdhendi
ndjeva gëzimet, dhimbjet dhe virtytet e tua
përpjekjen e një vendi që i ngjan vendit tim
ndjeva dridhmën e tokave të tua pjellore
thirrjen e jetës që buron nga zemra jote dëgjova

Shqipëri
Pak dija për baltën tënde
për damarët e tu pak dija

Këngën fjalëshumë të zogjve endacakë
dhe murmuritjen e jetës në gjethet e saj dëgjova
simfoninë qiellore të përrenjve dhe
shushurimën e erës që sjell shpresën te populli yt
që thith tashmë ajrin e lirisë,
dëgjova të Gjitha të fshehtat
e natyrës që të mban në gji ditë-natë dëgjova

Shqipëri
Dija pak për muzikën tënde
dhe për odet e tua pak dija...

Pashë fushat, qytetet e fshatrat e tua
pashë liqenet, kopshtet dhe rrugicat e tua
yjet net të tëra vështrova
ndërsa shqova të ardhmen në kupolëri qiellore
dhe në hapësirat kozmike të ardhmen tënde shqova
dhe lexova drejt në sytë e bijave e te bijave të tu
të vërtetën, nderin dhe "Besën"*

Shqipëri
Pak dija për Popullin tënd
për shpirtin tënd pak dija
fola, dëgjova, në mendime rashë
këngët e tua të dëshpërimit dhe të gëzimit
këndova

Me ritmin e zëmrës tënde kërceva
në brengat dhe hallet e tua u futa
Nga gëzimi u drodha, lot nga dhimbja derdha
bukën tënde hëngra
ujin tënd piva

Shqipëri
Po, jam, sigurt që të dua

Tiranë, 22 Janvier* 1996

Përktheu nga greqishtja: Mimoza Dino


Foto: Francoise Roy

Giuseppe NAPOLITANO (ITALI)

U lind më 12 shkurt 1949, në Minturno (banon në Formia). Është i martuar me Irene Valonen, poete dhe aktore, kanë një vajzë, Gabrielën. I diplomuar për Letërsi në Romë, në 1972 me temën e diplomës mbi teatrin surrealist francez, Xhuzepe Napolitano ka dhënë mësim për 33 vjet letërsi italiane dhe latinisht në gjimnaze të ndryshme.

Që nga viti 2006, drejton një kolanë librash të vegjël: "dhoma e poetit", në të cilën ka botuar, përveç se shumë libra të tij poetikë dhe me ese, edhe autorë të ndryshëm italianë të njohur dhe debutues, dhe sidomos përkthime të poetëve të Mesdheut, të panjohur më parë në Itali (francezët D. Leuwers, G. Drano, E. Burgos, A. Olive dhe N. Stamberg, spanjollët C. Vitale, A. Serna dhe G.Vega, tunizianët R. Chehaibi, shqiptarët A. Tufa dhe Sh. Emërllahu, algjerianen S. Negrouche).

Në vitin 2008,ka themeluar shoqatën kulturore "Dhoma e poetit"(ku është dhe Kryetar), me të cilën ka organizuar prej vitesh një festival ndërkombëtar poezie në jug të provincës së Latinës (në Komunat e Itrit, Formias dhe Spinjos): "Zëra të Mesdheut". Në vitin 2011, Festivali u mikprit nga ekspozita ndërkombëtare "Yacht Med Festival" (Gaeta), me 12 poetë që vinin nga 10 vende të ndryshme.

Botimet kryesore në poezi:

Çaste 1970; Brenda gjurmës 1978; Maskë 1978; Nëse te e nesërmja gjen pak të djeshme 1989; Krijesë 1993; Poezi / jopoezi 1994; Fjalë fjale 1998; Zemër rëre 1998; Loja 1999; Ekuilibër i ndryshueshëm (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2000; Kalime (5 libra të vegjël), 2002; Sextines de Campodimele (përkthimi nga Nicole Stamberg) 2002; Bashkë me ty u linda sërish 2003; Në bregun e kohës 2005; Fluturo lart, fjalë 2007; 10 poezi (përkthyer në gjermanisht nga R. Vecellio) 2008 dhe (përkthyer në shqip nga R. Salihu) 2010; Antologji (poezi 1967–2007 nën kujdesin e S. Di Spigno) 2009; Masa jetësore (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2009; Ditët e Naimit (përkthyer në shqip nga E. Zaimi) 2009; Genius loci (18 poezi për Normanno Soscian), 2009; Fletorkë 2010.

Pastaj... (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2010; Shfaqja e sigurisë (përkthyer në frëngjisht nga G. Drano) 2007 dhe (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2011; Divine dignité du verbe (përkthimi nga A. Vantchev de Thracy) 2014; Dialogë me Hënën 2013 dhe (përkthyer në shqip nga I. Zajmi) 2014.

FALEMINDERIT PEJË: PËRQAFIMI I FJALËS

(Ditar i vogël udhëtimi)

1.

Da quattro anni pellegrino poeta
nei Balcani mi mancava il Kosovo
a completare una geografia
iniziata in verità quando esisteva
la Yugoslavia con le sue contraddizioni
("qui Crna Gora" disse a Budva con orgoglio
la ragazza dell'Ufficio informazioni)
– forse ancora difficili a nascondere
per quanta buona volontà ci possa essere
anche nel fare della poesia la chiave
per aprire porte e rompere frontiere
invitando almeno le anime al confronto

Ricordare un poeta chiamando poeti
(dei tanti che lo hanno conosciuto)
a ricordarlo con la loro poesia
è il più bel dono da fare alla memoria
ed è un'idea che da tempo ho desiderio
di attuare per mio padre – avrei bisogno
magari solo del Sindaco di Pejë...
di un Sindaco disposto a riconoscere
il lavoro di chi ha tanto donato
della sua vita alla città che poco invece
sembra avere interesse a ricordare.

2.

Për katër vjet poet pelegrin
në Ballkan më mungonte Kosova
 të kompletoj një gjeografi
e cila në të vërtetë kishte filluar
– kur ekzistonte Jugosllavia me kontradiktat e saj
 ("këtu është Mali i Zi", thoshte me krenari
 në Budvë vajza e zyrës së informacionit)
-ndoshta edhe më e vështirë ta fshehësh
për sa mund të ketë vullnet të mirë
që të shndërrosh edhe poezinë në çelës
për të hapur porta e thyer kufi
duke ftuar të paktën shpirtrat në ballafaqim.

Të kujtosh një poet duke ftuar poetët
(nga të shumtët që e kanë njohur)
ta përkujtojnë me poezitë e tyre
është dhurata më e bukur për ta kujtuar
e është një ide që kam dashur ta bëj
prej kohësh për babanë tim – do kisha nevojë
mbase vetëm për kryetarin e Pejës...
një Kryetari të gatshëm të çmojë
punën e atyre që dhanë aq shumë
nga jeta e tyre për qytetin i cili duket pak
ka ndonjë interes t'i kujtojë

3.

Në pjesën e poshtme të luginës shtrihen malet e larta
(ka dëborë akoma pranë kufirit me Malin e Zi)
Peja më kujton Tetovën, është shumë e bukur
xhamia e vogël, ku nuk dua të hyj për të penguar.

Ka një pamje të trishtuar tregu në shi
:ca rrugica me dyqane të zakonshme
të argjendarisë dhe suvenireve që nuk më joshin -
- ka shumë gjelbërim në qytet që ndjell shpresë
- nuk shpresoj të jetë një vëzhgim
banal (i kanë dedikuar Rugovës
një "park të paqes" përgjatë lumit)

Najada sllovene na ofron qershi
blerë në rrugë dhe pastaj luleshtrydhe
si një vogëlushe me dëshira
kur ngjitemi te ujëvarat në pyll
ndjehemi nga pak të shkëputur
– duke u njohur më shumë me njëri tjetrin

Por këtu me të gjithë sikur po ritakohemi
në një dimension të njohur
sepse frymëmarrja e përbashkët është poezia
 duket si një xhaxha i vjetër i kohërave të tjera
edhe Ademi vëllai i Azemit Shkrelit
që vërtet ndihet i gëzuar që më ka takuar

Miqësia e vërtetë shprehet
me dhuratën e papritur të një ftese
në mesin e miqve që lexojnë poezi

Këtu mbesin dhe ruhen ndjenjat e mira që ende
japin shpresë dhe shtytje për të vazhduar
duke sakrifikuar një grimë kohë për dashuri.

4.

Më tepër se Maqedonia kjo tokë –
-që për rastësi ka shumë ndërlidhje
jo vetëm në aspektin gjuhësor –
ka vuajtur shumë dhe ka për të bërë shumë udhë
në rrugën e vështirë drejt Evropës

Tokë e varfër e varfër dhe e përgjakur
e cila me sa duket po shërohet
por sa forcë i duhet për të shkuar
qetësisht përtej fantazmave të saj
t'i jap të nesërme një fëmije të lirë

Kthimi në aeroport është një aventurë
(vonesa dhe incidenti që ndodhi e bllokimi i trafikut
fatmirësisht u anashkalua)
ndoshta për shkak se vozitësi është i lodhur
e nxiton për kryer detyra të tjera

Shkojnë në Monako të shtunën
për të takuar të afërmit fatlum dhe pastaj
i kthehen melankolisë së zakonit
por pak atdhe diku tjetër i ngushëllon
nëse dinë për të e nuk harrojnë

Unë jam në shtëpi gjithkund edhe pse
flas pak gjuhët e të tjerëve
por më mjafton të di se kemi një gjuhë të
përbashkët
që lidh zemrat dhe mendjet
në kërkim të një botë ideale për të jetuar

Jam si thotë Nicole një nëpunës i poezisë
– me rrogë zero – e për dashurinë
ndaj fjalës (kështu thoshte Carlos)
do të takohem me të gjithë ata që kanë nevojë
të takohemi në një përqafim të fjalës.

Përkthyer nga gjuha italiane: Ilire Zajmi

Bujar PLLOSHTANI (MAQEDONI)

Bujar Plloshtani, poet, publicist, eseist filozofik dhe kryetar i shoqatës së artistëve "Pushkin".

Bujar Plloshtani ka lindur më 18 dhjetor 1983.

U diplomua në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Evropës Juglindore.

Në vitin 2005, si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë viziton "Goethe Haus", "Goethe Museum" dhe "Ekspozitën Friedrich Schiller ", Frankfurt / Main.

Më 2005 ka punuar në SAATCHI - sektorin e anketave dhe intervistave, Shkup.

Më 10 nëntor 2007, në netët e poezisë "Takimet nën Rrap", në Shkup i jepet Çmimi "për vepër erotike" botuar në dy takime.

Më 2010, merr pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë "Mbrëmjet Strugane të Poezisë"

Më 2010 emërohet anëtar i Shoqatës së Poetëve të Japonisë

Është kolumnist në Hermes News, Telegrafi, Klosi News.

Ka botuar librat "Nga regjia e shpirtit" - poezi (2007), "Traktati mbi arsyen e mendimit" - filozofi (2009), "Mbi arsyen e fjalës - poezi (2010), "Etikë dhe Politikë" - filozofi politike (në proces), Bujar Plloshtani, poet, publicist, eseist filozofik dhe kryetar i shoqatës së artistëve "Pushkin".

MOTIV POETIK

Në je penduar për gurët e tokës,
mos eja dot
se udhë e gjatë është për tek unë.

Koha ikën tashmë si shejtan,
vonë po bëhet gjithnjë për gjithçka.

Kur terri po afron,
Hënën natën vonë
e shoh si portret amorf të ngjitur në qiell.

Buzëqesh ajo nuk di,
por të më shpirtërojë mavi.

Heshtje mistike,
ngado nga kjo vetmi që prore djeg.

Dua të iki i vetëm atje në një tokë si për mua,
dhe asnjë zë të brishtë prej kësaj toke mos dëgjoj.

Të iki në stepat e largët,
atje njësoj për sytë e mi.

Do jem me veten,
ju premtoj si poetët:
me poezinë, shpirtin tim që zgjohet përditë
në mërzi.

Dhe në vjeshtë,
kur një artikull i ri trishtimin rreth syve t'ma lexojë.

Do ju kujtoj për mërzinë e gurëve,
që unë kisha braktisur dikur.

Vjeshtë, 22 tetor 2013

FILOZOFIA E FJALËS

Fjalën deshën ta zhveshin nga fjala,
nga magjia e saj që një komb e ngre në këmbë.

Deshën ta vrasin si në duel, tinëz
në udhët pa kthim
por nuk mundën dot.

Deshën ta mbyllin në qeli,
ta shkëpusin nga vetë fjala
edhe këtë nuk e bënë dot.

Hëna është ngjitur në qiell,
me pamjen e kaltërt
tek ndrit xhamin tim përjashta.

Një dritë pingule
sytë m'i zverdh.

Më hyn brenda meje,
si shtizë kur fjala depërton thellë.

Fytyrën kam mbështetur në xham,
duke pritur fjalën t'ma thotë
brengën e saj të fundit.

Prej fjalës nuk rrodhi,

as brenga as dhembja
veç triumfit sot në liri.

Vjeshtë, 29 tetor 2013

HËNA XHELOZE

Edhe pse të panjohur krejt,
e zjarrtë si yje djeg ajo.

O Perëndi në mundësh ktheje mbrapshtë
se poetët vetëm kudo janë.

Një lloj epshi i saj,
në mua qarkullon si i dehur pamasë.

Rënkoj thellë sa mundem,
përjashta nata turp e zezë më vret.

Hëna xheloze në mua sytë gjithë vrer,
O qiej sonte një shtizë poeti në mua ka hyrë.

Më vret
si në duel!

Slavica DABEVSKA QIROVSKA (MAQEDONI)

Slavica Dabevska Qirovska është e lindur në Tetovë. Shkruan poezi dhe prozë. Deri më tash ka të botuar këto vëllime të poezisë bashkëkohore: "Bulki pokraj prugata" (Balluket përreth hekurudhës), "Vençanica" (Dasmë), "Dusha koja gree" (Shpirti që ngrohë) dhe "Samo xvezdite znaat" (Vetëm yjet e dinë). Së shpejti do botojë edhe romanin "Zeleniot kaput" (Palltoja e gjelbër). Dhuntinë e saj poetike, poetja e paraqiti para publikut në ngjarje të shumta poetike në Maqedoni, Serbi, Bosnjë e Hercegovinë. Poezia e saj është paraqitur në shumë portale letrare, shumë herë ka marrë çmime në takime poetike për të cilën flasin diplomat e shumta dhe revista në të cilat është paraqitur. Tërë energjinë krijuese e drejton në ndërtimin e veprave artistike, ku përveç shkrimeve ajo talentin e saj e tregon në muzikë dhe pikturë. Diturisë i jep kahe dhe i përkushtohet edukimit dhe shkollimit të fëmijëve të vet, sepse punon si pedagoge. Është anëtare e Shoqërisë së shkrimtarëve të R. të Maqedonisë. Jeton, punon dhe vepron në Tetovë.

ZONJA HYJNORE

Zonja hyjnore, mbretëreshë e tokës
Kurorë mbi baltë, mbi errësirën shekullore
Më prano, shpirtin e hershëm krishterë,
Të mbetem e përzgjedhura jote e njomë
Edhe pse bredh, cilësi kam.
Zonja ime: mbjell mëshirë
Mirësia jote që shpresë mbi mua zgjon
Aq mbifuqi ndaj gabimeve qorre.
Pa të shpirti nuk është i denjë,
Besimi në vdekje dhe në jetë më mbështet.

Mëkatet e mia le të heshtin!
Më fal si fëmijës tënd
Dhe e di që nuk do të më mundojnë
Dhe ju lutem bekoni,
Edhe pse vet i premtova djallit!
Më ruaj, ai mëkat mos më paraqitet,
Virgjëreshë, më dërgo përtej pragut
-fshehtësinë e shenjtë- në detyrë kremtohet!
Besimi në vdekje dhe në jetë më mbështet.

Shoh: në Zot dhe në motivet e tij
Në pikturë parajsa, me harpë dhe kanu,
Kjo frikë, ajo gëzim më ngjallë.
Më jep gëzim, e shenjta hyjni
Që mëkatarëve ndihmë u jep
Jam gjithë besim, pa më të voglën hakmarrje
Besimi në vdekje dhe në jetë më gjykon

MBRËMJE E HESHTUR

Kjo zile që ndrit n'dhoma
Nën qiell të huaj më shtyp tani
Eh, tjetrit që në psalmë nëm
Mbi mjerim, është qyteti që më shtrëngon.

Vajto, zilja ime mike. Dhimbjes
Jepja atë që pushon, vello të zeza
Bjeri me luhatëse gjoksit, me kunj
Të pëlcasë zemra mbi brinjët tuaj.

Heshtazi tingëllojnë .... veç mendimet më hanë
O, prehja e mbrëmjes gjithmonë më lodhë
Heshtje... Vetëm jam... Në dhomë e vetmuar!
Mbi ballin, digjet puthja jote e dashur...

Nemisje! Emocione të forta! Tento, mendim
Ngrit dëshirë, mëndje më dërgo pas Nuhut.
Bëju shakullinë, stuhi, zë, varkë me rrema
Jeho në shpirt, me zilen tënde.

GRIMCË E BEKIMIT

Vjen koha të derdhet dhimbja
Vjen ngadalë koha e mirësisë
Mirupafshim ja çasti i agonisë
O, rinia ime tash dihet ardhmëria.

Nga pendla të butë rënë nga çerdhja
Të arkangjelëve dje të reve të ndritshëm
Më të ndritshëm edhe se unaza e hënës për çudi
Nga të gjitha rrezatimet dhe shkëlqimeve magjike.

Ngadalësoj ecjen që të shoh para meje
U gjenda sikur para kopshtit të zjarrtë
Një shpirt i përvuajtur theket me ty
Tash hapëroj pas gjurmëve shpirtërore.

Nuk vdiset nga njohja e dhimbshme
Ky është çast i mëshirës së zjarrtë
Kaluan shumë vite të provokimit
Koha ngadalë më çon në dritë.

Botëra të qeta i zbulova tash të qarta
Shpirti tash më pret si lulja
Nga e cila lindin fryte të majme
Piqen kodrave drejt horizontit.

E them jetë e vërtetë
Vetëm unë mundem të këndoj kështu
Këngët e mia janë grimca të bekimit
Heshtni këngëtarë tjerë, kur do të qahet.

Përktheu: Artan Arsllani



Braha ROSENFELD
(IZRAEL)

Poete, kritike, përkthyese, botuese, lidere e grupit. Që nga 1990, poezia, kritika letrare dhe përkthimet e saj, kryesisht nga polonishtja dhe gjithashtu nga rusishtja dhe anglishtja, janë publikuar në shumicën e revistave dhe shtojcave letrare në Izrael. Poezia e saj është shfaqur në revista prestigjioze dhe antologji jo vetëm në Izrael, por edhe në Poloni dhe Rumani. Ajo ka shërbyer si kryesuese e Unionit të Shkrimtarëve Hebraik në Izrael. Katër përmbledhjet e poezisë së saj (hebraishte) janë botuar deri më sot:

Vajza e zjarrit, Vajza e Ujit -Sifriat Poalim Publishers, 1994;

Shulamit dhe Njeriu i zjarrit - Iton 77 Libra. 1988 - subvencionuar nga Fondi Amos;

Nëna ime pikturon - Eked Publishers, 2008 - subvencionuar nga Fondi i Arteve të Yehoshua Rabinowitz , Tel Aviv dhe Yad Vashem;

Pastaj unë isha te Zanafilla, Safra Publishers, 2010, të cilës ju dha çmimi ASI (Organizata e Shkrimtarëve të Izraelit) 2009.

Braha Rosenfeld i takon brezit të poetëve të periudhës së pas krijimit të shtetit; poetë këta të cilët kombinojnë historinë personale dhe kombëtare në shkrimet e tyre. Natyra e ndërlikuar ekzistenciale e punës së saj, e pasuron dhe e paraqet poezinë e saj një sfidë emocionale dhe soditëse për lexuesit.

PIKETAT

Eja te unë nga Jugu
nga Afrika e largët, le të themi:
Kepi i Shpresës së Mirë - vendi
ku të gjitha anijet frikësohen.

Pra: eja tek unë nga Jugu -
ja gishtërinjtë e mi,
ti the se këmbët e mia janë aq të bukura -

Ngadalë, ngadalë.
Goja e puthur e juaj mund të mbulojë
të gjithë kontinentin
me prekje të ngrohta të një njeriu të zi,
drita shkëlqyese jugore
dhe ashkla të ametistit.

Por, të lutem, mos u mbyt në Detin e Kuq.
Ecë me frikë, kalo me kujdes
në mes të dy Shtyllave të Solomonit,
si në mes Dyerve të Parajsës dhe
Dyerve të Ferrit,
me gjuhën e lëmuar
dhe buzët e dridhura marrin
rrugën e shenjtë, në Jerusalem.
Ku një grumbull gurësh të dashurisë të presin
me një pyll të pishave.

Pastaj, shko poshtë,
poshtë derisa bien
në zemër të Luginën e çarjes së Madhe,
Deti i Vdekur, shënimi më i ulët
në rezultatin hyjnor
ku veshi i madh i brendshëm
është qëllimshme në dëshirën
të bëjë dashuri.

Në Shkretëtirën e Judesë, në kufi me egërsirën,
Trumbetat e Jerikos do të shpërthejnë,
zhurma tektonike ka me të shoku
dhe dy prej nesh do të ngrihen
kaq pranë, kaq larg
Zot.

AJO KA NJË PALLTO TË THELLË, ME XHEPA TË HESHTJES

Ajo ka një pallto të thellë, me xhepa të heshtjes
hije e degraduar, pa zotërues
dhomëza për vdekje të panatyrshme:
gjymtyrë-të copëtuara, zë-mbytur, kryepremë
dëshirë-shkatërrimtare
në heshtje, në heshtje,
ajo nuk do të rënkojë
sepse ajo ka një xhep pallto të thellë me heshtje
më e mira e të fshehtave dhe kurorëzim të djallëzuar
me një gjokszbuluar, me shumë qëllime
dhe mëngë të gjera, erë përqafimi

ajo ka mësuar të veproj brenda kufijve
për të dërguar sytë e saj si zbulues

drejtësia e saj kthehet në malinje
ajo ndrydh zërin e saj për të fshehur lakuriqësinë

konsideron veten në pasqyrë me neveri
ulet me gjunjët e saj s' bashku, pi gllënjka të vogla
nga gota porcelani t'kockave, kujdesshëm
t'mos derdh e t'mos njollos emrin e saj të mirë
dhe uniformen, ndërsa brishtësia harkon kokën e saj
një kreshtë e heshtjeve përhapet nga flokët e saj.

ajo është zbutur nga gishtat sekrete për të mos e thyer
akullin e heshtjes së saj,
zilet e saj kumbuese do të mbeten të padëgjuara
lira e saj i është marr, vargjet ju konfiskuan
Këslëkuqja- thanë ata
e joshi ujkun e keq - ajo beson dhe shpërblehet,
kërkon dorën e Mjekër Kaltrit, në vdekjen e saj.

pallto e saj është e mirë dhe e ndritur, me ajër e ngjyrosur
me mjeshtri qepjeje, me thurje të fshehura
shpiku më parë përjetësinë e rritur në trupin e saj
vendosi poshtë rrënjët si këmbë-nofull
planifikon të tërheq lëkurë gjarpri.

një pallto e mbushur me heshtje
thellësitë amniotike fëshfërijnë me meditime embrionale
si dhe një kor bilbilash me një orkestër bulkthi
dhe kopetë, dhe kopetë nga fauna të ndryshme
kështu: ata dërguan agjentë të fshehtë
roja në porta dhe hapje
për ta mbrojtur nga sekretet e Kopshtit të Edenit.

ajo s'mashtron kurrë, kurrë s' vjedh kuaj
vetëm: herë pas here vjedh shikimet e habitshëm
dhe e mban të heshtur lidhjen me zjarrin e vjedhur
dhe ujin e huazuar
një pallto e mbushur me heshtje.

ajo s'beson në amazona me një sisë
as në moirai, liliths ose vampir
shqisat e saj janë të fuqishme, ajo e do aromën e ëmbël të pasionit
ajo s'do të jetë një kufoma e hijeshuar, një
këngëtare e ëmbël fytyrë zbehur

ajo i ka xhepat e plotë
ajo do të shkëmbej një impuls ngjallje për fjalë

ajo digë u plas
dhe shumë ujëra dhe shumë ujëra
dhe një bollëk i pabesueshëm
Zoti

(Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj)



Robert SIMONIŠEK (SLLOVENI)

Robert Simonišek (1977), poet sllovenі, shkrimtar, përkthyes dhe historian arti. Gjatë studimeve të tij, Simonišek punoj si gazetar për gazeta të shquara sllovene dhe ka qenë në një turne udhëtimesh përreth Evropës. Pasi mori Master dhe Doktoratën në historinë e artit, ai dha mësim në Universitetin e Lubjanës dhe ka kryer punime në literaturën sllovene. Deri më tani, ai ka botuar tri koleksione poetike (Katalogu i mbuluar nga uji, 2003; Një Vetë-portret pa një hartë, 2008; Migrimet, 2013), një koleksion tregime të shkurtër (Shikimi melankolik, 2011), monografia (shkëputja Sllovene, 2012) dhe një roman (Dhoma Poshtë Kalasë, 2013) i cili është nominuar për 'Kresnik', »Librin Slloven«. Vëllimi i tij i fundit Migrimet pranon kompleksitetin e dashurisë njerëzore dhe vetëdijes së humbjes. Në vargjet medituese ku vetmia frymëzon, përkohshmërinë, dobësinë, shpresat dhe ndarjet kanë përfaqësuar ndalesat, zëri i autorit është në gjendje të ndjell bukurinë. Shkrimet e tij janë përkthyer në anglisht, kroatisht, çekisht, spanjisht etj dhe janë shfaqur në një numër antologjish. Jeton në Celje.

HOUSE

Do të doja të ndalem këtu,
ndoshta vetëm për disa muaj,
ndoshta për disa dimra.

Jeta është më pak e parashikueshme
se kolonat e gazetave, pozicioni
i tyre i pandryshuar që nga dita e djeshme
karikaturat qetësonin me pushtet.
Jeta është më e ndritshme se xhami më i hollë,
e cila fluturon në tokë dhe qiell
Para se të vonojnë vendimet tona.

Nuk çaj kokën nëse qeramikat janë të shurdhra
nëse zëri i vijave të derës vrimave të tyre
dhe dritaret rrjedhjen e ajrit të mprehtë,
brejnë dhomën e gjumit gjatë natës.

Dua të mbledh mendimet nën këto tavane,
Dëgjon jehonat e variacioneve,
kthehet përmes një korridori të gjatë
dhe ngulit veten në një peizazh vjeshte.

Të gjitha venitjet e jetës ishin
në mëdyshje për të bërë marrëveshje
ndonjëherë në vende të rrezikshme,
ndonjëherë në procesin e magjistarëve të mira.

Leri muret e bardhë të rritet lartë
dhe gjestet e pjesëve tjera të tyre
lodhjet e trotuareve,
më lejoni të ulem nga flaka,
duke tërhequr shpirtrat pas shpinës time.

Do të doja të ndalem këtu,
dorëzojë pasaportën time të shqyer të kohës.
Pastaj do të mbyll derën e përparme,
të vazhdoj me të njëjtën arsye,
para se nata ta kapërcej gardhin.

GRUA E RE

Përmes qytetit provincial
një muzikë latine shprish flokët e saj
shpërndarë kudo
me korin e pyjeve lartë.
Buzëqeshja e dhëmbëve të bardhë,
një mendje e pa fund me lëvizje të vonuara.
Mbrëmja shtrihet përtej pritjeve.

Qershitë prekin thelbin e majit
dhe nëpërmjet të gjithë ajrit të tendosur,
i cili mbeti i shurdhër
në mënyra të ditës së
ajarit midis treguesit të orës
dhe rrugës boshe.

Bakër i errët derdhur nga çatitë,
mbi faqet aromatike dhe sy mbyllur
pas pragut të shtëpisë së Zotit
injoroj profecitë e lashta.

Sonte era endet përmbi pemët
varros gjurmë te të njëjtëve emra
që kanë nevojë për zërat tanë.
A guxojmë të pranojmë se vetëm lëkura
na liron nga toka
dhe koha agnotike?

Shtëpia në të cilën hyra ka pesë dhoma.
Të gjitha të bardhët lundrojnë në drejtim të masës portokallike
që nuk ndërhyn me zakonin tim.

Për një kohë unë do të ulem në verandë
dhe të dëgjoj për veten time. Pastaj do të zbres
nëpër kopsht në një tjetër mbrëmje të zakonshme,
me kujdes, që të mos ndërpresë afër
midis meje dhe hënës së plotë.

AIROPORTET ETJ

Të gjitha këto shifra po bie shi nëpërmjet nesh,
një dritë ngjitet lartë përtej qelqit
dhe thyhet në copa të aluminit me shkëlqim
në hapat e pasazhet ngushëlluese,
të gjitha saktësitë e numrave ndezjet
dhe pastërtia duke u përpjekur të na bindë
se ne janë të rëndësishme dhe qëllimi
për në vendin e duhur.

Edhe pse ngjyra qifte vetëm kohët e fundit
fluturoi larg nga duart tona në pasdites,
duke lëvizur në të gjitha drejtimet e qiellit,
deri sa u bashkua me bar të butë
pëlqen buzët tona.

Ne të gjithë e dimë mirë se ku ishte fillimi
dhe ku fund i ditës,
se si të kthehem nga shtigjet me baltë në dhoma
plot zëra kadifeje.

Tani shikimet më të errëta sigurojë drejtimin
ndërsa ne ulemi në sallat,
pavetëdijshëm për njëri-tjetrin,
imituar gurin egjiptian
me këmbët tona të kaluara, duke pritur
të bëhen të lehta përsëri.

Askush nuk e di se kush do të ulet pranë nesh,
sa lartë duhet të rritet,
kur buzëqeshja detyruese e shoqëruesit e fluturimit
imiton ndjenjën e sigurisë -
si në një kurs të emocioneve njerëzore.

Ne kemi mësuar të jetojmë pa ankesa,
gjestet tona nuk zbulojnë thelbin.
Retë flok bore komplot pritjeje
si në qoftë se ne ende nuk e dimë
se cili shtet është i shkruar në hartën tonë,
sikur nëse ne kemi harruar
se si e ngurta një pemë është
kur ajo rritet nga toka.

Translated by the author, Katarina Rakušček and Mary Kathryn Dunn.

Përktheu nga anglishtja në shqip: Jeton Kelmendi

Victoria SLAVUSKI (ARGJENTINA)

Victoria Slavuski është një poete, noveliste dhe gazetare kulture argjentinase me vendbanim në Evropë. Proza dhe poezia e saj janë publikuar ne shume gazeta dhe revista letrare, midis të tjerave "Opium", "Sunda", "Subdream", "Ex-Tempore", "Fiaker Haiku" (Schule fur Dichtung), "Krytia", "Archipelago", "Humlog", "Poetica(e)" "National Radio ABC Australia", etj.

Është anëtare dhe performon rregullisht tek Labyrinth, shoqata e poeteve të Vjenës. Ka botuar një novelë, "Muzikë për të harruar një ishull", Planeta, 367 faqe, Buenos Aires, (kritika, komente dhe shënime akademike rreth materialit gjenden online në internet). Po përfundon një novelë të dytë, Camara Gris, me ngjarjet e vendosura në Vjene. Esetë, intervistat, dhe artikujt avan-gard mbi artin, teatrin, letërsinë, muzikën kontemporane, janë publikuar në shumë gazeta dhe revista, ndërmjet të cilave, La Vanguardia, në Spanjë, ku ajo kontribuon rregullisht në suplementin kulturor, Kunsthalle, Der Standard (Austri), Times Literary Supplement (Angli), Frankfurter Allgemeine Zeitung (Gjermani), El Clarin, La Nacion, La Opinion, Panorama, Confirmado, Pagina 12 (Argjentinë), Corriere de la Sera (Itali), Best Of (Portugali) dhe Krytia (Indi).

PAVARËSISHT

Pa marrë parasysh se sa i zgjuar je
do të vdesësh
pavarësisht se sa i hijshëm je
sa zemërbutë, sa koprrac
sa i zymtë,
pavarësisht sa i errët je
sa i droguar
sa i bardhë
pavarësisht se sa i lehtë
sa i mirë
pavarësisht gjendjes tënde shpirtërore
sa i keq
sa i çmendur
sa i dëshpëruar, sa i trashë
pavarësisht cilës fe i përket
pavarësisht se sa besimtar je
pavarësisht sa dështime ke kaluar
sa suksese, sa ekstaza

sa justifikime, sa abuzime
pavarësisht sa i mëshirshëm apo i devotshëm je
sakrificave për të realizuar veprat e tua
pavarësisht sa i ëmbël, sa i ri, sa i dobët

Apo sa plak dhe i humbur dhe i devotshëm
pavarësisht besimeve të tua
pavarësisht sa i trembur je
ti do te vdesësh
unë do te vdes
pavarësisht se si
sa produktiv apo joshës, sa krijues
apo sa likuid, apo sa i hollë
apo sa koprrac apo sa nevrik
sa dinjitoz apo sa mumje je
pavarësisht se sa frikacak je
apo një bujar i pasionuar
sa i trembur apo sa i mençur
sa i mërzitshëm
sa i rënë shpirtërisht, apo sa i mprehtë
sa i talentuar
sa korrekt apo inkorrekt je politikisht
altruist, egoist, hedonist
pavarësisht sa mizor apo i shurdhet je
ne me siguri do të vdesim
unë do të vdes
dhe djali jot
dhe i dashuri im
dhe babai jot
miqtë dhe armiqtë e mi
dhe macja jote
dhe qeni i xhaxhait tim
dhe çdo plesht
dhe kanarina e të gjithëve
pa marrë parasysh sa i famshëm je
sa i sinqertë, sa hipokrit,
pavarësisht se sa shtëpi, lopë, apo makina ke
apo libra, apo të dashur, apo borxhe
pavarësisht besimit tënd, racës tënde
apo sa i varfër je
sa i bukur apo i shëmtuar
pavarësisht se sa budalla je
sa primitiv
je
sa i dashur je
sa të duan, apo s'të duan
ne sigurisht do të vdesim

Pavarësisht se çfarë bën
çfarë dëshiron që të kishe bërë
apo çka bëre, dhe do doje mos ta kishe bërë
apo që nuk do ta bësh kurrë
pavarësisht se sa dëshiron të flasësh
apo të qeshesh, apo të vjedhësh, apo të qash në shkretëtirë
pavarësisht se sa i shëndetshëm apo i pasur
sa i sëmurë apo elegant
ti dhe unë sigurisht do vdesim
si të gjithë, në formën tonë të tanishme, apo në manifestimin
që do të shuhet

lufta dhe vrasja, janë gjithmonë mbi-vrasje
gjithmonë te tepërta.

MBI VENEDIKUN

Per Cesare Caterisano

Fjala Venedik
është një gondole e vogël
tërhequr nga prapa para
përshkruan kurbat
dhe mbaron lart
shtrihet jashtë gojës
dhe ledhatohet nga e prapmja e dhëmbëve
dhe maja e gjuhës.
Megjithatë, unë nuk mund të shkruaj rreth
Venedikut.
Venusi u lind ne Venedik
U lind prej shkume
Ndërmjet Le Zattere dhe La Giudecca.
Pavarësisht, unë s'mund të shkruaj mbi Venedikun.
Shën Zandegola në dialektin venedikas
Do të thotë Shën Johan kokëpreri.
Italianët e tjerë bashkojnë fjalët
njëjtë si të kenë bashkuar mbrapsht kokat
mbi qafën e përgjakshme
por koka dhe qafa ime
nuk mund të ngjiten
derisa unë shkoj mbrapsht
në Venedik.
Ndërkohë, unë i pres kokën gjithçkaje
I pres kokën fjalës Venedik
Dhe gërmoj mbi Venedik, edhe pse kështu

Unë prapë nuk mund të shkruaj mbi Venedikun.
Kjo nuk është një poezi mbi Venedikun
Kjo nuk është poezi
Kjo nuk është rreth
Kjo nuk është për Venedikun
Venediku është poemë për vetveten
Venediku të shkruan ty
të kthen ty në një poeme rreth vetes
në të cilën ti kthehesh në një poemë të pafundme
për Venedikun
Venediku gdhend tatu gondolash të vogla
mbrapa syve të panumërt turistikë
që bëhen poezi të panumërta, të lëvizshëm për
Venedikun
duke shkrepur aparatet
duke pirë hijet e Calli dhe Kanalit
deri në kockë të shpirtit të tyre.

Dhe ju tani ke Tiepolin blu
sytë e Tzianos, lot
te kuq të Muranos
sepse ju nuk mund të shkruani për Venedikun
sepse ju nuk e dëshironi këtë
sepse nuk ka aspak nevojë për këtë.
Tek Shën Mëria e Frarit ka një pikturë
Në të cilën çdokush vështron shenjtin në qendër
Kur një çunak i vogël vështron tek ju
Nga një qoshe e pikturës
Duke dalë prej Seicentos
Për t'ju shpjeguar juve
Pse ju nuk mund të shkruani për Venedikun
Në këtë jo-poemë
Jo për Venedikun
Dikush do të dëshironte të mblidhte
Impresionet e tij për Venedikun
Por djaloshi i zverdhur Tiziano duket sikur u pyet
A është e mundur të mbledhësh impresionet?
A është e mundur të mbledhësh diçka?
A je ndonjë venedikas i verbuar?
Si hëna e varfër
Xheloze e kohës, mbledhësja e vetme-
Me rrëfe!
Do të dëshironit të ishit Venedikas
Nëse Venediku nuk do të ishte një ide
E pasqyruar ne valët e vogla të kohës
Përmes orëve midis të cilave kalon uji
De Chirico natën
Bukuri joreale, e brishta bukuri

Teatri i bukurisë tuaj
Prezenca jote teatrale me maskë të ujit
Më shndërron mua në një personazh tragjik të
Kohës
Që pështpërit: O Venedik
Diferenca mes meje e teje
është se unë njëherë isha në qendër të bukurisë
Siç ti gjithmonë je
Gjaku im është plot gondola të vogla
Me njerëz që duartrokasin
Për të festuar vetveten
Sytë e mi ishin një fluturim pëllumbash
Dhe zemra ime ishte një krah luani
E cila kishte tashme një dorëshkrim
Nëpër faqet
Unë s'mund të shkruaj kurrë për Venedikun.

---

* Gondola – anije veneciane
* Tiziano – Artist venecian

KALIGRAMATIKA E FLUTURËS

fluutur fluuuutur flutur fluturo
veeeemjjje vemje kërthi flutur kërthi
së pari veeeemjjje më pas kërthi përpara
veeeemjjjes më pas kërthi e pastaj fl uuu tur
flutura ma ri po sa schmetterling papillon kelabek
lindur prej kërthisë së vet çmendurake
mbesë e vetes –vemje zvarritëse—fluturon
tashmë rreh krahët fluu tuuuu ro njëse,
iguane lamparine petaluma, hap dhe mbyll paf-puf
cho- cho në momentin, në momentin e vibrimit
vëre kush merr frymë paf-puf cho-cho në
momentin, në momentin
në momentin që ndan jetën nga vdekja, në
momentin, në momentin
unifikuar në momentin vertikal të njëshmërisë, rreh
krahëzat fluturuese: thithili kimimila
parpar kepepeo paro-parong-buki pinpilinpauxa
eporiporit ajo ulet: motyl falter titer pee plim,
ajo fluturon: flutura farfalla fifoldara prajapathi
kokaa pepeo borboleta tximeleta balbaiana,
pulelehua balanbaalis bataplai afafranto
kabakaba poompata apalotl osampurumpuri
pilipintu bilibala bedelallha alibangbang
marisorgin del prej qetësisë ose zvarritet e shtriqet

paraprin ndryshimin: ex phantasmatic
vemje kërthijë në fluturimin frymëmarrës
mbi pauzën e pafundme të sintetizuar ndër
dhomëzat e zemrës, në momentin
kur mbi boshllëkun e dukshëm të pabesueshëm të
momentit, mbi faqet marramendëse ose në pritje
të të tanishmes – flakëron duke goditur të tashmen
– flutur pa histori, bukuri apo keqbërëse e kurrës
dhe kurrfarës
mbyllur ne te kaluarën, hapur në të tashmen,
zhdukur në të ardhmen
flutur e momentit
e tani dhe tanishmes
zbret prej ajrit shpëton
fluturimthi eshte e mbaruar
ashtu siç e fillon flutrimin
ndermjet çdo gjëje dhe as gjeje

Përktheu nga anglishtja: Lediana Stillo

---

* mariposa Schmetterling papillon Kelebek, - lloj fluture



Nicolaj STOCHHOLM (DANIMARKË)

Nicolaj Stochholm ka lindur në Kopenhagë, në vitin 1966. Duke jetuar dy vite si fëmijë në Spanjë dhe Tunizi, ai ka botuar poezitë e tij të para në revista letrare në moshën 17-vjeçare, ndërsa ende shkonte në gjimnaz. Në moshën 18 vjeçar, ai u nisë për në Francë dhe më pas në Spanjë, ku qëndroi për 3 viteve duke punuar në atë që do të bëhej përmbledhja e tij e parë me poezi, të cilat u botuan në vitin 1991. Ai ka ndjekur studimet në Universitetin e Kopenhagës derisa në vitin 1992 arriti të jetoi nga shkrimet e tij. Ai kaloi më shumë se 6 vite në Spanjë, Marok dhe Irlandë. Ai tani është i vendosur në Kopenhagë, ku shkruan dhe luan në bandën e rokut The Liquid. Poezia e tij është përkthyer në shumë gjuhë dhe është publikuar në antologji dhe revista, në shumë pjesë të botës. Aktualisht një vëllim i poezisë së tij është në përgatitje për botim në Greqi.

Çmimet për poezi:

1994 Çmimi Michael Strunge

1994 Granti 3 vjeçar i Këshillit të Arteve shtetërore (The State's Artcouncel)

2002 Çmimi Beatrice i akademisë daneze

2003 Emil Aarestrup Medaille

Bibliografia:

Biografi (Biografia) 1991, Borgens Forlag (Sh.B. "Borgen")

Sammenfald (Bashkimi) 1992, Borgens Forlag (Sh.B. "Borgen")

Rekonstruktion (Rikonstruksioni) 1998, L & R Forlag (Botimet L & R)

Sange fra et ophør (Këngët nga fundi) 2000, L & R Bibliotek (Libraria L & R)

Femogtyve digte og en drøm (25 poezi dhe një ëndërr) 2000, Botimet Gyldendal

Aldrig mere (Kurrë më) 2008, Botimet Gyldendal

Odefabrikanten (Prodhuesi i odes) 2011, Botimet Gyldendal

Rim Ødelagt (Rima tw shkatërruara) 2013, Botimet Gyldendal

Ana tjetër e peizazhit. Një antologji e poezisë bashkëkohore nordike në përkthim amerikan. Botimet Shope, New York 2006

Muzikë dhe poezi:

Gartner, Artpeople Records 2005

Færden, Geiger Records 2008

The Liquid, Atlas Interplan. Slow Shark Records / VME Nordic 2013

AUTOMORFOLOGJI I-IV

I

Retë e zemëruara nga të shkruarit
kërcënojnë peizazhin tim
kur më në fund
kapa shpatën time
ajo ishte ndryshkur qysh moti.

është një klithmë pa lot
është një plagë që s'do të shërohet
është një det që s'do të lulëzojë.

Është një kalë i verbër
ka një tjetër qartësi
ka një varr pa asnjë kufomë të vetme

S' ka zemër: një i dëbuar
S' ka shtrat për të këputurin
S'ka flamur për erën

Unë tani jam në shtëpi kudo
dhe nuk vijë më
nga kudo

II

Si mund t´a rikrijoj këtë shpatë
e cila e mban tërë forcën time
unë mundja ta dëshiroja erën përsëri
pa humbur veten time
dielli do të heq lotin e qiellit

Këtu retë mblidhen për të harruar shiun
këtu çdo kufij këndon si zogjtë e plotfuqishëm
duke mbrojtur veten pas hartave dhe krahëve në
fluturim

Këtu shkretëtira derdhet me etjen e të afërmit
këtu era mbërtheu trupin tim
duke ofenduar thellësisht t' gjithë ëndrrat e mia

Asgjë s'e ndjek ndrojtjen këtu: e gërryera
këtu toka nuk mban mend fuqinë e kuajve
këtu era fshinë çdo gjurmë

Unë duhet të largohem: Unë duhet të pushoj
Unë duhet të fillojë: Unë duhet të fitojë
para se çdo gjë të ngurtësohet dhe të gjej një formë

III

Ku shkon shiu të fsheh lotët e saj
që fsheh shkrimin në një zemër prej guri
Unë duhet të gjejë grimca të asgjësuara
skema e thellë e gjurmëve të rrotave
të cilët mbajnë fajin për këtë vend

Dëgjoj zogjtë që zhduken me klithmat e tyre mitike
nga gërmadha në fabrika të pluhurosura, kjo farë
e vetme që digjet para se të arrinte qëllimin

Dhe tani The Spikes këndojnë- kurrë s'arritën
hijen dhe vdekjen e shirës
dhe janë të akorduar si portal varri në stacion
televiziv

Trupi tani sfidon trupin
pandërprerë, i lig, duke pritur
me sytë e pastrehuara si një biletë metro

A duhet s'pari vërtetë ta shemb
këtë vend, të cilin
kamë ardhur ta posedojë

IV

Tani ëndrrat e mia vijnë dhe fundosen përsëri:
Unë jam ulur në peizazhin statikisht të çliruar
i cili është i gjallë dhe lëviz me kohën
aty ka njerëz, kafshë dhe bari ku mund të shkeli;
një ujëvarë derdhet në mes të gjitha krijesave

Një ketër përpiu hijet tona e ne buzëqeshim
shitësi na jep fruta
nga toka dhe pemët, nga era dhe retë

Ka peshq të ngritur nga deti-
deti nuk është oqean por çdo valë këndon
për natën dhe qiellin e veshur me zëra pyjore

E gjithë kjo jetë duke i dhënë ujë
jo një lëng
por siguri e gjitha gjërave

Unë duhet të kthehem: ky s' është parku im
sytë e mi të mbyllur, ky është vizioni im
pallati im i dimrit, i zbehtë dhe i zbrazët, detyrohem
ta hapë.

Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj



Christos TOUMANIDIS (GREQI)

Christos Toumanidis ka lindur në vitin 1952, në Pella të Greqisë Veriore.

Që prej vitit 1965 jeton e punon në Athinë. "Peripecinë elegante të poezisë", siç thotë dhe vetë, e nisi në moshën 16 vjeçe, por përcaktuese në gjithë krijimtarinë e tij ishte miqësia e ngushtë me poetin e madh, Janis Ritsos, pranë të cilit "mësoi jo vetëm sekretet e krijimtarisë poetike, por edhe të kultivimit të shpirtit".

Në letrat greke paraqitet së pari në vitin 1978, me përmbledhjen e titulluar "Paparashikueshëm". Që atëherë ka botuar më shumë se dhjetë vëllime poetike, ndërsa është një nga lëvruesit më të shquar të poezisë haiku në Greqi, duke përgatitur edhe disa antologji.

Poezia e Toumanidis-it është përkthyer në anglisht, rusisht, persisht, suedisht, ndërsa dy vëllime të tij poetike ("Duhmë qirinjsh" dhe "Hije që ecin", janë botuar në gjuhën shqipe në vitet 2006 dhe 2009.

Toumanidis është ndoshta propaganduesi më aktiv i poezisë shqipe në Greqi, duke i prezantuar herë pas here në revista letrare dhe portale elektronike greke, krijimtarinë e kolegëve të tij shqiptarë.

Tre poezitë e paraqitura në Antologjinë e festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit", janë shkëputur nga vëllimi i tij i fundit poetik "Elegjitë e Lindjes", botuar në 2014.

1. NJË VJERSHË MË KËRKUAN TË SHKRUAJ

Një vjershë më kërkuan të shkruaj
Për Ferrin tokësor
Që e quajtën Rripi i Gazës,
Që e quajnë Nahal, Erez dhe Xhenim.
(Paska dhe ferri fshatrat e vet të panjohur!)

Një vjershë – klithmë u rreka të shkruaj
Dhe qysh atëherë nuk kam më gjumë
Nuk kam lot. As zë nuk kam.

"Mjafton me sytë e shpirtit, për një çast,
Të shohësh në lindje t'Edenit", tha.

Dhe nisi menjëherë shiu.
Një shi lajmesh të zeza.

2. E Ç'PËRRALLË T'U THEM FËMIJËVE?

E ç'përrallë t'u them fëmijëve?
Fëmijëve që qysh në pelena
Prekin këmbëza pushkësh.
Dhe nga gjiri i nënës pinë qumësht të zi.
Dhe befas bëhen burra.
Martirë. Bëhen Kujtesë.

(Përmes shpërthimesh e bubullimash lufte, fjalët
Si bomba vrasin edhe ato).

Na ish një herë e një kohë dielli...
Ishin ullinjtë dhe vreshtat tanë.
Erëzat e kopshtieve.
Ishte flladi i Hermonit që çelte shpirtrat.

Njëmijë e një net pa qiell.
Shehrezadeja dhe Aladini më nuk jetojnë.
Mirëpo, nëpër gërmadha ne –
Nëpër strehimet, netëve pa yje –
Duhet t'u pëshpëritim
Përralla të reja fëmijëve.

Duhet përsëri të bëhet diell. Dhe fllad
Një qiell përrallor me krahë tokësorë.

3. PËR TY, LINDJE E MESME

Mitër e ikjes dhe nënë e dhimbjes tonë.
Ty dhe gjakun tënd mbartim të gjithë ne
Që i përkasim perëndimit.
Njëmijë e një net të ëndërruam
Dhe po aq të mohuam.

Njëherë e një kohë ishte drita.
Dhe trumbeta e diellit.
Por sot, siç thonë "të menpurit"
Je errësira e frikshme.
Erebusi i shpirtit tonë.
Fundi i një iluzioni të lashtë.

Në kopshtin e Edenit dhe Tokën Hanaan
Nuk çelin lule. Nuk lidhin ullinjtë.
Bomba dhe raketa dhe varre, varre, varre...
Dhoma fëmijësh në gjuhë flakësh.
Lutje.

Shpresa qiellore.
...
Ndërsa zotat e botës; Analistët
Mblidhen në Brukselin e smogut.
Planizojnë tragjedinë njerëzore të radhës.

Përktheu: Robert Goro

Björk ÞORGRÍMSDÓTTIR (ISLANDË)

Björk Þorgrímsdóttir ka lindur më vitin 1984, në Reykjavik. Ajo ka kryer studimet për filozofi dhe literaturë, si dhe ka mbaruar masterin për shkrim kreativ pranverën e kaluar.

Björk ka botuar poezi në revista të ndryshme letrare. Ka publikuar dy libra me poezi; "Bananasól" (Banane Sun, 2013) dhe vëllimin "Neindarkennd" (The Feeling of Nothingness, 2014).

Përveç krijimtarisë letrare, ajo ka marrë pjesë në manifestime të ndryshme, që kanë në qendër të tyre gjuhën.

SERENADA

Kështu. Këtu. Janë. Duke qëndruar. Ne. Jami këtu.
Ne këmbë. këtu ne. Duke qëndruar kështu jemi.
Ne këtu. A jemi. Këtu pra këtu.
Ne jemi ne. Kështu ne këtë mënyrë. këtu qëndrimi
Këtu. jemi këtu ne. Pra këtu qëndrojmë ne.
Këtu qëndron këtu në këtë mënyrë. Ja ku jemi.
Qendrimet janë kështu si ne. Kështu ne jemi këtu kësi soji.
Këtu janë kështu këtu janë. këtu në këtë mënyrë
A jemi në këmbë. Kështu jemi duke qëndruar ne
keshtune. Qënrojmë ne që qëndrojmë. Po qëdrojmë ne pra
ne jemi këtu. Këtu qëndrojmë këtu në këmbë jemi
këtu ne. A jemi këta ne që po qëndrojmë këtu në këmbë ne.
Ja ku jemi ne në këmbë jemi këtu ne.

Po qëndrojmë këtu në këmbë jemi duke qëndruar ne.
Ne këtu jemi në këmbë jemi
duke qëndruar ne këtu këtu ne jemi
jemi duke qëndruar në këmbë këtu ne.

Ai është një klishe.
Theksim i tij.
Është thënë. Thotë. Thuaj. Tha. Saga.
Unë them. Ne kemi thënë. Shkatërrim vizual: blathermia,
kompesive.
Shkojnë në çarje.
Hezitimet / prishjet / hapësira të mbushura.
Ai vazhdon tutje.
Shpall mbi çarjet jashtë.
Kurrë nuk lejon gjerat askund të lëviz hapësira.
Njofton.

Rastësi nuk janë mbiemrat.
Asnjëherë mbiemrave.
Pret një këndvështrim.
Shkon në një pikëpamje.
Shpreh fjalët nga prapa.
Inxizon mahnitur.
Listat e pakalueshme.
Unë them askund.
Ndryshim tani dhe i gjerë.

PËRSPEKTIVË:

Nata e vjetër dehur tapë zhytet një peshkaqen
faqezi-deti.
Në gojë në goja.
Oksigjeni është një ëndërr.
Luginat e shkretuara.
Oqeani i rrjedh nga qoshet e syve.
Dropitur nga rënie përpiqet për të kapur valët.
Valë e mosveprimit shfaqin rrugën e saj.
Dërçikthi bije.
Është përpunuar në stomak dhe unë mbytem
terësisht brenda.
Ajo qendron në. Të gjithë për rreth.

Përktheu nga anglishtja: Jeton Kelmendi



Ndue UKAJ
(KOSOVË)

Ndue Ukaj (1977), shkrimtar, kritik i letërsisë dhe publicist. Ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku ka ndjekur edhe studimet e magjistraturës. Ka qenë anëtar i disa redaksive letrare dhe editor i revistës për art, kulturë e shoqëri "Identiteti." Është i përfshirë në disa antologji të poezisë shqipe, brenda dhe jashtë vendit. Poezitë dhe tekstet e tij janë përkthyer në anglisht, spanjisht, italisht, rumanisht, finlandisht, kinezisht, suedisht dhe janë botuar në shumë revista prestigjioze. Është autor i librave: "Diskursi biblik në letërsinë shqipe "Ujëvarat e metaforave", "Godo nuk vjen", "Ithaca of the Word", poezi, "Godo is not coming", "Arka e shpëtimit."

Libri me poezi Godo nuk vjen, u laureua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli" për librin më te mirë të botuar me poezi në vitin 2010 në Kosovë. Ndërsa në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë, "Ditët e Naimit", u laureua me çmimin për poezinë më të mirë. Revista letrare The International Poetry Transation And Research Centre, që botohet në Kinë, më 2014, e ka vlerësuar një nga poetët më të mirë të botuar në vitin 2013 në këtë revistë. Është vlerësuar edhe me mirënjohje dhe çmime tjera letrare.

Është anëtar i PEN-it në Suedi.

LOJA E KUJTESËS

Pasqyra rri e ftohtë si akull antarktiku
përballë syve që e shikojnë habitshëm.
Aty është pika e zjarrtë,
si vendi ku u lidh Prometheu dhe nyja e dilemave
që bluajnë mendjen njerëzore.

Si në skenë teatri, ulesh dhe ushtron dramën e harrimit
mbas çdo përsëritje ndjen një shtrëngim në fyt.
Aty s' ka Zeus, askush s' bërtet nga hidhërimi,
as shkëmbinj me t'lidh për ta.

Ti ec një hap para dy prapa, me trupin elastik,
para regjisorit që fishkëllen përtej mureve të teatrit.
Ti se njeh, ai s'të njeh,
veç dëgjon instruksione: si shuhen kujtimet, si tjetërsohet kujtesa.

Veshët e tu janë të lodhur.
Dëgjojnë shushurimë fjalësh, dëgjojnë klithma fjalësh

dhe britmat e njeriut që lufton m'u çlirua nga
vargonjtë e dhimbjeve, vargonjtë robërisë. Skena
është e zbrazët dhe ushton-
Oh, si ushton zëri i shtegtarit në pyllin e pafund të
mistereve.

Pastaj diçka ndodh brenda teje,
të trazohen ëndrrat, si fantazitë e fëmijëve.
Unë s'flas. Nuk guxoj as me heshtë.
Ti dridhesh në skenën e zbrazët
ushtron dramën e harrimit, duke lëviz një hap para
e dy mbrapa.
....
Lëvizjet tua janë të ngadalshme, në heshtjen që
kumbon sheh dy sy
si fantazmën e Hamletit.
Rrudhesh, tkurresh dhe e ha imazhin tënd.
Aty pushon shikimi i zbehtë, në dritën e së cilës
kërkon hapin e humbur.

Mes është një tunel-
ku qirinjtë shuhen si dritat në këtë skenë boshe.

Skena është e frikshme, e zbrazët ashtu si drama jote.
S' dëgjohet asnjë za, veç ti orvatesh me tjetërsua
kujtesën.
E ajo tërbohet, ashtu siç tërbohet deti
pamëshirshëm përplasë
misteret e thellësive.

Aty fluturojnë të vërtetat që vallëzojnë në duart e
tua plot zjarr.
E ti shtrëngon fytyrën,
sheh vetën si në pasqyrën që t'i shfaq të vërtetat e
fshehura,
rrudhat në ballin tënd, sytë e tretur.
Qepallat që mbulojnë dhimbje,
flokët e shprishura dhe buzët e thara
Dhe aty afër gishtat që dridhen, duke i selektu
dëshirat, kujtimet. Përballë jehonës së kujtesës, rri
pasqyra dhe difton ato që s'i duam.

ATO QË NUK ARRIJMË

Hana skuqet, era tërbohet, ashtu si buzëqeshja jote.
Çfarë mbeti pa u shkrua, pa u thanë?
Për një çast ulem e kundroj qiellin

dhe shtrëngoj duart e mia n'qafën tënde.
Rri në një largësi kokëforte, ku duken plasaritjet e qiellit
E shihen vrimat e zeza të tokës.

Në mbrapaskenë shtrihet heshtja e gjatë, e zymtë-
si dora e Pandorës në arkën e sekreteve.
Si nëpër mjegull i shtrijë duart përpara
e përgjigjet për çka kërkoj, s'i gjej.
Jo... si gjen as ti.

Përplasje. Angështi. Fjala çanë natën e zezë,
ku zhvendosen të vërtetat si fletët nëpër erë
dhe fluturojnë në lartësinë e qiellit,
ku vetëm zogjtë jetojnë të lirë.

Hëna vazhdon skuqjen, era vazhdon tërbimin
e buzëqeshja jote zvetënimin,
dhe thua: lutjet s'dimë kujt ja drejtojmë.

Është natë, hëna skuqet,
kujtesa jonë është një thes i madh
ku dëshirat përzihen si fjalët pa kuptim.
Dhe përplasen ëndrrat me realitetin si në një skenë mundje,
në vrullin e rrëmbyeshëm shpërlahet koha,
si ti n' ujëvarën e dashurisë.

Unë s' lëviz, vetëm shikoj
duart e mia imune nëpër mbeturina
s'i lypin ëndrrat e pa treguara
në rrënojat e qytetërimit të fshehur.
Muret e tij thyhen çdo ditë nga hapat e pakontrolluar.
Unë qëndroj i heshtur-
I heshtur si din të jetë vetëm heshtja.
Mandej mblidhem, tkurrem e ngushtohem brenda heshtjes sime.

Jashtë hana vazhdon skuqjen, era tërbimin,
ashtu si buzëqeshja jote harenë e zvetnume.
E ti nëpër kthinat e vetmisë, pret me vra kujtesën
e me zbrit shkallëve të saj t' zbehta,
ku sytë e rëndomtë s' shohin gjë.
M' i lexuar rreshtat e pashkruar,
ku shfletohet libri i mistereve.
Mes diferencave të dhimbjes e gëzimit,
Është një qiri që terrin e mund.

IDENTITETI

Nëpër pasqyra shumëngjyrëshe s'shihet asgjë: as gjurmë,
As hija e lajmëtarit të dritës me kandilin që lufton errësirën.
Lakuriq shfaqen vetëm statujat e përlotura të qytetit X,
Ku gjëmojnë të përbuzurit që pyesin për paqen humbur.
Në dritare shfaqen gra lakuriqe që kanë shartua pemë
Dhe presin...Presin kalorësitë e dhimbjes. Kthimin.

Në një dritare t' vogël je ti, me sytë e bukur e flokët e shprishura.
Fustan yt është i papërshtatshëm për trupin tënd të bukur.
Me vramendje thua: librat i lexojmë m'u mbështjellë me idetë e tjerëve. Idetë e tjerëve i përtypim si fjalën para shkëputjes nga qenia, kur merr arratinë e panjohur.
Oh, ç'është hidhnim i mosqenit vetvetja?

Lakuriqe shfaqen vetëm statujat e përlotura të qytetit X
ku dashuria s'ka tinguj përcjellës, e truri s'ka vend për risi;
s'ka vend as për dashuri-
truri që racionin e ka të përcaktuar nga kujdestarë... rojet e injorancës, rojet e territ që dritën e luftojnë tash e mot.

Rritemi duke u mësua si të dashurojmë-
e dashurojmë duke e mësua ma parë urrejtjen.
Kjo metamorfozë e jetës ka zanafillën te orgjitë e tempujve mashtrues,
ku lakuriq shfaqen vetëm statujat e përlotura-
thua me një dhimbje që s'e shpjegon me fjalë-
kjo metamorfozë e ka zanafillën te gjarpri mashtrues-
them, me një dhimbje që s'e mbuloj me fjalë.
Luajmë me fjalë, luajmë me ide,
Dhe i tundim dilemat e mëdha, si ëndrrën tonë për parajsën e humbur.
Dhe përplasjen në përqafim të pemës së shartuar,
Pa identitet-
Qysh kur i hëngrëm frutat pa shije.

Burhanedin XHEMAILI (MAQEDONI)

Ka lindur më 28.02.1962. Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka kryer në Kumanovë, ndërsa Fakultetin Filologjik, Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe më 1988 në Shkup. Ka ndjekur edhe studimet pasuniversitare në Letërsi... Ka punuar profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në shkollë të mesme, ndërsa tani është pranuar Këshilltar Shtetëror në Sekretariatin për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, që të transferohet në Ministrinë e Kulturës... Dy mandate ka drejtuar Klubin e Shkrimtarëve "Jehona e Karadakut" dhe përsëri është Kryeredaktor i Revistës "Doruntina" organ i klubit të shkrimtarëve.

Ka botuar:

1."Drita e vonuar'' poezi 1993
2."Frikë nga liria" tregime 1994
3."Portrete të djegura" dramë 1999
4."Tingujt e jetës" tregime 2001
5."Kambanat e lirisë" poezi 2003
6."Magjia moderne'' tregime dhe novela 2005
7."Rruga e ndjenjave" roman 2006
8."Në fund të tunelit" tregime 2011
9."Ëndrra e zgjuar brenda syve" poezi 2013
10."Nga ëndrra në ëndërr/ Din vis în vis" poezi në rumanisht 2013

Po ashtu ka botuar edhe shkrime publicistike, ese, vështrime letrare dhe recensione... Poezi dhe tregime i janë përkthyer në maqedonisht, kroatisht, rumanisht , anglisht...

ÇASTE VETMIE...

Nata e matur
me vetminë e fjetur
shkundi retë e zeza
mbi xhamin e dritares
dhe zgjoi heshtjen time
t'plandosur,
gjersa shikoja portretin e kthyer
n'albumin e kujtimeve të zgjedhura
që m' kthenin në kohën e shkuar,
e zëri i humbur
brenda labirinteve të harresës
m' lëvronte shpirtin
me pyetjet e pareshtura

e nuk më çelte portat e mundësive
të mbyllura me rraptimë shiu...

Nëntor, 2012

KTHIMI...

Sa herë që degdisem
udhëkryqeve të jetës
pështpërimat hijerënda
rrotullohen rreth meje e teje
e fjala nuk e mund arsyen
as ëndrra zhgjëndrrën,
por pikëpyetjet e shfrenuara
humbin peshën e kuptimit
dhe kthimit
në pikën zero
për fillime të mbara
nga e para...

HERETIKËT

1.
Në këtë heshtje të ngurosur
heretikët po gufojnë përbrenda
si uji i kazanit që vlon e nuk tymon
e magjistarët modern mbi avull magjie
po shpikin formulime të reja
për devijimin
që po merret për lavdi
e lavdia për çmendi...

2.
Në këtë kohë të kthyer
pa orë e matës,
po zihen mes veti
idetë e mbrapshta
me engjëjt e heshtur
matanë zjarrit
që na djeg shputat e këmbëve
të lëshuara në lumin e akullt,
e dallkaukët duartrokasin
në sheshin e shtrigave
kur defilon mashtrimi
dhe humbet besimi...

Emine Maliqi - ZAIRI (PESO) (KOSOVË)

U lind më 1janar 1972 në Busavatë të Dardanës (ish Kamenicë) nga ku edhe mori lëndën e parë të ndjesisë poetike .

Vëllimi i pare poetik" Aureola ne Pentagram" u botua nga klubi letrar Nositi Dardane ne vitin 2010.

Dy vite më vonë del me përmbledhjen e dytë poetike, të botuar nga Shtëpia botuese Faik Konica në Prishtinë.

Ajo jeton dhe vepron atje diku afër Alpeve dhe vazhdon të shkruaj kurorave të tyre!

ËSHTË NËNTOR

Janë strukur vetmitarët pranë zjarrit
zogjtë e fshehur kraharorit i gostitin me dëborë
zërat e vetëm që ua mbajnë gjallë brendinë
çfarëdo që këndojnë ata duhet ta dinë

Është nëntor
dhe dielli nuk tërhiqet vetëm me një buzëqeshje
sado që shkëputen yjet me të bardhat thekë
ata sodisin zjarrin që lëpihet nga gjuhë e nxehtë...

nëntor është
sa here që vjen
e gostitin të parët
vetmitarët

NJË DITË

Vjen një ditë
kur puna jote vogëlohet
dhe nuk t'i mbush më brinjët
është e qartë se ti nuk do të vuash
se zemra jote është më e tharë
se sa shpatullat ngarkuar me mal

Vjen një ditë kur do ta humbësh ecjen
dhe m'u aty nën hapin e fundit
dashuria jep shpirt
e sytë
ata do t'i gëzohen currilit të strehëve

në gjumin e tyre më nuk qahet
Vjen një ditë
kur bëhesh njësh me terrin
për tu mësuar më lehtë me varrin.
E ne te gurëzuar si gurë-pritje
shpërndarë si erë-ikje
një ditë të vetme të rrojmë-presim
të tjerat i vdesim

RA

terri ra
s'është risi për të vdekurit
shi ra
hapi puse për të eturit
edhe një yll i fikur ra
një gropë të zezë në qiell e la

shi ra
asnjë gjeth nuk u rrëqeth
asnjë zog nuk qau
veç ne ikëm
nga droja se na del boja

edhe ëndrra ra
në një prag gjumi
si n'kllapi
sa bëra te prek
vdiq si bletë

shi ra
edhe kambanat e kishës
i lagu përbrenda
bash mu aty ku fshihen bletët
kur mbarësohen
dhe pahiri shurdhohen
shi ra
rigueshëm ranë kambanat



Bohdan ZADURA
(POLONI)

Bohdan ZADURA, ka lindur në Pulawy, në Poloni, në vitin 1945. Ai ka botuar njëzet përmbledhje me poezi, tre romane, dy përmbledhje tregimesh, tre libra me kritikë letrar dhe përkthime të shumta me poezi dhe prozë (angleze, hungareze, ukrainase). Ai mbaroi nivelin e Masterit për filozofi, në Universitetin e Varshavës (1969), pastaj ka punuar në një muze të vogël në Kazimierz Dolny, dhe në Teatrin e Vizionit dhe Lëvizjes në Lublin (si këshilltar letrar). Ai ishte në stafin editorial të tremujores Akcent, (në Lublin) që 25 vjet, dhe që nga viti 1983, ka punuar për mujoren prestigjioz Twórczość në Varshavë, ku ai tani është redaktor i përgjithshëm.

Shtatë vëllimet e punimeve të tij të mbledhura janë botuar në 2005-2007. Librat e tij të fundit me poezi: Wszystko (Gjithçka) 2008; Życie Nocne (Jetë nate), 2010; Zmartwychwstanie ptaszka (Ringjallja e zogut të vogël), 2012; Kropka nad i (Ndalesa e plotë e I-së) 2014. Zadura ka fituar çmime të shumta, duke përfshirë edhe çmimin Piętak, me 1994, çmimin e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë Kievskie Lavry të vitit 2010, çmimin Silesius të vitit 2011 (për librin më të mirë të poezisë të botuar në vitin 2010), Çmimin Gábor Bethlen të vitit 2013 (Hungari) dhe çmimin Skovoroda të vitit 2014 (Ukrainë).

LAMTUMIRË OSTEND

I
Ne mund ta quajmë këtë detyrim liri
Plazhet e prillit shkëmbor dhe zbrazësi-
Dhe era e vetmuar është kudo e pranishme.

O pranverë e vonuar, Drita nga yjet
Vrapon te syri shumë gjatë, Shumë gjatë
Gjelbërimi mbledh veten në lulëzim, Shumë gjatë.

Ne mësojmë durimin, Shumë pyetje
Formuluar dobët për këtë jetë.
E përvoja të shumta t' përjashtuara.

Ndoshta s'ka përgjigje, Ndoshta
Përgjigjja është në pyetje, Ndoshta
Mund të jetë një eksperiment, Të Jesh ndoshta.

II
Dielli u ndal në zenit, O njohuri të vonuara të
Ëndrrave të ndriçuara, Sa vite janë të nevojshme
Për të njohur veten-tha ai duke shikuar njerëzit
përmes panelit.

K. ishte i heshtur. Ai gjykoi të duhurën
Përgjigje për botën që të jetë heshtja K.
Sikurse prapa tij Ai besonte në sekrete

Ai ishte në gjendje të dëgjoi, Pretendoj të kuptoj,
Nuk ishte i befasuar
Nga çdo gjë Akulli shpërtheu në Vistula Paneli, u
lëkund.
A. vazhdoi

Le të themi detyrimi
Ekziston - le të themi, Por si mund të flasë njëri për
atë
Duke mos e njohur realitetin dhe veten.

III
Një grua hyri, Dikush tjetër i përngjashëm
O komedi e ngjashmërisë, Asgjë përsëritet
A. shikon rrugën ku ai takon.

Historinë dhe fatin, Fati nuk ishte historia
Historia nuk ishte grua, Por ai vrapon larg
Para se ai t´i gjej rezultatet e arratisjes së tij.

Kjo është e gjitha Asgjë më shumë Një grua kalon
Një aromë delikate, jo aroma e
Pyjeve Akacia në rreze dielli të plota qershori.

Kjo u përhapë, Dikush tjetër i përngjashëm
Është si zhurma e bletëve
Në pyjet Acaria, Është si muzikë.

Në pragun e Tingullit të Rrufeshëm
Duke ftuar për një ndjekje, Zgjon asociacione
Premtimet Acarimin, Zgjon dëshirën.

Duke qenë një kujtim, Re e padukshme
Sa më shumë e përhapur aq më shume trupor
Dhe përsëri shpërthime, Dhe përsëri panele të
lëkundura

IV
Çfarë unë munda, Çfarë duhet, Çfarë duhej
Çfarë unë dëshiroja, Pse kam dhënë
Pse shkaqet e humbura më interesojnë mua.

Gloria victis, siç shkruan mirë një zonjë e caktuar
Në kamionçinë që mbante Romuald Traugutt
Dielli qëndron ende në zenit, O dituri e vonuar

Gabimi ushqen gabimin, Ai është një lum i gabimeve
As triumfi as vdekja e Zhvendosur n' kohë
Dhe një shënim i rremë në vetë-ekzaminim.

E Vërteta jonë zgjat aq sa aroma
E parfumit në një kafe tymosjeje, Të Vërtetat tona
Në një botë pa të vërteta, Deti mashtrues.

V
Shekulli i nëntëmbëdhjetë, ishte shumë rëndë.
Shumë i rëndë që t' shpërthejë
Ai ende s'ka shkuar, Është ende i shkatërruar

Nuk bëjnë më ëndrrat rregull në ne
Vdekja me peshë, Është në të
Kjo panel i drurit, këto shandanë Dhe është

Në dhomat e pushimit zbukuruar tani me kolona të reja
informacioni i njoftimeve të numrave dhe simboleve mashkullore
Rrjedhat e degraduara nëntokësore.

Të anarkisë, Ky është shekulli i nëntëmbëdhjetë
Duke rregulluar lapsat dhe pendët e saj
E vjetra kërkon hakmarrje për dëshira të gjata e të fshehura.

(Përktheu nga anglishtja: Edita Kuçi Ukaj)

Ilire ZAJMI
(KOSOVË)

Ilire Zajmi, e lindur në Prizren është shkrimtare, gazetare, përkthyese e studiuese.

Ka studiuar drejtësinë në Universitetin e Prishtinës. Magjistre e shkencave të gazetarisë e komunikimit masiv.

Autore e përmbledhjeve me poezi: "Kambanat e mëngjesit"-Prishtinë (1991), "Baladë e bardhë"-Prishtinë (2000), "Amnesia" në gjuhën angleze, shtëpia botuese Corpos Editora, Portugali (2011), "Ëndërr e huaj" në formatin e-book Filozofia urbane (2013), përmbledhjen me poezi në gjuhën frënge "C'est la fin" botuar nga shtëpia botuese l'Harmattan, Francë (2014).

Autore e romanit "Fashitja e ëndrrave rebele" Prishtinë (1996), librit publicistik bashkë me gazetarin italian Filippo Landi "Un treno per Blace" botuar në gjuhën italiane nga shtëpia botuese la Meridiana në Itali (1999); "Një tren për Bllacë", shtëpia botuese Saga Prishtinë (2011), librit studimor në fushën e komunikimit "Pamjet televizive dhe realiteti" shtëpia botuese Rozafa, Prishtinë (2011). E romanit "Era" botuar nga shtëpia botuese "Bota Shqiptare" Tiranë 2014.

Ka përkthyer në shqip nga gjuha italiane së bashku me Anton Nikë Berishën, librin "Pëshpëritje e hënës" të Giuseppe Napolitanos.

E prezantuar si autore në revista letrare e antologji ndërkombëtare.

Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë të botës si anglisht, frëngjisht, italisht, portugalisht, rumanisht, në gjuhët malazeze, kroate, boshnjake, etj.

Pjesëmarrëse në festivale ndërkombëtare të poezisë.

Fituese e çmimit "Ventennale" në konkursin ndërkombëtar për poezi në Milano të Italisë, 2011. Fituese e çmimit të parë për poezi në manifestimin "Mitingu i Poezisë" edicioni i 49 në Gjakovë, maj 2013.

Anëtare e PEN qendrës së Kosovës dhe asociacionit Poetas del Mondo (Shkrimtarët e botës).

Koordinatore e festivalit ndërkombëtar të poezisë "Britma e gruas" .

DËSHIRAT

Dëshirat janë fëmijë që nuk rriten kurrë
Flluska që pluskojnë në ajër
Joshje për të shijuar mollën e mëkatit
Braktisje e kujtesës. Hi i shndërruar në eshkë

Dëshirat janë hieroglife të lashta sa bota.
Mesazhe në shishe
Dëshirat e vërteta janë ato
Që s'arrijmë t'i njohim akoma
Që s'guxojmë t'ia pranojmë as vetes
E thellë thellë në skutat më të largëta
mbyllim sytë në errësirën e dhomës pa dritare
Pyetemi vërtet a janë tonat apo të hijeve që na rrethojnë
Dëshirat janë zogj të trembur shtegtarë
Nga vende të panjohura vijnë.
Në vende të panjohura shkojnë.

FUNDI

Ky është fundi miku im
Fundi i ëndrrës i agmisë
Ky është fundi i stories
Që ende s 'ka filluar
Ky është fundi i tundimit
I mëkatit të pashijuar
Ky është fundi i dështimit
Netëve pa dëshmitar
Ky është fundi i erotikës
Puthjeve të vonuara
Ky është fundi i dashurisë
Që ende s'ka lulëzuar
Ky është fundi miku im
Fundi i pafund i jetëvdekjes
E ti pret syhapur
Fundin e lojës.

KOTËSI

Tëre ditën e lume
I vështroj njerëzit në kalim
Pi kafe të ithtë duhan të lirë
Para dhe prapa shpine askënd se shoh
Koketoj me meshkujt që s ' më pëlqejnë
Tregoj barsoleta e nuk qeshem fare
Shkruaj poezi në dritën e hënës
I shqyej nën rrezet e diellit
Premtimet e dhëna në mëngjes
Në mbrëmje i harroj
I largohem jetës ajo më përqesh
I druhem harresës më shumë se zjarrit
Dhe ndjehem e vetmuar
Si bishë e plagosur në kafaz.
A do të jem krejtësisht e vdekur kur te vdes?

foto: Roland Tasho

Visar ZHITI (SHQIPËRI)

Është një nga shkrimtarët më të njohur bashkëkohorë shqiptar, që lëvron poezinë, prozën, esenë, po ashtu gazetarinë dhe përkthimin.

Është diplomuar për Gjuhë dhe Letërsi në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës. U emërua mësues në fshatrat e Kukësit, jo shumë larg kufirit shtetëror me Kosovën. Pas 5 vjetësh punë është dënuar me gjyq të hapur me 10 vjet burg për poezitë e tij. Por dhe në burg ka shkruar fshehurazi poezi. Pasi lirohet, pa të drejtën e botimit, të profesionit dhe atë elektorale, punon si punëtor në fabrikën e tullave në Lushnje.

Kur nisën protestat për demokratizimin e vendit, rreshtohet me të parët dhe bëhet gazetar në organin e parë të shtypit opozitar, "RD".

Pas rënies së diktaturës, në vitet '90 e deri më tani, pothuajse çdo vit Visar Zhiti ka botuar nga një libër nga krijimtaria e tij dhe e të atit (edhe ai i dënuar), ndërkaq ka kryer specializime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe ka marrë masterin në një nga universitet e Romës.

Ka punuar dhe si drejtor në shëpinë botuese "Naim Frashëri", në Kuvend, deputet, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, diplomat, por dhe i pa punë, deri dhe Ministër kulture së fundmi.

Vepra letrare e Visar Zhitit vlerësohet nga lexuesi dhe kritika për guximin artistik dhe të vërtetën që mbart, për gjuhën e gjallë, me metafora e kumbime, për imazhet sa tronditëse, po aq dhe magjepsëse, ku gërshetohen realizmi i ashpër me fantazinë, e përditshmja dhe kohët, tragjizmi dhe grotesku, shpresa dhe besimi tek njeriu, dashuria e pafund, dhembja dhe gëzimi i jetës plot me dritëhije dhe mister, gjithmonë me mesazhe paqeje.

Visar Zhiti është përkthyer dhe në gjuhë të ndryshme si italisht, anglisht, maqedonisht, kroatisht, rumanisht, kurse poezi të tij gjenden nëpër antologjira dhe në gjuhët frëngjisht, gjermanisht, polonisht, sllovenisht, serbisht, malazeze, hebraisht, greqisht, arabisht, danisht, etj.

Visar Zhiti ka përkthyer në gjuhën shqipe poetët e njohur Mario Luzi, Federico Garsia Lorka, Isikava Takuboku, Sebastiano Grasso, Adonis, etj, dhe ka disa botime me lutjet e shenjtores tonë Nënë Tereza

Ka marrë shumë çmime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare, mes të cilëve dhe çmimin e madh letrar "Naim Frashëri" në Tetovë. Është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me urdhrin "Mjeshtër i Madh".

Është Anëtar nderi i Festivalit Ndërkombëtar "Ditët e Naimit" të Tetovës, në Maqedoni. Është anëtar i Akademisë Internacionale të

Arteve të Bukura, të Letërsisë dhe Shkencës "Alfonso Grassi" në Itali dhe anëtar i Akademisë Europiane të Arteve, po kështu është anëtar i PEN Klubit në Itali.

Emri i Visar Zhitit është i përfshirë në enciklopedi dhe në Fjalorë Enciklopedikë për Shqipërinë si në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA, etj., dhe në Enciklopedinë italiane Piccolo Treccani - Itali, etj.

Jeton në Tiranë.

ENGJELLI I SHQIPTAREVE

Engjëlli i shqiptarëve
po ecën zbathur
kësaj dite të ngrohtë,
këmbët duan të shijojnë tokën
ashtu si sytë leximin e poezive.
Dy flatrat e engjëllit të shqiptarëve
sa ngadalë po lëvizin
dhe jo për të fluturuar,
ja, sa për të krijuar një puhizë
që të freskohen mendimet përreth.
Sot do të rrijë mes nesh engjëlli ynë,
t'i gëzohemi flatrave të tij, janë tonat
dhe jo gjithmonë kanë qenë kaq mirë,
herë dhembte njëra,
rëndohej e nuk lëvizte dot
dhe herë tjetra nga plagët
që i shkaktonin sqepat dhe kthetrat
e grabitqarëve.
Binin pendë dhe vite
pikonte gjaku nga qielli
dhe mbusheshin pllajat tona me lulëkuqe...

NË QYTETIN E STUDENTËVE

Rini e gëzuar...
Se si më duket, sikur sipër tyre lodrojnë
balona ngjyra-ngjyra
të lidhura me fije të padukshme tek duart,
nëpër kopsat e xhaketave, në ndonjë ide a shqetësim,
balona plot mbi flokënajën e fantazive,
ja, e mbushën qiellin,
e kuqja e dashurive, sa e shpeshtë,
bluja e ëndrrave,
e blerta e shpresave,

grija e një dyshimi, e verdhëllemta diellore,
e bardha si pafajësia e tyre...
dhe i lutem erës
të luajë me to e qeshur,
por të mos i çajë!
Ikin balonat lart, lart si dëshirat,
bashkohen me ato që vijnë nga Perëndimi,
se qielli nuk ka kufij. Po toka
duhej të dijë të zgjedhë...

19 prill 2014

PËRMBAJTJA

Sebastiano GRASSO..... 11
NË STACION
FORMË TË HUMBURA
DO TË VIJNË TEK TY MBI FLLADE
LEGJENDAT FSHATARE
RRATHË MAGJIKË
TË KËPUTËSH AGIMET
MUZGU I JETËS
KUMBIMI I SË DIELËS
AJRI ZVETËNON
MBI RRËNOJA
TË VOZITËSH
TË RIJETOSH MAGJINË
RRUGA BËN BËRRYL
NATË SURREALISTE
QYTETI VDES
MISTERE
SHKALLË LËVIZËSE
GRI
ENGJËJ NË KUNDËRDRITË
E FUNDIT

Maryam Ala AMJADI.....19
DELIRIUM
KU ËSHTË PAQJA E KËSAJ POEME?
SHTËPI E HIDHUR SHTËPI

Kadir AYDEMİR..... 25
HAJDE, ZGJOHU
NË THELLËSITË
DIMRI I POEZISË

Silke Liria BLUMBACH.....29
MËNGJES NË ALLIAS
UNË JAM
KOSOVA DHE UNË
DUKE U ZGJUAR NGA NJË ËNDËRR E LIGË
FSHAT SHQIPTAR
RRAFSHI I TETË

Bisera Suljiç-BOSHKAILO..... 33
NËNA IME
BOSNJA E PAKOHË
MOS MË PRIT MË I DASHUR

Mujë BUÇPAPAJ..... 37
ADRESAT JANË PREJ AJRI
JO VETËM HAPAT
KUR THUA TË MË PRESËSH

Laure CAMBAU.....41
PESHKATAR
VAJZA QË SHET FRUTA
KOKË

Germain DROOGENBROODT..... 43
ITAKA
CIKËL
KUR RETË

Shaip EMËRLLAHU..... 45
PRANVERË JETATDHEU
UDHË PA KRYE
KAH PO SHKOJMË

Galina GANOVA..... 47
PSE NUK
PA TY
KOZMIK

Laura GARAVAGLIA..... 49
INDIKATIV I TANISHËM

Brigitte GYR.....53
I
II
III

Adriana HOYOS..... 57
SYRI VIGJILENT
LITANIA E FRIKËS
STATUJA

Entela SAFETI - KASI..... 61
HIRI
FJALA
SIKUR

Trajçe KACAROV..... 65
E DIJA NJË GRUA
GRUAJA QË ECË PARA MEJE
OPIT
TAJA

Levent KARATAŞ.....67
E TIJ TË ATIJ
HIPNOZA

Joslin Love KEARSE..... 69
KËTEJ E TUTJE
RREBESH PLUMBASH DHE PLAÇKITJE
AJO, DASHURI SI… VIVALDI
ROJTARE E MOTRËS
DEPRESION

Dinos KUBATIS.....73
NUK ISHA NË KOSOVË…
PAVARËSIA E KOSOVËS
LUMI I LANËS
SARANDË
PORTI I NDEZUR
SHQIPËRI

Giuseppe NAPOLITANO..... 81
FALEMINDERIT PEJË: PËRQAFIMI I FJALËS

Bujar PLLOSHTANI.....85
MOTIV POETIK
FILOZOFIA E FJALËS
HËNA XHELOZE

Slavica DABEVSKA QIROVSKA..... 89
ZONJA HYJNORE
MBRËMJE E HESHTUR
GRIMCË E BEKIMIT

Braha ROSENFELD.....93
PIKETAT
AJO KA NJË PALLTO TË THELLË,
ME XHEPA TË HESHTJES

Robert SIMONIŠEK..... 97
HOUSE
GRUA E RE
AIROPORTET ETJ

Victoria SLAVUSKI.....101
PAVARËSISHT
MBI VENEDIKUN
KALIGRAMATIKA E FLUTURËS

Nicolaj STOCHHOLM.....107
AUTOMORFOLOGJI I-IV

Christos TOUMANIDIS..... 111
NJË VJERSHË MË KËRKUAN TË SHKRUAJ
E Ç'PËRRALLË T'U THEM FËMIJËVE?
PËR TY, LINDJE E MESME

Björk ÞORGRÍMSDÓTTIR..... 115
SERENADA
PËRSPEKTIVË

Ndue UKAJ.....117
LOJA E KUJTESËS
ATO QË NUK ARRIJMË
IDENTITETI

Burhanedin XHEMAILI.....121
ÇASTE VETMIE...
KTHIMI...
HERETIKËT

Emine Maliqi - ZAIRI (PESO)..... 123
ËSHTË NËNTOR
NJË DITË
RA

Bohdan ZADURA..... 125
Lamtumirë Ostend

Ilire ZAJMI..... 129
DËSHIRAT
FUNDI
KOTËSI

Visar ZHITI.....131
ENGJELLI I SHQIPTAREVE
NË QYTETIN E STUDENTËVE

Boton
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
"Ditët e Naimit"
Tetovë

Drejtor
Shaip EMËRLLAHU

www.ditetenaimit.org

Botimin e ndihmoi
Ministria e Kulturës e R. Maqedonisë

U shtyp më vitin 2014, në shtypshkronjën
"ArbëriaDesign", Tetovë.

CIP - Katalogizimi në publikim
Biblioteka popullore dhe universitare 'Sveti Klimen Ohridski',
Shkup

821-1(082.2)

FYTYRË sirene / [përgatiti Shaip Emërllahu ; përktheu Visar
Zhiti ...[etj.] ; parathënia Vizar Zhiti]. - Tetovë : Ditët e Naimit,
2014. - 133 f.; 24 cm. -
(Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit");

ISBN 978-608-65084-9-4

COBISS.MK – ID 97161482